ZBULUESIT

Viti 3 - Tremujori 3

"Të zbulojmë thesaret e përjetshme **në librin e Markut, Gjonit dhe te Veprat e Apostujve, duke përfshirë mrekullitë e Jezusit, vdekjen dhe ringjalljen e Tij, shfaqjen e Tij, rikthimin e Tij në qiell dhe nisjen e Epokës së Kishës."**



Programi Bazë

Zbuluesit është një shërbesë e Discovery Land Global.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Një mesazh nga drejtoresha ekzekutive

Të dashur udhëheqës,

Sa bekim i jashtëzakonshëm ta'i japësh jetë Biblës dhe t'u mësosh fëmijëve Fjalën e Perëndisë. Këtë tremujor do të ecim bashkë me nxënësit përgjatë jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Shpëtimtarin tonë. Ju lutem, merrni kohë për ta dëgjuar fillimisht zërin e Perëndisë ndërsa lexoni Shkrimin dhe pastaj studioni kurrikulën.

Ndërsa përgatiteni dhe drejtoni javë pas jave, më lejoni t'ju inkurajoj që të përqendroheni te e korra! 2 e Korintasve 6:2b na thotë: "…tani është dita e shpëtimit." Shumë prej jush keni punuar tokën dhe keni mbjellë farën, e tani po prisni. Përdoreni këtë tremujor si mundësi për t'u lutur për fëmijët e për t'i ftuar që të kenë një marrëdhënie personale me Jezu Krishtin. Sa gëzim është kur sytë e një fëmije hapen për të vërtetën dhe ia dorëzon jetën të vetmit Perëndie të Plotfuqishëm. Mos hiqni dorë!

Mezi pres të shoh gjërat e mrekuellueshme që Perëndia do të bëjë në jetën e udhëheqësve, në mënyrë që që shumë fëmijë nëpër botë të njohin, të duan dhe t'i shërbejnë Perëndisë së vërtetë!

Qëndroni të fortë!

Kris Smoll
Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Tabela e Përmbajtjes
Viti 3 – Tremujori 3

Të kuptojmë kurikulën..... 4
Përmbledhja e tremujorit..... 9
Mësimi 1: Jezusi shëroi një burrë të paralizuar. 12
Mësimi 2: Jezusi ringjalli një vajzë të vdekur dhe shëroi një grua të sëmurë. 21
Mësimi 3: Jezusi u mëson njerëzve se qëndrimi i drejtë para Perëndisë është më i rëndësishëm sesa traditat..... 29
Mësimi 4: Jezusi ringjalli Llazarin. 38
Mësimi 5: Jezusi lau këmbët e dishepujve. 45
Mësimi 6: Pjetri mohoi Jezusin. 52
Mësimi 7: Jezusi iu shfaq dishepujve dhe të tjerëve..... 61
Mësimi 8: Jezusi ngjitet në qiell dhe nis epoka e kishës..... 68
Mësimi 9: Anania dhe Safira gënjejnë. 75
Mësimi 10: Stefani qëndroi i patundur për Jezusin. 82
Mësimi 11: Filipi i tregon etiopasit për Jezusin. 92
Mësimi 12: Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë. 99

Shtojca

Mësim tematik: Lajmi i mirë! 102
Mësim tematik: Qielli..... 109
Lojërat e fundit të përsëritjes 117
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin 120
Mirënjohje dhe falënderime 122

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

TË KUPTOJMË KURIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbulesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepro si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektiv të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
-: 15 Loja e përsëritjes
: 00 Adhurimi
: 15 Koha e zbulimit
: 30 Mësimi nga Bibla
: 60 Loja e fundit e përsëritjes
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiqu t'i bashkosh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin
Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin
Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimit:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).
Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.
Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.
Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën "Vepro si duhet" te mësimi.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që "t'i jepni jetë Biblës", duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t'i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t'i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin "Gjejeni" në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t'i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posteri *Ndihu si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimit dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
2 Pjesëmarrja aktive në klasë
1 Shfaqja e frytit të Frymës
1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesaret e gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje e Tremujorit

Viti 3 – Tremujori 3

Në këtë periudhë kaq të mrekullueshme kemi festuar për ardhjen e Jezusit dhe për gjithçka që Ai ka bërë për ne. Duke nisur që nga profecitë për ardhjen e Tij, te mrekullitë dhe mësimet e Tij; nga dashuria e Tij për ne e deri te plani i Tij, kemi përjetuar pak nga mrekullia për të njohur Jezusin dhe rritjen në Të. Edhe këtë tremujor do vazhdojmë të rritemi në njohuri ndërsa udhëtojmë përmes jetës së Jezusit këtu në tokë, deri te vdekja dhe ringjallja e Tij e lavdishme. Ndërsa mësojmë së bashku, do të forcohemi dhe do të pajisemi për të qëndruar të fortë për Jezusin.

Të gjithë njohim njerëz që nuk i besojnë Jezusit. Ata mund të mendojnë se Ai është mit, ose ndoshta kanë pak njohuri rreth Tij dhe besojnë se ishte njeri i vërtetë, por nuk besojnë se Ai mund t'i shpëtojë nga mëkati. Janë të paralizuar frymërisht – të paaftë të ecin në Frymën dhe në të vërtetën e Tij. Kur Jezusi ishte këtu në tokë, katër burra kishin një shok të paralizuar – që nuk ecte. Këta të katërt bënë gjithçka, sfiduan çdo pengesë, që t'i mundësonin shokut të tyre një takim me Shpëtimtarin. Për shkak të këmbënguljes së tyre, miku i paralizuar u ngrit dhe eci me këmbët e veta dhe gjithashtu mori faljen e mëkateve. Këta katër shokë na treguan se çfarë do të thotë ta drejtosh dikë te Jezusi.

Jezusi filloi ta shfaqte fuqinë e Tij në tokë në dasmën ku ktheu ujin në verë. Fuqia e Tij u shfaq sërish kur shëroi edhe atë burrin që kish qenë i verbër nga lindja dhe të paralizuarin që ia sollën katër shokët. Jezusi shëroi edhe shumë të tjerë. Nëpër vend u përhap fjala për Të dhe turmat rreth Tij u shtuan. Edhe pse shumica e judenjve nuk besuan se mrekullitë e Jezusit vërtetonin se Ai ishte Biri i Perëndisë, një drejtues i quajtur Jair, iu përgjërua Jezusit për të bijën e cila ishte sëmurë dhe po vdiste. Ndërkohë që Jezusi po shkonte te vajza e vogël, një grua që kishte pasur gjakderdhje prej dymbëdhjetë vjetësh preku cepin e rrobës së Jezusit për t'u shëruar. Kur Jezusi u ndal për të parë se kush ishte, disa lajmëtarë i thanë Jairit se ishte shumë vonë pasi e bija kishte vdekur. Jezusi e inkurajoi Jairin të mos kishte frikë, por të besonte. Besimi i Jairit u shpërblye kur vajza e tij e vdekur u rikthye në jetë. Gruaja e sëmurë dhe Jairi janë shembuj të fuqishëm të mënyrës se si ne duhet të varemi në fuqinë madhështore të Perëndisë.

Farisenjtë e refuzuan Jezusin sepse Ai shëroi njerëz në Shabat, ndërsa dishepujt e Tij nuk ndoqën me përpikëri traditat strikte judaike, siç ishte larja e duarve si ritual. Mirëpo, rregullat që thyen Jezusi dhe dishepujt nuk ishin në Shkrim; ishin tradita të krijuara nga njeriu. Jezusi vuri në pah hipokrizinë e tyre dhe u shpjegoi se nuk është ndjekja e rregullave specifike që i rrit ata në shenjtëri, përkundrazi është qëndrimi i drejtë para

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Perëndisë. Mëkatet që ne kemi kryer mund të pastrohen vetëm prej pastërtisë së gjakut të Jezusit dhe ne mund të rritemi në shenjtëri vetëm duke jetuar me përulësi për Perëndinë.

Përveç dymbëdhjetë dishepujve, Jezusi ishte i afërt edhe me dy motrat, Martën dhe Marinë, dhe vëllanë e tyre, Llazarin. Kur Llazari u sëmur, motrat i dërguan fjalë Jezusit. Në vend që të nxitonte për ta shpëtuar, Jezusi priti qëllimisht derisa Llazari vdiq. Kur Jezusi mbërriti, edhe Marta edhe Maria shprehën besimin e tyre të sigurt tek Ai, bashkë me hidhërimin e humbjes së të vëllait. Jezusi kërkoi ta çonin te vendi ku Llazari ishte varrosur katër ditë më parë. Ai e kthen nga vdekja mikun e Tij, duke shënuar kështu kulmimin e mrekullive që kishte kryer. Nga hidhërimi më i thellë, motrat përjetuan gëzimin më të madh dhe na mësojnë t'i besojmë Jezusit në kohë të mira dhe të vështira.

Jezusi kishte treguar përmes mrekullive dhe mësimeve të Tij se kush ishte dhe se koha e Tij e vdekjes po afrohej. Gjatë vaktit të tyre të fundit, Jezusi u mësoi dishepujve se çfarë do të thotë në të vërtetë të jesh drejtues shërbëtor. Jezusi, Ai përmes të cilit u bë bota, mori rolin e një shërbëtori të përulur dhe me dashuri lau dhe thau këmbët e dishepujve. Duke vepruar kështu, ai e ktheu përmbys botëkuptimin e dishepujve të Tij. Ky shembull i shërbesës së Shpëtimtarit na bind të jemi shërbëtorë besnikë.

Jezusi ua bëri të qartë dishepujve se do të tradhëtohej, do të vdiste dhe në ditën e tretë do të ringjallej, megjithatë dishepujt nuk e kuptuan. Në mënyrën e tij egoiste, Pjetri deklaroi një besnikëri të palëkundshme ndaj Jezusit, madje deri në vdekje, ndërsa Jezusi e përballi me të vërtetën. Para se gjeli të këndonte dy herë atë ditë, Pjetri do ta mohonte Jezusin tri herë. Megjithatë, Jezusi bëri edhe këtë premtim – Ai u lut që besimi i Pjetrit të mos mpakej dhe që Pjetri të kthehej për të forcuar vëllezërit. Kur parashikimi i Jezusit u bë realitet, Pjetri përjetoi agoninë e dështimit të tij. Kur ndodhi ringjallja e Jezusit, Pjetri përjetoi hirin e Shpëtimtarit të tij. Ndërsa kalojmë përmes Pashkës me Pjetrin, le të kujtohemi që me guxim të qëndrojmë të fortë për Jezusin.

Pasi Jezusi vdiq dhe u ringjall, Pjetri dhe dishepujt e tjerë panë me sytë e tyre që Jezusi ishte gjallë, sërish në formë njerëzore. Provat vërtetuan se Ai ishte i gjallë: Ai hëngri, bisedoi, eci dhe bëri mrekulli. Nuk ka dyshim se Ai e mposhti mëkatin dhe vdekjen, prandaj ne mund të dimë me siguri se Jezusi dha prova se është i gjallë.

Jezusi kaloi 40 ditë në tokë pas ringjalljes, duke mësuar dishepujt dhe duke i përgatitur për çfarë do të vinte. Para se të ngjitej në qiell, Jezusi u dha një premtim dhe një mision të fundit. Ai premtoi se Fryma e Shenjtë do të vinte e do t'i pajiste, që të bëheshin dëshmitarë dhe të shpallnin Ungjillin nëpër botë. Mirëpo fillimisht dishepujt duhej të përgatiteshin. Pasi Jezusi u ngjit në qiell, dishepujt u bindën. Ata u kthyen në Jerusalem

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dhe u përgatitën për të qenë dëshmitarë. Shembulli i tyre na tregon se mund <u>të jemi gati për t'iu bindur Jezusit.</u>

Kisha e krishterë filloi pas ringjalljes dhe ngritjes së Jezusit në qiell. Ndjekësit e Jezusit ishin të përkushtuar dhe ndanin me guxim Ungjillin, si dhe ndanin gjithçka në përbashkësi me njëri-tjetrin. Uniteti i tyre është një dëshmi e mrekullueshme e një jete të përqendruar te Krishti. Një përjashtim i këtij uniteti ishte Anania dhe Safira, një burrë dhe një grua mes të krishterëve të hershëm, që provokuan Frymën e Shenjtë, duke u përpjekur të mashtronin për kontributin që jepnin nga pasuria e tyre. Ndëshkimi për ta ishte i ashpër. Rasti i tyre shërben si një shembull tronditës që na ndihmon të kujtojmë <u>të themi të vërtetën.</u>

E vërteta e Ungjillit vazhdoi të mbillej, dhe kisha e hershme u rrit shpejt. Kjo rritje bëri që dymbëdhjetë dishepujt të kërkonin ndihmë për të plotësuar nevojat e ndjekësve të Jezusit. Të dymbëdhjetët zgjodhën shtatë burra besnikë si ndihmës, njëri prej të cilëve quhej Stefan. Stefani bëri shenja të mrekullueshme si dëshmi e pranisë së Perëndisë dhe kjo nxiti kundërshtime të forta nga armiqtë e Jezusit. Kur dolën dëshmitë e rreme kundër Stefanit, ai e tregoi i patrembur historinë e Izraelit dhe i përballi akuzuesit e tij me vrasjen e Shpëtimtarit. Për këtë e vranë me gurë, kështu ai u bë martiri i parë i krishterë. Me vdekjen e tij, Stefani na tregoi koston e mundshme kur <u>gëndrojmë të patundur për Jezusin.</u>

Vdekja e Stefanit u ndoq nga një sërë përndjekjesh ndaj atyre që ndiqnin Jezusin. Një nga rezultatet e kësaj përndjekjeje ishte shpërndarja e dishepujve në veri dhe në jug të Izraelit. Kështu, mesazhi i Ungjillit u shpërnda ngado dhe trupi i besimtarëve të krishterë u rrit. Perëndia po vepronte dhe plani i Tij nuk do të dështonte. Pjesë e këtij plani ishte takimi i Filipit me një zyrtar të lartë të mbretëreshës së Etiopisë. Etiopasi ishte një eunuk që po kthehej në shtëpi nga një udhëtim adhurimi në Jerusalem. Takimi i caktuar prej së larti e arriti qëllimin kur Perëndia e përdori Filipin që ta çonte eunukun drejt shpëtimit në Krishtin. Kjo ngjarje na tregon se sa e rëndësishme është që, pavarësisht rrethanave, të jemi gati për <u>t'i shërbyer Perëndisë.</u>

Tanimë përfundon studimi ynë i Dhiatës së Re, ndërsa në këtë ditë kujtojmë të vërtetat e rëndësishme që kemi mësuar për t'u rritur në hirin dhe njohjen e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë. Pas disa javësh do të rikthehemi në kohët entuziazmuese të Dhiatës së Vjetër, ku do të shohim veprat e mrekullueshme dhe të fuqishme të Perëndisë në jetën e shumë njerëzve. Deri atëherë, kujtojmë Fjalën e Perëndisë dhe e zbatojmë çdo ditë të jetës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 1
Marku 2:1-12

Kupto si duhet:	Jezusi shëroi një burrë të paralizuar.
Mendo si duhet:	"Dhe ata i thanë: «Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote»." Veprat 16:31 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'i drejtoj njerëzit te Jezusi.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i guximshëm kur i drejtoj njerëzit te Jezusi.

PËRGATITU!

Në botë ka shumë njerëz të humbur, të cilët nuk kanë shpresën dhe hirin që gjendet në Jezusin. Ashtu ishim edhe ne, mirëpo u shpëtuam! Këtë javë do të mësojmë se sa e rëndësishme është t'i drejtojmë njerëzit te Jezusi. Vetëm Ai mund të mbushë boshllëkun e të shërojë dhimbjen, e vetëm Ai mund të ofrojë shpëtim dhe jetën e përjetshme. Le të lutemi që të mund t'u japim nxënësve tanë shembullin se si t'i drejtojnë njerëzit te Jezusi me guxim.

Lutu: Lutu që Perëndia të hapë sytë e nxënësve, që të mund të kuptojnë se ka miliona njerëz të pashpëtuar nëpër botë që kanë nevojë për Jezusin. Lutu edhe për nxënësit e pashpëtuar. Kërkoji Perëndisë t'i sjellë në takim, që ata të mund të marrin një vendim personal për ta pranuar Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar.

Lexo: Marku 2:1-12

Kupto si duhet: Jezusi shëroi një burrë të paralizuar.
Në këtë periudhë kaq të mrekullueshme kemi festuar për ardhjen e Jezusit dhe për gjithçka që Ai ka bërë për ne. Duke nisur që nga profecitë për ardhjen e Tij, te mrekullitë dhe mësimet e Tij; nga dashuria e Tij për ne e deri te plani i Tij, kemi përjetuar pak nga mrekullia për të njohur Jezusin dhe rritjen në Të. Edhe këtë tremujor do vazhdojmë të rritemi në njohuri ndërsa udhëtojmë përmes jetës së Jezusit këtu në tokë, deri te vdekja dhe ringjallja e Tij e lavdishme. Ndërsa mësojmë së bashku, do të forcohemi dhe do të pajisemi për të qëndruar të fortë për Jezusin.

Të gjithë njohim njerëz që nuk i besojnë Jezusit. Ata mund të mendojnë se Ai është mit, ose ndoshta kanë pak njohuri rreth Tij dhe besojnë se ishte njeri i vërtetë, por nuk besojnë se Ai mund t'i shpëtojë nga mëkati. Janë të paralizuar frymërisht – të paaftë

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

të ecin në Frymën dhe në të vërtetën e Tij. Kur Jezusi ishte këtu në tokë, katër burra kishin një shok të paralizuar – që nuk ecte. Këta të katërt bënë gjithçka, sfiduan çdo pengesë, që t'i mundësonin shokut të tyre një takim me Shpëtimtarin. Për shkak të këmbënguljes së tyre, miku i paralizuar u ngrit dhe eci me këmbët e veta dhe gjithashtu mori faljen e mëkateve. Këta katër shokë na treguan se çfarë do të thotë ta drejtosh dikë te Jezusi.

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ky mësim mbulon një pasazh të shkurtër nga Shkrimi që mund ta lexoni të plotë, bashkë me komentet për mësuesin; gjithashtu mund të shtoni pyetje-përgjigje midis pasazheve. Mësuesi duhet ta ketë gjatë gjithë kohës Biblën e hapur, që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Edhe nxënësit duhet t'i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi që është shënuar te mësimi më poshtë.
- Të duhen letra/kartonë dhe lapustila për të gjithë nxënësit.
- Shpeshherë nxënësit e kanë të vështirë të përgjigjen kur i pyet nëse kanë një shok që nuk e njeh Jezusin. Mund të të thonë: "Të gjithë shokët e mi e njohin Jezusin." Ata mund ta thonë këtë për shkak se shokët e tyre mund <u>të dinë për</u> Jezusin, por nuk <u>besojnë vërtet</u> tek Ai për shpëtim dhe nuk <u>jetojnë</u> për Të. Të kesh njohuri për Jezusin dhe t'i besosh Atij për shpëtim janë dy gjëra të ndryshme. Si mësues, ti duhet ta shpjegosh mirë këtë dallim duke përdorur "Librin pa fjalë" dhe duke shpjeguar më tepër detaje për kuptimin e të qenët i krishterë. Shpjegoju se shpëtimi nuk ka të bëjë me veprat e mira si: të shkuarit në kishë, pagëzimi, etj.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Shndërroje klasën në skenën e kësaj ngjarjeje. Var një dërrasë nga tavani me katër litarë dhe uli nxënësit përreth saj në forë U-je.
2. Inskenoje historinë duke përdorur LEGO, figura, etj. Prit një vrimë në një kuti këpucësh për të treguar se si miqtë e ulën vigun te turma e njerëzve brenda në dhomë.
3. Kur nxënësit të hyjnë në klasë, kërkoju të vendosin mbi një vig në qendër të dhomës emrin e një shoku që nuk e njeh Jezusin. Herë pas here sfidoji nxënësit të mendojnë nëse do të donin t'i ftonin këta miq në kishë, të shpallnin Ungjillin dhe të luteshin rregullisht për ta. Pyeti se si mund të bashkëpunojnë për t'i afruar shokët e tyre te Jezusi. Një gjë është ta dëgjosh mësimin, po tjetër gjë është ta zbatosh atë!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Është urgjente!

Qëllimi: T'u mësojmë nxënësve se sa urgjente është t'i **drejtojmë** njerëzit te Jezusi.

Aktiviteti 1: : Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Një kukull në rolin e të paralizuarit
- Një tendë/çadër (mund ta improvizoni me çarçaf)
- Katër litarë të lidhur me një vig (një dërrasë e sheshtë ku do të shtrini kukullën; litarët duhet të zbresin nga mesi i tendës)
- Etiketa shpërblyese (nga një për çdo nxënës që e përfundon detyrën)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në katër skuadra dhe vendose secilën skuadër në njërin cep të tendës/çadrës.
2. Tërhiqe vëmendjen e nxënësve tek i paralizuar i shtrirë mbi vig në mes të tendës/çadrës.
3. Me shumë kujdes, kërkoji çdo skuadre të mbajë litarin që i takon cepit të tyre.
4. Sfidoji që me ngadalë e me kujdes ta ulin të paralizuarin në tokë, ku Jezusi po jepte mësim. Thekso se sa e nevojshme është puna në skuadër. Skuadra duhet të bashkëpunojë, në mënyrë që i paralizuari të mos rrëzohet nga vigu. Nëse ai bie, do ta nisin nga fillimi.
5. Nëse arrijnë ta ngrenë e ta ulin vigun me sukses, shpërbleji me nga një etiketë shpërblyese secilin.
6. Thekso faktin se bashkëpunimi i tyre e **çoi** shokun e tyre te Jezusi.

Aktiviteti 2: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Çarçafë të mëdhenj që do të shërbejnë si vig (nga një për çdo skuadër)
- Një kukull në rolin e të paralizuarit (sa më e madhe të jetë kukulla, aq më i vërtetë aktiviteti) (nga një për çdo skuadër)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Një zonë me pengesa, në të cilën ka një vijë nisjeje dhe një vijë mbarimi; duhet të jetë mjaft e gjerë, që të dyja skuadrat të lëvizin njëkohësisht dhe të ketë pengesa që duhen kaluar sipër, poshtë, anash, etj. (këtë aktivitet mund ta kryeni edhe jashtë)
- Etiketa shpërblyese
- Alternativë shtesë: Për ta bërë më sfiduese, vendosni një gotë ujë pranë të paralizuarit. Qëllimi është të mos e derdhin ujin gjatë garës me pengesa.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me 6-8 persona për çdo skuadër.
2. Jepi çdo skuadre një çarçaf, ku të vendosin të paralizuarin. Çdo anëtarë i skuadrës duhet të ndihmojë me mbajtjen e çarçafit.
3. Vendosi të dyja skuadrat në vijën e nisjes.
4. Sfidoji ta çojnë të paralizuarin deri në vijën e përfundimit, përmes shtegut me pengesa, pa e rrëzuar atë.
5. Nëse ndonjëra nga skuadrat e rrëzon të paralizuarin, apo rrëzon ndonjë nga pengesat, duhet të kthehet te vija e nisjes.
6. Nëse ndonjëri nga anëtarët nuk po ndihmon, skuadra duhet të rikthehet te vija e nisjes.
7. Skuadra e parë që arrin ta përfundojë garën me pengesa dhe të kalojë vijën e përfundimit me çarçafin me të paralizuarin, fiton nga dy etiketa shpërblyese për çdo anëtar.
8. Përsëriteni me dy skuadra të tjera.

Aktiviteti 3: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Biskota të thjeshta (që do të përdoren si bazë për mini-picat me fruta)
- Krem djathi për ëmbëlsira
- Fruta të prera në copëza të vogla për të bërë "fytyra" te biskotat (rrush, luleshtrydhe, boronica, banane, mandarina, rrush të thatë, etj.)
- Një shembull i "fytyrës" mbi picën me fruta
- Pjata plastike
- Lapustila
- Etiketa shpërblyese

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi çdo nxënësi një pjatë plastike, në cepin e së cilës të shkruajë emrin.
2. Sfidoji nxënësit të mendojnë për një shok të tyre që nuk beson në Jezusin.
3. Thuaju se detyra e tyre është të bëjnë fytyrën e tyre në mini-picat me fruta.
4. Shpjegoju se kjo është një garë për të parë se kush mund të krijojë fytyrën më "realiste". Tre krijuesit më të mirë do të fitojnë nga pesë etiketa shpërblyese.
5. Jepu tetë minuta kohë për të përfunduar.
6. Thuaju të punojnë shpejt dhe saktë.
7. Kur të përfundojë koha, ndaluni dhe lutuni për miqtë.
8. Bëj një vlerësim të shpejtë të fytyrave që kanë formuar te picat me fruta. Shpall tre fituesit dhe jepu etiketat shpërblyese.
9. Lejoji të shijojnë përgatitjen e tyre.

*Ndoshta nxënësit mund ta kenë të vështirë të mendojnë për një shok që nuk e njeh Jezusin, sepse miqtë e tyre mund të kenë dëgjuar për Jezusin, por nuk besojnë vërtet tek Ai për shpëtim. Mund të të duhet t'u shpjegosh atyre shkurtimisht se çfarë do të thotë të jesh i krishterë.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Gjatë aktivitetit të KZ-së sot, keni ndihmuar apo jeni përpjekur të ndihmoni një person në nevojë. A e di se ka njerëz përreth teje, nxënës në shkollën tënde, në lagjen tënde, etj., që janë në nevojë? Sot do të mësojmë për një burrë që kishte një nevojë të madhe. Dëgjoni me kujdes dhe do të zbuloni se cila ishte nevoja e tij më e madhe, që është e njëjtë për shokët e tu.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Lutu specifikisht për nxënësit që kanë ardhur sot dhe për fëmijët nëpër botë që nuk e njohin Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, që ata të dëgjojnë e të kuptojnë për shenjtërinë, mirësinë dhe planin shpëtues të Perëndisë për njerëzit.*

Zbuloje: A është Marku në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër? (Dh.R.) Le t'i hapim Biblat te libri i Markut, kapitulli 2, vargu 1. *Shkruaj referencën e vargut në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat aty. Mësoju se referenca është "adresa" e vargut në Bibël – Marku është libri, numri i parë – 2 – është kapitulli, pra, numri i madh te Bibla, dhe numri i dytë – 1 – është vargu, pra, numri i vogël te Bibla. Ndihmoni ata që janë për herë të parë. Për nxënësit që dinë të gjejnë referencat, përdor metodën "Stërvitja me shpata".*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Çfarë është "Stërvitja me shpata"? Ndërsa shpjegon, thuaj: "Biblat lart!". Nxënësit duhet t'i mbajnë krahët lart me Biblat drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet t'i përsërisin pas teje. Pasi të gjithë të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: "Nisuni!". Nxënësi i parë që e gjen vargun dhe vendos gishtin te vargu, fiton një etiketë shpërblyese.

Kronologjia: Marku gjendet në Dhiatën e Re. A mund të gjeni periudhën kur Jezusi eci në tokë te kronologjia jonë? Kërkoju nxënësve të drejtohen atje.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Kemi mësuar se Perëndia dërgoi Birin e Tij, Jezusin, në tokë si njeri për një arsye shumë të rëndësishme. Arsyeja ishte që Jezusi të merrte ndëshkimin që ne meritojmë për mëkatin tonë (faqja e errët e "Librit pa fjalë"), që të shpëtohemi (faqja e bardhë), të jetojmë për Të në këtë jetë (faqja e gjelbër) dhe të kemi jetë të përjetshme në qiell (faqja e artë). Përdor kronologjinë e Biblës për t'u drejtuar te lindja, jeta, vdekja dhe ringjallja e Jezusit.

Kujtoni që izraelitët ishin populli i veçantë i Perëndisë. Ai zgjodhi që Jezusi, Shpëtimtari i botës, të vinte nga familja e tyre! Përdor kronologjinë e Biblës për t'iu referuar asaj periudhe në histori. Mirëpo, është e trishtë që, shumë prej judenjve, që jetuan në kohën e Jezusit, që kishin njohuri për Të, nuk besuan se Ai vërtet ishte Perëndia që kishte ardhur t'i shpëtonte. Pavarësisht se sa të jashtëzakonshme ishin mrekullitë e Jezusit, shumë prej njerëzve nuk besuan tek Ai. E njëjta gjë ndodh edhe sot; ka njerëz në shkollën tuaj apo në skuadrën tuaj, apo në familjen tuaj, që mund të kenë dëgjuar për Jezusin, por nuk besojnë tek Ai për të shpëtuar nga mëkati. Megjithatë, disa prej judenjve besuan dhe e treguan besimin përmes veprimeve të tyre. Sot do të mësojmë për diçka që duhet ta bëjmë të gjithë ne që i besojmë Jezusit.

Përvijimi i Shkrimit: Marku 2:1-12

Jezusi hyn në Kapernaum

Lexo Marku 2:1

Përmbledhje: Kush e kujton se ku lindi Jezusi? (Bethlehem) Ku jetoi Ai ndërsa rritej? (Nazaret) Kur Jezusi filloi të predikonte, u shpërngul në një qytet të quajtur Kapernaum. Perëndia kishte dhënë profeci për Jezusin në të treja këto qytete. Profeci do të thotë se Perëndia e tha dhe ajo që u tha ndodhi vërtet. Edhe sot mund të shohësh prova historike në këto qytete, që Jezusi dhe dishepujt e Tij ishin atje.

Shënim për mësuesin kryesor: Referoju Mikeas 5:2, Mateut 2:23 dhe Mateut 4:12-16; të gjitha këto profeci vërtetojnë saktësinë e Shkrimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Njerëzit vijnë te Jezusi

Lexo Marku 2:2

Përmbledhje: Përse po vinin gjithë këta njerëz te Jezusi? (Disa donin të dëgjonin mësimet e Jezusit dhe disa të tjerë donin të shëroheshin nga sëmundjet) A mendoni se të gjithë njerëzit që vinin te Jezusi e besonin se Ai ishte Perëndi? (Jo, disa e besonin, por të tjerë jo) Kjo turmë i përngjan pak kishës sonë. Disa njerëz vijnë e dëgjojnë, por nuk besojnë vërtet.

Katër shokë sjellin te Jezusi mikun e tyre të paralizuar

Lexo Marku 2:3-4

Përmbledhje: Ua! Këta katër burra nuk lejuan asgjë që t'i ndalonte për ta çuar shokun e tyre te Jezusi. A e dini se çfarë do të thotë të jesh i paralizuar? Do të thotë që nuk arrin t'i lëvizësh disa pjesë të trupit. Ky burrë nuk arrinte të lëvizte për të shkuar vetë te Jezusi, prandaj shokët e tij e çuan te Jezusi. Edhe pse nuk mund të hynin nga dera për shkak të turmës, ata e gjetën një mënyrë. Çfarë bënë ata që ta çonin mikun e tyre te Jezusi? (Ata e ngritën në çati, bënë një të çarë dhe e ulën trupin e tij me një vig) Ata nuk thanë që ishte shumë e vështirë dhe hoqën dorë, apo jo? Ata u përqendruan dhe bënë gjithçka ishte e nevojshme për ta çuar mikun e tyre te Jezusi! Kjo më kujton "Kohën e zbulimit" sot. Shumë prej jush u përqendruat dhe nxituat për të arritur qëllimin, njësoj si këta shokët. Përse e bënë ata? Si do t'i përshkruaje këta shokë? A do të thoje se janë të guximshëm? (Po)

Mendo për shokët e tu që kanë nevojë për Jezusin. A bën ti gjithçka mundesh për t'i çuar te Jezusi, apo thua që është shumë e vështirë, gjen ndonjë justifikim dhe heq dorë? Cilat janë disa nga mënyrat për t'i çuar njerëzit te Jezusi? Jepu kohë nxënësve të përgjigjen. Sugjero disa mënyra për t'i drejtuar njerëzit te Jezusi, nëse sheh që fëmijët e kanë të vështirë të përgjigjen (për shembull: lutu për ta, ftoji në kishë, shpallu Ungjillin atyre përmes "Librit pa fjalë", etj.) Tani është një çast shumë i mirë që t'u tregosh se si ti ke sjellë dikë te Jezusi.

Le të zbulojmë se çfarë ndodhi kur këta katër shokët e ulën mikun e tyre të paralizuar te Jezusi.

Jezusi fal mëkatin e të paralizuarit

Lexo Marku 2:5

Përmbledhje: Cila ishte gjëja e parë që bëri Jezusi kur pa katër burrat me shokun e tyre të paralizuar? (Ai fali mëkatin e të paralizuarit) Të gjithë e shihnin që ai ishte i paralizuar. Jam i sigurt se edhe ai vetë, edhe kushdo përreth tij, po priste që Jezusi t'i shëronte trupin. Mirëpo, çfarë bëri Jezusi fillimisht për

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

të? Ai i fali mëkatin! A ka ndonjë gjë më të rëndësishme në këtë jetë sesa falja e mëkatit? (Jo!)

Ungjilli

Po ti? Te Veprat 16:31, thuhet se duhet të besojmë në Zotin Jezu Krisht që të shpëtojmë nga mëkati. A ke shpëtuar ti nga ndëshkimi i mëkatit? A e ke marrë këtë vendim dhe a i ke kërkuar Jezusit të të shpëtojë nga mëkati? Nëse jo, apo nëse nuk je i sigurt dhe do të doje ta diskutoje me dikë, do të kemi një kohë për këtë. Ata që janë të sigurt se i kanë besuar Jezusit, apo që nuk duan të flasim për këtë temë, mund të qëndrojnë dhe do të vazhdojmë të mësojmë për të paralizuarin. Le të shohim se ç'ndodh më pas!

Mësuesit fetarë nuk besojnë se Jezusi është Zot

Lexo Marku 2:6-7

Përmbledhje: Aty kishte edhe disa drejtues fetarë të cilët nuk besonin se Jezusi ishte Biri i vetëm i Perëndisë. Ata e dinin se vetëm Perëndia mund t'i falte mëkatet e njerëzve, ndaj menduan se Jezusi ishte gënjeshtar! Mirëpo, a ishte gënjeshtar Jezusi? Padyshim që jo! Çfarë mendoni se bëri Jezusi? Le ta zbulojmë.

Jezusi vërteton se kush është duke e shëruar të paralizuarin

Lexo Marku 2:8-9

Përmbledhje: Jezusi i njihte plotësisht mendimet e tyre. Çfarë mendoni se ishte më e lehtë për t'u bërë? A ishte më e lehtë për Jezusin të thoshte se mëkatet e atij burri ishin falur apo t'i thoshte të çohej e të ecte?

Kur burri mori faljen e mëkateve, a e kuptoi njeri nëse vërtet kishte ndodhur? (Jo) Por, kur Jezusi i tha të ngrihej, të merrte vigun e të ecte, a e kuptuan njerëzit përreth nëse ai u shërua? (Po, sepse e panë me sytë e tyre) Kush është i Vetmi që mund të falë mëkatet? (Jezusi) Kush është i Vetmi që mund të shërojë një të paralizuar thjesht duke i thënë të ecë? (Jezusi) Le të shohim se çfarë bëri Jezusi më pas.

Jezusi bën ende mrekulli

Lexo Marku 2:10-12

Përmbledhje: Burri i paralizuar u shërua. Jezusi e tregoi fuqinë e Tij! Tani njerëzit duhej ta kishin kuptuar se Ai ishte vërtet Perëndia! Mirëpo, nuk ndodhi ashtu; edhe pse disa besuan dhe lavdëruan Perëndinë pas kësaj mrekullie, kishte ende të tjerë që zgjodhën të mos i besonin Atij. Kjo ndodhi shumë kohë më parë, megjithatë Perëndia ende bën mrekulli dhe sot njerëzit mund të zgjedhin t'i besojnë Jezusit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

A nuk ishin fantastikë shokët e të paralizuarit? Ata e çuan shokun te Jezusi dhe ai u shërua, madje mori faljen e mëkateve! Edhe pse ishte shumë e vështirë për ata që ta çonin te Jezusi, ata e bënë. Referoju "Kohës së zbulimit" sot. A nuk dëshiron edhe ti të jesh shok i tillë? Kur ne jemi të gatshëm të bëjmë "punën e vështirë", që shokët tanë të shohin e të kuptojnë Jezusin, ne bëhemi pjesë e veprës së Perëndisë në jetën e tyre!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Drejtuesi i KZ-së dhe ndihmësit shpërndajnë letrat dhe lapustilat ndërkohë që mësuesi jep udhëzimet e mëposhtme. Mendoni për një shok tuajin që ka nevojë për Jezusin. Shkruajeni emrin e tij/saj te letra. Pas disa çastesh do të lutemi dhe do t'i kërkojmë Perëndisë të të japë shumë mundësi për ta sjellë atë shok te Jezusi. Ndërsa kthehesh në shtëpi sot, fol me prindërit për këtë shok që ka nevojë për Jezusin dhe kërkoju të të ndihmojnë të lidhesh me prindërit e tij/saj, që t'i ftoni në kishë.

Ndonjëherë është e vështirë t'i çosh njerëzit te Jezusi, mirëpo, nëse jemi të krishterë nuk duhet t'i lejojmë vështirësitë të na ndalojnë përpjekjet. Le të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë të çojmë një shok te Jezusi.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Përse kishin ardhur aq shumë njerëz për ta parë Jezusin? (Që ta dëgjonin ndërsa predikonte dhe që të shëroheshin)
2. Përse e çuan katër shokët mikun e tyre të paralizuar te Jezusi? (Që ai të shërohej)
3. Çfarë bënë shokët kur turma nuk i lejoi të shkonin te Jezusi? (E çuan shokun e tyre mbi çati, bënë një të çarë dhe e ulën te Jezusi)
4. Kur ia fali mëkatet të paralizuarit Jezusi? (Kur pa besimin e tij dhe të katër shokëve të tij)
5. Kur mësuesit judenj nuk besuan se Jezusi ishte Zot, çfarë bëri Jezusi? (Ai e shëroi të paralizuarin)
6. Çfarë është më e rëndësishme: të shërohesh nga diçka që nuk shkon në trupin tënd, apo të marrësh falje për mëkatin? (Të marrësh falje për mëkatin)
7. Çfarë na mësuan këta katër shokët? (Rëndësinë dhe urgjencën e drejtimit të njerëzve te Jezusi)
8. Përmend disa mënyra se si mund t'i drejtosh njerëzit te Jezusi. (Duke u lutur për ta, duke i ftuar në kishë, duke u shpallur Ungjillin atyre, etj.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 2
Marku 5:21-43

Kupto si duhet:	Jezusi ringjalli një vajzë të vdekur dhe shëroi një grua të sëmurë.
Mendo si duhet:	"I madh është Zoti ynë, e pamasë është fuqia e tij dhe e pafund zgjuarsia e tij." Psalmi 147:5
Vepro si duhet:	Unë do të mbështetem në fuqinë e madhe të Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i inkurajuar kur mbështetem në fuqinë e madhe të Perëndisë.

PËRGATITU!

Vargu nga "Mendo si duhet" këtë javë shpall fuqinë e Perëndisë. Në kohë vështirësish, mund ta thërrasim Atë me besim, duke ditur se Ai na dëgjon dhe na kupton gjithmonë. Sa premtim inkurajues! Ndërsa përgatitemi këtë javë, le t'i kërkojmë Perëndisë të na bëjë të mprehtë për të dalluar fuqinë e Tij.

Lutu: Lutu që, ndërsa shpjegon mësimin, Perëndia t'ua shfaqë veten nxënësve, që ata të kuptojnë se sa i qëndrueshëm, i besueshëm dhe i palëkundshëm është Ai. Lutu për secilin nga fëmijët që ke në grup që të kërkojnë të vërtetën këtë javë.

Lexo: Marku 5:21-43

Kupto si duhet: Jezusi ringjalli një vajzë të vdekur dhe shëroi një grua të sëmurë
Jezusi filloi ta shfaqte fuqinë e Tij në tokë në dasmën ku ktheu ujin në verë. Fuqia e Tij u shfaq sërish kur shëroi edhe atë burrin që kish qenë i verbër nga lindja dhe të paralizuarin që ia sollën katër shokët. Jezusi shëroi edhe shumë të tjerë. Nëpër vend u përhap fjala për Të dhe turmat rreth Tij u shtuan. Edhe pse shumica e judenjve nuk besuan se mrekullitë e Jezusit vërtetonin se Ai ishte Biri i Perëndisë, një drejtues i quajtur Jair, iu përgjërua Jezusit për të bijën e cila ishte sëmurë dhe po vdiste. Ndërkohë që Jezusi po shkonte te vajza e vogël, një grua që kishte pasur gjakderdhje prej dymbëdhjetë vjetësh preku cepin e rrobës së Jezusit për t'u shëruar. Kur Jezusi u ndal për të parë se kush ishte, disa lajmëtarë i thanë Jairit se ishte shumë vonë pasi e bija kishte vdekur. Jezusi e inkurajoi Jairin të mos kishte frikë, por të besonte. Besimi i Jairit u shpërblye kur vajza e tij e vdekur u rikthye në jetë. Gruaja e sëmurë dhe Jairi janë shembuj të fuqishëm të mënyrës se si ne duhet të varemi në fuqinë madhështore të Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor: Jeta dhe vdekja frymërore kapen në konceptin e shpirtit. Trupi (mishi) është i përkohshëm ndërsa shpirti i përjetshëm. Një nga mënyrat më të mira për t'ia shpjeguar këtë një fëmije është me shembullin e mbështjellëses së karameles. Mbështjellësja përfaqëson trupin tonë, ndërsa karamelja brenda përfaqëson shpirtin. Kur një njeri vdes, mbështjellësja (trupi) mbetet prapa, ndërsa shpirti – gjithçka tjetër që të bën atë që je – shkon në qiell. Shpirti është ai që merr faljen dhe që mund të kalojë përjetësinë në qiell. Kur të jemi në qiell do të marrin një trup të përsosur që do të jetojë përjetë. Ne mund të mbështetemi te kjo e vërtetë edhe tani, edhe në përjetësi.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Ky është një mësim i shkëlqyer për t'u inskenuar. Zgjidh drejtues ose nxënës që do të luajnë rolet e caktuara ndërsa ti shpjegon.
2. Jepi çdo nxënësi nga një copë letër, në formën e libërshënuesve. Ndërsa shpjegon, nxënësit duhet të skicojnë pikat kryesore në libërshënuesin e tyre. Sfidjoi t'i vendosin te Bibla e tyre që të kujtojnë gjatë javës atë që mësuan sot.
3. Përdor hartën e kohëve të Biblës për të treguar fshatin e Kapernaumit, ku ndodhën ngjarjet. Pastaj përdor një hartë moderne për të theksuar se këto vendndodhje ekzistojnë ende.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Mbështetu!

Qëllimi: Të përjetojmë se çfarë do të thotë të mbështetesh vërtet te diçka.

Shënimet e drejtuesit për Kohën e zbulimit:

- Nëse do t'i pyesje nxënësit se çfarë bënë gjatë KZ-së sot, a do të përgjigjeshin ata duke e përfshirë fjalën "mbështetem"? Sigurohu që ta theksosh konceptin e "mbështetjes" sot.
- Lexo me kujdes se si lidhet aktiviteti me mësimin.
- Fatkeqësisht, shumë nga nxënësit kanë mësuar se nuk mund të mbështeten e as të varen te njerëzit, as tek ata që duhet të jenë pranë tyre. Sot ata do të mësojnë se mund të mbështeten te fuqia e madhe e Perëndisë, në çdo kohë.
- "Të mbështetesh" do të thotë të vendosësh besimin tënd diku; të varesh.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Postera 21cm x 27cm ku shkruhet " _____ do të mbështetet në fuqinë e madhe të Perëndisë!" (burim i printueshëm)
- Katrorë të vegjël letrash në ngjyra të ndryshme
- Ngjitës
- Lapustila
- Lapsa me gomë
- Një shembull i posterit

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Thuaju nxënësve të shkruajnë emrin te posteri.
2. Udhëzoji të vendosin ngjitësin te shkronjat dhe pastaj ti mbushin me katrorët e vegjël të letrave me ngjyra.
3. Ndërkohë që nxënësit punojnë, ec nëpër dhomë dhe pyeti nëse mendojnë se ngjitësi do t'i mbajë letrat e vogla. Pyeti përse janë të sigurt. A **mbështeten** te ngjitësi për t'i mbajtur letrat me ngjyra të ngulitura te posteri? Mund ta përforcosh idenë duke i pyetur: "Po sikur t'jua marr ngjitësin? A do t'ju pëlqente? Jo, sepse ju po **mbështeteni** te ngjitësi për t'i kapur katrorët me ngjyra te posteri!"
4. Pasi t'i përfundoni, varini diku që të thahen.

Aktiviteti 2: Stacioni i plastelinës

Lista e sfidës me plastelinë

1. Varkë
2. Liqen
3. Turmë me njerëz
4. Jezus
5. Burrë i quajtur Jair
6. Këmbë
7. Vajza në shtrat
8. Dorë
9. Grua e sëmurë
10. Mantel
11. Shtëpi
12. Pikë loti
13. Vajzë në këmbë
14. Pjetri
15. Jakobi
16. Gjoni

Lista e sfidës me plastelinë

1. Varkë
2. Liqen
3. Turmë me njerëz
4. Jezus
5. Burrë i quajtur Jair
6. Këmbë
7. Vajza në shtrat
8. Dorë
9. Grua e sëmurë
10. Mantel
11. Shtëpi
12. Pikë loti
13. Vajzë në këmbë
14. Pjetri
15. Jakobi
16. Gjoni

Mjetet:

- Një listë e sfidës me plastelinë me fjalët: varkë, liqen, turmë me njerëz, Jezus, burrë i quajtur Jair, këmbë, vajza në shtrat, dorë, grua e sëmurë, mantel, shtëpi, pikë loti, vajzë në këmbë, Pjetri, Jakobi, Gjoni (një listë për çdo skuadër) (burim i printueshëm)
- Dërrasa të mëdha ose kapakë të mëdhenj plastikë (nga një për çdo skuadër; duhet diçka e fortë mbi të cilën skuadrat të vendosin objektet)
- Kronometër
- Tabelë për të shënuar pikët
- Juri (ndihmësit, mësuesi kryesor ose ndonjë nga prindërit)
- Tavolinë dhe karrige për jurinë
- Etiketa shpërblyese

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga tre deri në gjashtë nxënës.
2. Jepi çdo skuadre një listë me objektet që duhet të krijojnë te dërrasa e tyre.
3. Sfidoji të krijojnë sa më tepër objekte të munden nga lista, brenda tetë minutash. Mate kohën. Mund të krijojnë disa objekte njëkohësisht. Është një lojë që duhet luajtur me ritëm të shpejtë.
4. Kur të përfundojë koha, skuadra duhet t'i transportojë të gjitha objektet te tavolina e jurisë. Nxënësit duhet të **mbështeten** te dërrasa për t'i transportuar të sigurta objektet. Mund ta përforcosh idenë duke i pyetur: "Po sikur t'jua merrja dërrasën? A do t'ju pëlqente? Jo, sepse ju po **mbështeteni** te dërrasa për t'i transportuar objektet te tavolina e jurisë!"
5. Juria do të krahasojë punën e skuadrave dhe do të caktojë fituesin në bazë të krijimtarisë, saktësisë dhe numrin e objekteve të përfunduara. Fituesit do të marrin nga dy etiketa shpërblyese secili.
6. Skuadra fituese duhet t'i mbajë objektet gjatë mësimit si ndihmë vizuale. Shënim: Ti duhet të **mbështetesh** te dërrasa për të marrë ndihmë vizuale gjatë mësimit.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 3-të, tremujori i 3-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Sot ju është dashur të mbështeteni te _____ (plotësojeni vendin bosh me aktivitetin e KZ-së) për ndihmë. A ju ndihmoi? Si? A jeni mbështetur ndonjëherë te ndonjë person apo objekt gjatë një situate të vështirë? Çfarë do të thotë në të vërtetë fjala "të mbështetesh"? (Do të thotë ta vendosësh besimin tënd diku; të varesh aty) A është e vështirë apo e lehtë të mbështetesh te një person apo objekt?

Kur themi se duhet të mbështetemi te fuqia e Perëndisë, çfarë nënkuptojmë? (Të besojmë se Perëndia është i plotfuqishëm dhe ta kërkojmë fuqinë e Tij kur kemi nevojë për ndihmë) A e kuptoni se ne mund të mbështetemi me siguri te fuqia e Perëndisë? Ju mund të mbështeteni te Perëndia shumë më tepër sesa u mbështetëm te _____ gjatë aktivitetit të "Kohës së zbulimit"!

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në Stacionin e misionit, bëni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Lutu: *Kërkoji njërit nga nxënësve të nisë mësimin me lutje. Kujtoju se është nder dhe privilegj të drejtosh një grup njerëzish në lutje. Sigurohu që nxënësit e tjerë e dinë se duhet të luten në heshtje bashkë me atë që po drejton; kjo do t'i ndihmojë të përqendrohen. Në fund të lutjes, mësoju se fjala "Amen" do të thotë "bie dakord".*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Zbuloje: Mësimi i sotëm gjendet te libri i Markut, kapitulli 5, vargjet 21-43. Ku gjendet Marku në Bibël – në Dhiatën e Re apo te e Vjetra? (Dh.R.)

Kronologjia: Te cila figurë e kronologjisë tregohet koha kur Jezusi jetoi në tokë? *Drejtohu te kronologjia.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam për disa burra që çuan shokun e tyre te Jezusi. A ishte e lehtë apo e vështirë për ta të shkonin te Jezusi? (E vështirë për shkak të turmave të njerëzve dhe për shkak se shoku i tyre nuk ecte dot) Jezusi shëroi trupin e tij dhe shëroi (hoqi) mëkatin e tij. Mësimi na sfidoi t'i çonim njerëzit te Jezusi, edhe kur është e vështirë. A keni patur ndonjë mundësi këtë javë t'i flisni dikujt për Jezusin ose ta ftoni në kishë? Jepu kohë të tregojnë. Sot do të mësojmë për dy persona që kishin probleme të mëdha. Ata duhej <u>të mbështeteshin te fuqia e Perëndisë për t'i kaluar këto sfida të vështira</u>.

Përvijimi i Shkrimit: Marku 5:21-43

<u>Jairi erdhi te Jezusi me një problem të madh</u>

Lexo Marku 5:21-23

Përmbledhje: Jezusi e kishte treguar fuqinë e Tij të madhe duke bërë shumë mrekulli, në mënyrë që njerëzit të kuptonin se Ai ishte vërtet Perëndia. Për cilat nga mrekullitë e Jezusit kemi mësuar së fundmi? (Ai ktheu ujin në verë, shëroi burrin që kish qenë i verbër nga lindja dhe burrin e paralizuar) Çfarë na mësojnë këto gjëra për Perëndinë? *Bëj një listë me cilësitë e karakterit.*

Do t'ju tregoj për një drejtues fetar të quajtur Jair, i cili kishte një problem të madh dhe i nevojitej një mrekulli. Vajza e tij e vogël ishte sëmurë, duke vdekur. Kjo situatë e kishte trishtuar dhe trembur shumë Jairin. Kush e kishte fuqinë për të ndihmuar Jairin? (Jezusi) Për shkak se Jairi kishte dëgjuar se Jezusi mund të shëronte njerëz, shkoi tek Ai dhe iu përgjërua që ta ndihmonte. Megjithatë, mos harroni se Jairi ishte drejtues jude. Shumë nga drejtuesit judenj nuk besonin në Jezusin, madje disa donin edhe ta vrisnin! Çfarë mendoni se bëri Jezusi?

<u>Jezusi shkoi të ndihmonte Jairin</u>

Lexo Marku 5:24

Përmbledhje: Jezusi shkoi me Jairin. Ai nuk ishte i shqetësuar, apo jo? (Jo) A mendoni se Jairi donte që Jezusi të nxitonte? (Po, vajza e tij po vdiste) Mirëpo, ndërsa ata ishin rrugës për te shtëpia e Jairit, diçka ndodhi.

<u>Një grua vjen te Jezusi me një tjetër problem të madh</u>

Lexo Markun 5:25-29

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Kjo grua e gjorë! Edhe ajo kishte një problem. Ishte e sëmurë prej dymbëdhjetë vitesh! Janë shumë vite, apo jo? Ajo i kishte harxhuar të gjitha paratë e saj duke kërkuar ndihmë nëpër doktorë, por askush nuk e kishte ndihmuar. Perëndia na i jep doktorët për të na ndihmuar kur jemi sëmurë, mirëpo ka raste kur nuk na ndihmojnë dot. Kush e kishte fuqinë për ta ndihmuar këtë grua? (Jezusi) A shkoi kjo grua te Jezusi dhe iu përgjërua për shërim? (Jo) Çfarë bëri ajo? (Ajo shkoi fshehurazi pas Jezusit për t'i prekur mantelin) Përse e bëri këtë? (Ajo u mbështet kaq shumë te Jezusi, saqë besonte se, po t'i prekte qoftë edhe cepin e rrobes së Tij, fuqia e Tij e jashtëzakonshme do ta shëronte) A kishte të drejtë ajo? (Po) Çfarë mendoni se bëri Jezusi?

Jezusi ndalet për të folur me gruan

Lexo Marku 5:30-34

Përmbledhje: Çfarë tha Jezusi se e shëroi gruan? (Besimi i saj te Jezusi) Gruaja u mbështet te fuqia e madhe e Jezusit për t'u shëruar. Madje, Jezusi e quajti atë "bijë". Po Jairi? Si mendoni se u ndie ai ndërsa priste këtë grua, ndërkohë që vajza e tij po vdiste? A mendoni se ai po frikësohej se e bija po përkeqësohej?

A ke ndonjëherë ndonjë problem për të cilin të duhet ndihma e Perëndisë, por duket sikur Ai nuk po të ndihmon? A bëhesh i paduruar? A acarohesh, frikësohesh madje ndoshta edhe zemërohesh? Vargu nga "Mendo si duhet" është Psalmi 147:5. *Lexojua nxënësve.* Nëse i ke besuar Jezusit si Shpëtimtar, mund të mbështetesh te fuqia e Perëndisë. Ai na e dha këtë varg, që ta mendojmë dhe ta përdorim kur kemi probleme. Le të shohim se ç'ndodhi më pas me Jairin.

Jairi dëgjon se vajza e tij ka vdekur

Lexo Marku 5:35

Përmbledhje: Oh, jo! Çfarë ndodhi? (Vajza e Jairit vdiq) Si mendoni se po ndihej Jairi? (Me shumë mundësi i pashpresë) Njerëzit e shtëpisë i thanë të hiqte dorë. Por, le të dëgjojmë me kujdes se çfarë i tha Jezusi Jairit.

Jezusi e inkurajon Jairin

Lexo Markun 5:36

Përmbledhje: Jezusi e inkurajoi Jairin duke i thënë: "Mos ki frikë; vetëm beso." Mendoje pak. Jairi mund të ishte zemëruar me Jezusin sepse nuk shkoi në kohë tek e bija. Ai mund të ishte dorëzuar dhe të mos mbështetej te Jezusi, e të ishte kthyer në shtëpi për ta varrosur vajzën. Megjithatë, çfarë duhej të bënte Jairi në këtë situatë të tmerrshme? Ai duhej të mbështetej te fuqia e madhe e

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusit, ashtu siç duhet të bëjmë edhe ne. Sa herë ke frikë dhe ndihesh i pashpresë për diçka, kur në fakt duhet të qëndrosh e të mbështetesh në fuqinë e madhe të Perëndisë?

Pyeti nxënësit nëse kanë kaluar një situatë të vështirë apo të frikshme. Mund të ketë qenë një problem personal, një i afërm i sëmurë, humbja e një shoku, divorci i prindërve, një stuhi që kanë kaluar, etj. Edhe ti mund të tregosh për ndonjë situatë të shkurtër nga jeta jote; thjesht sigurohu të jetë diçka e përshtatshme për moshën.

Le të kthehemi te Fjala e Perëndisë dhe të shohim se çfarë bëri Jezusi.

Njerëzit qeshin me Jezusin

Lexo Markun 5:37-40a me intonacion

Përmbledhje: Përse mendoni se njerëzit qeshën me Jezusin? A kanë qeshur ndonjëherë njerëzit me ty kur je mbështetur te Perëndia apo kur ke folur për Të? Nuk është e lehtë kur të tallin. Në raste të tilla, na duhen pjesët "Mendo si duhet" dhe "Vepro si duhet". A mendoni se Jezusi po nënkuptonte se vajza kishte rënë të flinte siç flemë ne çdo natë? Apo mendon se Jezusi dinte diçka që këta njerëz nuk e dinin? Le ta zbulojmë!

Shënim për mësuesin kryesor: Gjoni 11, ngjarja e Llazarit, është një shembull tjetër i përdorimit të terminologjisë "në gjumë/i vdekur" nga Jezusi (vargjet 11-14).

Jezusi e ringjall vajzën e Jairit

Lexo Markun 5:40b-43

Përmbledhje: Ua! Jezusi e ringjalli vajzën e vogël! A nuk ju mahnit fuqia e Tij e madhe? A nuk ishte e mrekullueshme që Jairi zgjodhi të mbështetej te fuqia e madhe e Perëndisë?

Përfundimi

Jairi erdhi te Jezusi për shkak se donte që Ai t'i shëronte vajzën e tij të sëmurë. Mirëpo, ndërkohë që Jezusi u ndal për të shëruar një grua, Jairi mori vesh që e bija kishte vdekur. Jairi mund të ishte dorëzuar, megjithatë, Jairi u mbështet në fuqinë e madhe të Perëndisë. Për shkak se Jairi kishte besim, Jezusi e ringjalli vajzën e tij të vogël. A nuk është i mrekullueshëm Jezusi?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Përdor “Librin pa fjalë”. A mbështetesh ti te fuqia e madhe e Jezusit? A të ka ringjallur Ai nga vdekja frymërore dhe a ke marrë jetë të re? A e dini se çfarë nënkupton kjo? Së pari, duhet të kuptojmë se çfarë do të thotë të kemi shpirt (*shpjegoje shpirtin duke përdorur informacionin nga shënimet për mësuesin*). Para se të besojmë te Jezusi, edhe pse trupat tanë janë gjallë, shpirtërisht jemi të vdekur e të ndarë nga Perëndia për shkak të mëkatit (*trego faqen e errët*). Kjo do të thotë se, kur të vdesin trupat tanë, nuk do të shkojmë në qiell (*ngri faqen e artë pranë faqes së errët dhe pastaj ndaji*), ku gjithçka është e përsosur dhe ku nuk ka mëkat. Por, nëse zgjedhim t’i besojmë Jezusit që të na shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit (*trego faqen e kuqe*), Ai na fal dhe e pastron mëkatin (*trego faqen e bardhë*). Kjo do të thotë se Ai na ringjalli nga vdekja frymërore në përjetësi jete frymërore! Pra, kur trupat tanë të vdesin, shpirtrat tanë do të shkojnë në qiell (*trego faqen e artë*) dhe ne do të jetojmë me Perëndinë përgjithmonë si anëtarë të familjes së Tij, dhe do të kemi trupa të rinj! Mirëpo, derisa të shkojmë në qiell, duhet të jemi si Jairi dhe të mbështetemi te Jezusi dhe të vazhdojmë të mësojmë për fuqinë e Tij të madhe (*trego faqen e gjelbër*). Nëse nuk ke besuar në Jezusin për të shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit, a do të doje të mësoje tani për këtë? Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes “Librit pa fjalë”.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kush ishte Jairi? (Një drejtues jude)
2. Përse shkoi Jairi te Jezusi? (Ai donte që Jezusi të shëronte vajzën e tij që po vdiste)
3. Çfarë ndodhi kur Jezusi po shkonte të shëronte vajzën e Jairit? (Jezusi ndali të fliste me një grua; për shkak të besimit të saj, Jezusi e përdori fuqinë e Tij të madhe për ta shëruar)
4. Si e inkurajoi Jezusi Jairin pasi i vdiq e bija? (Ai tha: “Mos ki frikë; vetëm beso”)
5. Çfarë bënë njerëzit te shtëpia e Jairit kur Jezusi tha se vajza nuk kishte vdekur, por po flinte? (Ata qeshën)
6. Çfarë bëri Jezusi për vajzën e vdekur të Jairit? (Ai i tha të ngrihej; ajo u ngrit dhe filloi të ecte)
7. A u mbështet Jairi te fuqia e madhe e Jezusit? (Po)
8. Përmend disa nga mënyrat se si mund të mbështetesh te fuqia e madhe e Jezusit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 3
Marku 7:1-23

Kupto si duhet:	Jezusi u mëson njerëzve se qëndrimi i drejtë para Perëndisë është më i rëndësishëm sesa traditat.
Mendo si duhet:	"O njeri, ai të ka bërë të njohur atë që është e mirë; dhe çfarë tjetër kërkon ZOTI nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përulësisht me Perëndinë tënd?" Mikea 6:8
Vepro si duhet:	Unë do t'i kërkoj Jezusit të më ndihmojë të jetoj me përulësi për Perëndinë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i përulur kur Jezusi më ndihmon të jetoj për Perëndinë.

PËRGATITU!

Si të jetojmë një jetë të shenjtë, dhe a është e mundur të jetosh në shenjtëri në kohët moderne? Në vend që të përpiqemi të plotësojmë të gjitha kriteret e shenjtërisë, si dhënia e të dhjetës apo vullnetarizmi i mjaftueshëm, le të kalojmë kohë duke shqyrtuar zemrat tona. Kur jetojmë me përulësi për Perëndinë, natyrshëm rritemi në shenjtëri, ndërsa fryti i Frymës shkëlqen përmes jetës sonë. Në vend që t'i shohim me përçmim ata "më pak të shenjtët" përreth nesh, mund t'i shohim me sytë e Perëndisë dhe t'i duam siç na do Ai.

Lutu: Lutu specifikisht që prindërit ta vendosin Perëndinë të parin në shtëpitë e tyre. Lutu që ata të parët të ecin me përulësi në Perëndinë, ndërsa rriten në shenjtëri.

Lexo: Marku 7:1-23

Kupto si duhet: Jezusi u mëson njerëzve se qëndrimi i drejtë para Perëndisë është më i rëndësishëm sesa tradita.
Farisenjtë e refuzuan Jezusin sepse Ai shëroi njerëz në Shabat, ndërsa dishepujt e Tij nuk ndoqën me përpikëri traditat strikte judaike, siç ishte larja e duarve si ritual. Mirëpo, rregullat që thyen Jezusi dhe dishepujt nuk ishin në Shkrim; ishin tradita të krijuara nga njeriu. Jezusi vuri në pah hipokrizinë e tyre dhe u shpjegoi se nuk është ndjekja e rregullave specifike që i rrit ata në shenjtëri, përkundrazi është qëndrimi i drejtë para Perëndisë. Mëkatet që ne kemi kryer mund të pastrohen vetëm prej pastërtisë së gjakut të Jezusit dhe ne mund të rritemi në shenjtëri vetëm duke jetuar me përulësi për Perëndinë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- "Shenjtëria" e përmendur në këtë mësim i referohet shenjtërimit dhe jo drejtësimit. Pra, po i referohemi rritjes në ngjashmëri me Jezusin (faqja e gjelbër e "Librit pa fjalë"), jo shpëtimit (faqja e bardhë e "Librit pa fjalë").
    - Shenjtërim: të bëhesh i shenjtë (Ky është një proces gradual përmes të cilit një i shpëtuar bëhet më i ngjashëm me Jezusin, duke u rritur në shenjtëri dhe duke fituar mbi mëkatin.)
    - Drejtësimi: të drejtësohesh me Perëndinë (Kjo është një ngjarje që ndodh vetëm një herë, kur personi e pranon Jezusin si Shpëtimtar dhe pastrohet nga mëkati.)
- Edhe pse është një mësim i vështirë për t'u shpjeguar, të jesh i sigurt se është shumë praktik. Pjesa më e madhe e nxënësve njohin dikë që beson se disa rituale apo tradita të caktuar do ta ndihmojnë të shkojë në qiell: pagëzimi, ritualet e lutjes, pjesëmarrja në kishë, veprat e mira, etj. Qëllimi ynë është t'u mësojmë nxënësve se si të reagojnë me përulësi, në mënyrë që ta drejtojnë me dashuri këtë person në njohjen e vërtetë shpëtuese të Jezu Krishtit.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Kuti me objekte! Vendos pesë kuti mbi tavolinë, poshtë secilës vendos një objekt që përfaqëson tradita që disa njerëz besonin se do t'i ndihmonin të fitonin shpëtimin: një grumbull me para të rreme, kalendar dhe ndërtesë kishe (pjesëmarrja e rregullt në kishë), një kosh me ushqime (t'u japim nevojtarëve), një etiketë emri (të bësh punë vullnetare në kishë) dhe një kovë/legen të vogël me ujë e një kukull të vogël (pagëzimi). Shfaqi traditat në kohën e caktuar përgjatë mësimit.
2. Muzeumi i dyllit. Ndërsa shpjegon mësimin, nxirr persona të ndryshëm përpara dhe shndërroji në "manekinë prej dylli" që t'u japësh formë e t'i lëvizësh. Cakto një person në rolin e Jezusit, dy të tjerë në rolin e farisenjve dhe një person si dishepull. Lëvizi gishtërinjtë e farisenjve në drejtim të dishepullit dhe jepu një shprehi fytyre që tregon acarim. Ndërsa shpjegon, shto objekte te farisenjtë që tregojnë "peshën" e traditave; siç është ushqimi, leckë pastrimi (duart e palara), gota, kanë, etj. Ndërsa prezanton Ungjillin, hiqi me radhë traditat dhe vendosi në këmbët e një kryqi që t'u kujtosh nxënësve se nuk shpëtojnë veprat, por vetëm besimi në Jezusin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Shtesë! Shtesë! Lexoje të gjithën!

Shënim: Të nevojiten dy aktorë
Do të vini re se këtë javë, takimin tonë do ta vizitojnë dy "inspektorë". Ata do të vëzhgojnë nxënësit dhe do të "mbajnë shënime". Ndërkohë që ata bëjnë këtë, do të pyesin edhe se cilat **tradita** ndjekin nxënësit: A zgjati loja e përsëritjes në fillim fiks pesëmbëdhjetë minuta? A e kishin marrë të gjithë Biblën me vete? A filloi fiks në orar adhurimi? Përse po pranojnë këshilla nga shokët e tyre, kur në fakt, **sipas traditës**, vetëm drejtuesi duhet t'u japë këshilla? Inspektorët do të theksojnë fjalën "**tradita**". Ata madje mund të "spiunojnë" nga dritarja kur të largohen nxënësit.

Koha e zbulimit: Të thyesh traditën

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të heqin dorë nga **tradita** dhe të ndjekin **me përulësi** një plan të ri.

<u>**Aktiviteti 1:** Stacioni i kutive</u>

Mjetet:
- Dy grupe me nga 21 kuti, te të cilat shkruhen pjesë të ndryshme nga Mikea 6:8 (printojini në dy ngjyra të ndryshme; vendosini grupet e kutive në cepa të ndryshëm të dhomës) (burim i printueshëm)
- Poster me vargun nga Mikea 6:8 (burim i printueshëm); ose shkruajeni vargun në një karton (vareni në mur që ta shohin të gjithë)
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:
1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Kërkoju të shohin posterin ndërsa ti ua lexon me zë të lartë, duke theksuar çdo fjalë.
3. Thuaju: Nëse i kemi besuar Jezusit si Shpëtimtari ynë, Ai dëshiron që ne të jetojmë **me përulësi** për Të. Kjo do të thotë se Ai do që ne të duam t'i bëjmë gjërat siç i pëlqen Atij e jo siç na pëlqen neve. Sot do të bëjmë sfidën e vendosjes së kutive mbi njëra-tjetrën, por me një ndryshim. Dëgjoni me kujdes.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Shpjegoju se në çdo skuadër do të caktohet një kapiten. Kapiteni do të japë udhëzimet për vendosjen e saktë të kutive, që të formohet vargu i Mikea 6:8. Synimi është të shohim se cila skuadër i ndjek **me përulësi** udhëzimet e kapitenit, pavarësisht gjithckaje.
5. Kërkoju ndihmësve të zgjedhin nga një kapiten në secilën skuadër. Po të jetë e mundur, të zgjedhin nxënës me aftësi udhëheqëse. Drejtuesi mund t'i ndihmojë duke u pështpëritur sugjerime gjatë aktivitetit.
6. Informoji nxënësit se anëtarët e skuadrës fituese do të marrin nga dy etiketa shpërblyese. Mos harroni, qëllimi është të shohim se cila nga skuadrat ndjek **me përulësi** udhëzimet e kapitenit, jo cila është më e sakta apo më e shpejta.
7. Filloni aktivitetin. Vëzhgo me kujdes qëndrimin e nxënësve ndërsa punojnë.
8. Kur të përfundojë koha, shpërble me dy etiketa secilin nga anëtarët e skuadrës fituese.
9. Nëse nxënësit e përfundojnë vendosjen e kutive para përfundimit të kohës, zgjidh një kapiten të ri dhe përsëriteni aktivitetin.

Aktiviteti 2: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Plastelinë në katër ngjyra: e gjelbër, e kuqe, e verdhë dhe e bardhë (nga një copë e vogël në çdo ngjyrë, për secilin nxënës)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Kërkoju nxënësve të ulen te tavolinat. Jepi secilit nga një copë për çdo ngjyrë plasteline.
2. Thuaju: Sot do të luajmë një lojë, mirëpo do t'ju duhet të më dëgjoni me shumë kujdes. Do t'ju jap udhëzime për të krijuar objekte me plastelinë, por jo në mënyrën **tradicionale** (siç jeni mësuar deri më tani). Do t'ju duhet të ndiqni me **përulësi** udhëzimet e mia, edhe nëse ju tingëllojnë të çuditshme.
3. Informoji se dy nxënësit që ndjekin më së miri dhe me **përulësi** udhëzimet jo **tradicionale**, do të marrin nga pesë etiketa shpërblyese.
4. Kërkoju nxënësve të formojnë objekte me plastelinë por jo në ngjyrat **tradicionale**: një yll të gjelbër, një re të kuqe, një zemër të verdhë, një pemë të bardhë, etj. Për shembull: "Fillimisht do të formojmë një yll. Për ta formuar yllin, merrni plastelinën e gjelbër."
5. Ji i vëmendshëm ndaj nxënësve që ankohen për ngjyrat e gabuara dhe kujtoju të ndjekin me **përulësi** udhëzimet, edhe pse ngjyrat nuk janë ato **tradicionalet**.
6. Vazhdoni të formoni objekte në ngjyra jo **tradicionale** derisa të vijë fundi i KZ-së.
7. Në fund, shpërble me pesë etiketa dy nxënësit që i ndoqën me më shumë **përulësi** udhëzimet.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i artit

Mjetet:

- Një tabak letër shumë i madh, ku në shkronja GJIGANTE të shkruhet: "Unë ndjek Jezusin" (sigurohu që shkronjat të mbulojnë çdo cep të tabakut të letrës)
- Bojëra dhe furça
- Legenë me ujë (për të larë këmbët)
- peshqirë

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Shpjegoju nxënësve se do të pikturojmë një murale për ta varur në korridorin e kishës. Duam që të gjithë njerëzit të dinë se ju ndiqni Jezusin.
2. Thuaj: Merrni të gjithë nga një furçë. Prisni! Kështu e bëjmë gjithmonë. Le ta thyejmë traditën sot! Le të pikturojmë këmbët dhe të bëjnë një murale me gjurmët e këmbëve tona.
3. Kërkoju nxënësve të gjejnë një partner dhe të ngjyrosin këmbët e partnerit duke përdorur një ngjyrë (nuk lejohet ndryshimi i ngjyrës).
4. Pastaj partnerët duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin ndërsa vendosin këmbën me bojë te tabaku për të lënë gjurmën e tyre te njëra nga shkronjat. Sigurohu që nxënësit të jenë të kujdesshëm e të mos e vendosin këmbën gabimisht diku tjetër.
5. Dyshet duhet të veprojnë me radhë. (Ide alternative: Vetëm njëri nga nxënësit në çdo dyshe ngjyros këmbën. Tjetri do të jetë piktori dhe do të ndihmojë dhe mbështesë partnerin me këmbën e ngjyrosur.)
6. Vareni punimin që të thahet.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: A i vutë re "inspektorët" që kanë kontrolluar gjatë KZ-së sot? Çfarë po kontrollonin? Ata dukeshin si zyrtarë, por shumë të zënë me gjërat e vogla, si: sa minuta e lexoni Biblën çdo ditë, a ishte mjaft i "shenjtë" aktiviteti i KZ-së për shtëpinë e Perëndisë. Çfarë rregullash donin ata që të ndiqnim ne? Kush i ka bërë ato rregulla? E çuditshme!!! Le të shohim nëse mësimi i sotëm na ndihmon ta kuptojmë më mirë këtë situatë.

Lutu: Le të ndalemi e të lutemi që Perëndia të na mësojë diçka të re që të mund ta praktikojmë në jetën tonë sot.

Zbuloje: Mësimi për sot gjendet në Dhiatën e Re, në librin e Markut, kapitulli 7 (numri i madh në Bibël), vargjet 1-23 (numrat e vegjël në Bibël).

Kronologjia: Sot do të vazhdojmë të studiojmë jetën e Jezusit. *Kërkoju nxënësve të gjejnë figurën përkatëse në kronologji.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Pavarësisht të gjitha mrekullive të jashtëzakonshme që kreu Jezusi, shumë prej judenjve nuk besonin se Jezusi ishte Biri i Perëndisë. Nëse drejtuesit fetarë judenj do të pranonin se Jezusi ishte Biri i Perëndisë, njerëzit do fillonin të dëgjonin Jezusin dhe nuk do t'u bindeshin më atyre dhe traditave të tyre të krijuara nga njeriu. Po të ndodhte kështu, ata do ta humbisnin rëndësinë e tyre. Cila cilësi na bën të duam që të tjerët të mendojnë se ne jemi të rëndësishëm? (Krenaria) Njerëzit që i besonin Jezusit ishin mjaft të përulur sa për të hequr dorë nga mënyra e tyre e të jetuarit dhe për jetuar me përulësi për Perëndinë.

Që të ruanin pozitën e tyre të lartë, udhëheqësit fetarë përpiqeshin vazhdimisht ta zinin Jezusin në gabim. Ata mendonin se po ta kapnin Jezusin në gabim, mund t'u vërtetonin njerëzve se Jezusi nuk ishte ai që pretendonte të ishte. Mirëpo, kishte një problem me këtë plan – Jezusi nuk bëri kurrë asnjë gabim dhe Jezusi **është** Ai që thotë se është. Ai **është** Biri i Perëndisë dhe Ai **është** Shpëtimtari i botës!

Përvijimi i Shkrimit: Marku 7:1-23

<u>Udhëheqësit fetarë judenj pyesin Jezusin për larjen e duarve</u>

Lexo Marku 7:1-5

Përmbledhje: Pse kaq problem i madh ngrënia me duar të palara? Padyshim që, bashkë me ushqimin do të hash edhe ca mikrobe dhe baktere, mirëpo a mund ta quajmë mëkat? (Jo) Të lash duart është gjë shumë e mirë, mirëpo është një rregull i caktuar nga njeriu. A ju kujtohet që Perëndia i dha Moisiut dhe izraelitëve Dhjetë Urdhërimet? *Drejtohu te figura përkatëse në kronologji.*

Perëndia i dha këto ligje që izraelitët të dinin se si të jetonin për Të. Nëse do t'i ndiqnin me përulësi udhëzimet e Tij, do të shenjtëroheshin, ashtu siç është i shenjtë Perëndia. Të jetuarit e një jete të shenjtë do të thotë se jeton me përulësi siç i pëlqen Perëndisë, jo siç të pëlqen vetë. Nëse ata do të jetonin në shenjtëri, Perëndia u premtoi se do t'u jepte shumë bekime. Kështu, njerëzit që jetonin në vendet e tjera mund të shihnin se Perëndia i Izraelit ishte Perëndia i vërtetë dhe do ta bënin Perëndinë e tyre gjithashtu!

Mirëpo, udhëheqësit i kishin shtuar rregulla të reja ligjeve të Perëndisë. Kur njerëzit ndjekin një mënyrë të caktuar të të bërit gjërave, apo ndjekin rregulla të caktuara nga njeriu, quhet "traditë". Nuk i bëri Perëndia këto tradita, i bënë njerëzit. Farisenjtë kishin shumë tradita, që ishin shumë të vështira për t'u ndjekur. Njëra nga traditat ishte që njerëzit duhet t'i lanin duart në një mënyrë specifike para se të hanin. Nëse nuk e ndiqnin këtë rregull të krijuar nga njeriu, udhëheqësit fetarë thonin se po thyenin ligjin e Perëndisë. Thyerja e ligjit të Perëndisë quhet mëkat. Kur dishepujt e Jezusit hëngrën pa kryer larjen

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

tradicionale të duarve, udhëheqësit fetarë i akuzuan se kishin thyer ligjin e Perëndisë. A ishte vërtet mëkat? (Jo)

Edhe sot, ka fe që u mësojnë njerëzve se duhet të ndjekin ligje të bëra nga njeriu për të qenë të shenjtë, si ngrënia e ushqimeve të caktuara apo veshja e rrobave të caktuara. Edhe pse disa tradita na ndihmojnë të jemi më të ngjashëm me Jezusin – siç është leximi i një kapitulli nga Bibla çdo ditë – traditat nuk mund të na shpëtojnë. Efesianëve 2:8-9 na thotë se jemi shpëtuar prej hirit, jo prej veprave të mira. *Lexoni ose recitoni Efesianëve 2:8-9.* Edhe pse është shumë mirë të jesh i kujdesshëm me ushqimin dhe veshjen, këto gjëra nuk na shpëtojnë. Qëndrimi ynë para Perëndisë është shumë më i rëndësishme sesa traditat që ndjekim. *Referoju aktivitetit të "Kohës së zbulimit".*

Le të shohim se çfarë u tha Jezusi burrave që i përbuznin njerëzit, për shkak se nuk ndiqnin traditat.

Jezusi i quan udhëheqësit judenj hipokritë

Lexo Marku 7:6-8

Përmbledhje: Jezusi i quan mësuesit fetarë dhe farisenjtë "hipokritë". Një hipokrit është një person që hiqet sikur po vepron drejt, por qëndrimin e ka të gabuar. Nga jashtë mund të duket sikur jeton një jetë të shenjtë, por brenda, nuk e do Perëndinë.

Le të supozojmë se njëri nga fëmijët te grupi këtu është edhe shoku yt i klasës në shkollë. Ai këndon në kishë, u përgjigjet pyetjeve gjatë mësimit dhe hiqet sikur jeton sipas pëlqimit të Perëndisë. Mirëpo, kur është në shkollë përdor fjalë të pista, flet për gjëra të këqija dhe sheh gjëra të papërshtatshme në internet. A do të ishte hipokrit ky person? (Po)

Po ti, a vepron ndonjëherë kështu? A vepron si i krishterë në kishë, por në lagje apo në shkollë vepron siç nuk i pëlqen Perëndisë? Të veprosh ashtu do të thotë të jesh hipokrit.

Këta udhëheqës fetarë nuk po jetonin sipas pëlqimit të Perëndisë. Nuk po tregoheshin të përulur; po tregoheshin krenarë. Ata mendonin se ishin më të mirë se të tjerët. Në fakt, ata po jetonin siç donin vetë **dhe** po e bënin shumë të vështirë që të tjerët të jetonin me përulësi për Perëndinë. Jezusi u dha një shembull të përsosur për diçka që ata nuk e bënin siç i pëlqente Perëndisë. Le ta lexojmë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi jep shembuj të hipokrizisë

Parafrazim i Markut 7:9-13:

Jezusi shpjegoi se përse udhëheqësit fetarë ishin hipokritë. Perëndia na thotë të nderojmë babin dhe mamin. Një nga mënyra për t'i nderuar është duke u kujdesur për ta, sidomos kur plaken. Por, gjejeni pak se çfarë rregulli kishin vendosur udhëheqësit fetarë? Ata thonin se njerëzit nuk duhet t'i përdornin paratë për t'u kujdesur për mamin dhe babin; më mirë t'ia jepnin kishës paratë. Ata thonin se po jepnin para për Perëndinë që të shpëtonin nga përkujdesja për prindërit. Ky rregull i vendosur nga njeriu kundërshtonte atë që kishte thënë Perëndia. Jezusi donte që njerëzit të dinin të vërtetën, ndaj i thirri që ta dëgjonin. Le të shohim se çfarë u mësoi.

Jezusi shpjegon se çfarë i bën njerëzit të papastër

Parafrazim i Markut 7:14-23:

Jezusi u mësoi njerëzve se nuk të ndot ajo që fut në trup, si ushqimi apo pisllëku. "Pisllëku" i vërtetë është natyra jonë njerëzore. Ne duam t'i bëjmë gjërat siç na pëlqen ne – të ndjekim "traditat" tona – në vend që t'i bëjmë gjërat me përulësi siç i pëlqen Perëndisë. A ju kujtohet mësimi për Gjon Pagëzorin? Mësuam se "unë nuk jam personazhi kryesor, por është Perëndia". Ne që besojmë te Jezusi si Shpëtimtari ynë duhet të jemi të gatshëm të heqim dorë nga vetja – nga traditat tona – dhe ta jetojmë me përulësi jetën siç i pëlqen Atij. Ai është i vetmi që mund të na ndihmojë të rritemi në shenjtëri.

Ungjilli

Po nëse nuk i ke kërkuar kurrë Jezusit të jetë Shpëtimtari yt? A mund të rritesh në shenjtëri? Fatkeqësisht, përgjigjja është "jo". E vetmja mënyrë për t'u rritur në shenjtëri dhe për t'u bërë më i ngjashëm me Jezusin është të pranosh fillimisht me përulësi se je mëkatar dhe se ke nevojë që Jezusi të të falë. Këtë mund ta bësh sot! *Shpalle Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë" dhe bëj ftesë për shpëtim.*

Përfundimi

Jezusi u mësoi njerëzve se traditat nuk ishin rruga për në qiell. Ndjekja e rregullave dhe e traditave të bëra nga njeriu nuk është gjëja më e rëndësishme. Perëndia nuk përqendrohet aty dhe as ne nuk duhet të përqendrohemi aty – as për vete as për të tjerët rreth nesh. E po, si të jetojmë jetë të shenjtë atëherë? Mikea 6:8 na e mëson këtë. *Lexoje me zë.* Të "zbatosh drejtësinë" do të thotë të bëjmë më të mirën për të ndjekur rregullat e Perëndisë – ato nga Bibla, jo ato që i kanë bërë njerëzit. Të "duash mëshirën" do të thotë të jesh zemërbutë dhe i dashur me njerëzit, edhe pse ata nuk janë shumë të "shenjtë". Dhe "të ecësh përulësisht me Perëndinë" do të thotë se Perëndia dëshiron që ne t'i bëjmë këto gjëra me qëndrimin e duhur.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

“Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”

Ndonjëherë njerëzit mund të kenë tradita fetare, si përsëritja e lutjeve apo dhënia e një shume specifike parash në kishë. Por, si të krishterë, ne nuk duhet të ndjekim tradita fetare të bëra nga njeriu e as të përpiqemi të jemi të shenjtë për të fituar qiellin – besimi në Jezusin është e vetmja rrugë, dhe asnjë nga veprimet tona nuk na siguron një biletë për në qiell. Për shkak se ne e duam Atë, duam të veprojmë siç duhet. Puna jonë nuk është t’u themi njerëzve me radhë se janë në gabim, siç po bënin farisenjtë. Detyra jonë është pikërisht ajo që thuhet te Mikea 6:8. Lexoje sërish vargun. Duam të bëjmë më të mirën për t’iu bindur atyre që Perëndia na mëson në Bibël, t’u tregojmë njerëzve dashurinë e Perëndisë edhe kur nuk po veprojnë siç duhet. Kur Jezusi na ndihmon të jetojmë në këtë mënyrë, mund të ndiejmë përulësi, ndërsa kujtojmë se vetëm Perëndia është 100% i shenjtë.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t’i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë është një traditë? (Një rregull i bërë nga njeriu apo një mënyrë e të bërit të gjërave)
2. A mund ta çojë në qiell njeriun ndjekja e traditave? (Jo)
3. Cila fjalë përshkruan rezultatin e rritjes në ngjashmëri me Jezusin? (Shenjtëria)
4. Çfarë do të thotë të jesh hipokrit? (Të hiqesh sikur po jeton siç i pëlqen Perëndisë, por në fakt nuk po e bën)
5. Çfarë qëndrimi do Perëndia prej nesh ndërsa përpiqemi të jemi më të ngjashëm me Jezusin? (Përulësi)
6. Kur njerëzit rreth nesh nuk po ndjekin traditat tona ose madje edhe po mëkatojnë, a duhet të drejtojmë gishtin te gabimet e tyre? (Jo, duhet t’u tregojmë mëshirën dhe dashurinë e Jezusit)
7. Cilat janë disa tradita të mira që do të na ndihmojnë të rritemi në shenjtëri? (Leximi i Biblës, lutja para ngrënies së ushqimit, pjesëmarrja në kishë çdo javë, etj.)

Alternativë: *Sa për argëtim, mund t’u kërkosh “inspektorëve” të ecin nëpër korridor pas mësimit. Inkurajoji nxënësit t’u tregojnë atyre se çfarë mësuan.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 4
Gjoni 11:1-53

Kupto si duhet:	Jezusi ringjalli Llazarin.
Mendo si duhet:	"Ki besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua." Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t'i besoj Jezusit në kohët e mira dhe të vështira.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem plot shpresë për shkak se i besoj Jezusit.

PËRGATITU!

Pavarësisht se kush jemi apo ku jetojmë, do të kalojmë ditë sfiduese. E njëjta gjë do t'u ndodhë edhe fëmijëve. Si t'i përgatisim ata për ditët e vështira? Ne u mësojmë t'i shohin rrethanat e tyre përmes një këndvështrimi biblik, duke përdorur katër pikat 'Si duhet'. Kur ne i besojmë Jezusit dhe e përdorim Fjalën e Perëndisë si filtër optik në jetën tonë, mund të ndiejmë shpresë në çfarëdo situate.

Lutu: Lutu që nxënësit të kujtohen për atë që është e drejtë, para se të marrin vendime në bazë të ndjenjave. Kërkoji Perëndisë t'ua kujtojë të vërtetën në çdo stinë apo rrethanë të jetës së tyre.

Lexo: Gjoni 11:1-53

Kupto si duhet: Jezusi ringjalli Llazarin
Përveç dymbëdhjetë dishepujve, Jezusi ishte i afërt edhe me dy motrat, Martën dhe Marinë, dhe vëllanë e tyre, Llazarin. Kur Llazari u sëmur, motrat i dërguan fjalë Jezusit. Në vend që të nxitonte për ta shpëtuar, Jezusi priti qëllimisht derisa Llazari vdiq. Kur Jezusi mbërriti, edhe Marta edhe Maria shprehën besimin e tyre të sigurt tek Ai, bashkë me hidhërimin e humbjes së të vëllait. Jezusi kërkoi ta çonin te vendi ku Llazari ishte varrosur katër ditë më parë. Ai e kthen nga vdekja mikun e Tij, duke shënuar kështu kulmimin e mrekullive që kishte kryer. Nga hidhërimi më i thellë, motrat përjetuan gëzimin më të madh dhe na mësojnë t'i besojmë Jezusit në kohë të mira dhe të vështira.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Ky është një mësim plot ndjenja: trishtim, frikë, entuziazëm, ankth, lumturi, etj. Krijo një tabelë emocionesh, ku të shënosh të gjitha emocionet që përjetojnë personat ndërkohë që ti shpjegon mësimin. Duhet ta njohësh mirë mësimin dhe t'i kesh kuptuar qartë emocionet e përfshira në të. Përreth tabelës, shkruaj fjalët: "Unë do t'i besoj Perëndisë – Fjalët e Urta 3:5-6."
2. Ky është një mësim i shkëlqyer për t'u inskenuar. Paraprakisht kërkoju katër personave, për shembull: drejtuesi i KZ-së, një ndihmës dhe dy prindër, që të jenë pjesë e mësimit. Jepu veshje që u shkojnë me rolin dhe kërkoju të aktrojnë pa fjalë ndërsa ti lexon Shkrimin, pastaj të "ngrijnë" kur ti bën përmbledhje.
3. Para se të fillojë mësimi, vizato në tabelë një hartë me vendndodhjet e përmendura në mësim. Vizato shigjeta dhe shto fjalë kyç mbi vendndodhjet për të theksuar idetë kryesore.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Në të mirë dhe në të keq!

Qëllimi: T'u përforcojmë nevojën për t'i besuar Jezusit në kohë të mira dhe të vështira.

<u>**Aktiviteti 1:** Stacioni i kutive</u>

Mjetet:

- Dy grupe me nga 17 kuti, ku në 2 prej të cilave shkruhet "Besoji" dhe "Jezusit!" dhe te 15 kutitë e tjera vendos fytyrat nga posteri "Ndihu si duhet" (printoji grupet në ngjyra të ndryshme) (burim i printueshëm)
- Posteri "Ndihu si duhet" (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Ndaje stacionin e kutive në dy anë, duke ndarë kështu grupet e kutive nga njëra-tjetra.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Hidhini një sy emocioneve të ndryshme që tregohen te posteri “Ndihu si duhet”.
3. Kujtoju se, pavarësisht situatës që po kalojnë, ata mund t’i **besojnë** Jezusit. Tregoju kutitë ku shkruhet: “Besoji Jezusit!”
4. Sfidoji skuadrat të garojnë për t’i vendosur kutitë mbi njëra-tjetrën, dhe në majë të vendosin ato ku shkruhet: “Besoji Jezusit!”.
5. Skuadra e parë që e përfundon sfidën, fiton.
6. Kujtoju të dyja skuadrave që, pavarësisht nëse po kalojnë një ditë të mirë a të vështirë, mund të **besojnë** se Jezusi është gjithmonë pranë; referoju dy kutive në majë.
7. Jepi skuadrës fituese nga dy etiketa shpërblyese për secilin.
8. Nëse keni kohë, përsëriteni sfidën.

Aktiviteti 2: Stacioni i artit

Mjetet:

- Posteri “Ndihu si duhet” (burim i printueshëm)
- Fletë punëdore në krye të së cilës shkruhet “Si ndihesh?”, në mes duhet të ketë gjashtëmbëdhjetë rrathë me një vizë poshtë tyre, dhe në pjesën fundore të fletës të shkruhet “Çfarë di?” dhe Fjalët e Urta 3:5-6 (burim i printueshëm)
- Lapsa me ngjyra
- Etiketa shpërblyese
- Një punim i përfunduar si shembull (tregojua para se të nisin garën, por fshihe gjatë kohës që ata punojnë)



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit të vizatojnë gjashtëmbëdhjetë emocione të ndryshme në fletëpundoren e tyre. Tregoju shembullin.
2. Personi me figurat/emocionet e vizatuara më bukur do të fitojë dhjetë etiketa shpërblyese.
3. Kujtoju që, pavarësisht se çfarë dite po kalojnë, duhet t’i **besojnë** Zotit.
4. Kërkoju t’i marrin me vete edhe gjatë mësimit, që t’u referohen në momentet përkatëse.
5. Inkruajoji nxënësit t’i varin diku në shtëpi, në mënyrë që sa herë t’i shohin të kujtojnë se, pavarësisht se çfarë ndodh, duhet t’i besojnë Zotit.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 3-të, tremujori i 3-të.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Jeta është plot me ulje-ngritje. Ka ditë të bukura, ka ditë të mërzitshme, ka ditë vetmie dhe ditë entuziazmuese. Sa prej jush kanë patur një javë të mirë? Po një javë të keqe? Një javë të trishtë? Një javë normale? Pavarësisht ditës, mund t'i besosh Jezusit. Sot do të mësojmë për disa persona që përjetuan shumë emocione. Dëgjoni me kujdes për të zbuluar se si ata i besuan Jezusit në uljet dhe ngritjet e jetës.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, kujtoju nxënësve që, pavarësisht se ku ndodhesh në këtë botë, do të kesh ditë të mira dhe të këqija. Megjithatë, pavarësisht si është dita, mund t'i besosh Jezusit.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të lutet me guxim dhe të falënderojë Perëndinë për të gjitha emocionet që na ka dhënë.*

Zbuloje: Sot do të studiojmë Fjalën e Perëndisë në librin e Gjonit, kapitulli 11. Gjoni gjendet në Dhiatën e Re – Mateu, Marku, Luka, Gjoni.

Kronologjia: Në cilën figurë të kronologjisë shohin shërbesën e Jezusit këtu në tokë?

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Mbyllini sytë tani! *Sigurohu që të gjithë t'i kenë mbyllur sytë.* Imagjino sikur të jetoje në kohën kur Jezusi ishte këtu në tokë. Mendo se çfarë do të kishe parë e ç'do të kishe dëgjuar. Si do të ndiheshe po të shihje një nga mrekullitë e Jezusit, si shërimi i të paralizuarit, për shembull? Si do të ndiheshe sikur të dëgjoje për herë të parë mësimet e Jezusit për Perëndinë dhe qiellin dhe se Ai do të falë mëkatin tënd? A mendon se do të kishe besuar se Jezusi është Biri i Perëndisë? A do të kishe qenë ti njëri nga ndjekësit e Tij? E dimë se shumë prej judenjve nuk besuan tek Ai, madje disa u përpoqën ta vrisnin. Mirëpo, kishte disa të tjerë që besuan. Ata i besuan Jezusit plotësisht. Sot do të mësojmë se çfarë bëri Jezusi për disa nga këta njerëz që besuan tek Ai.

Përvijimi i Shkrimit: Gjoni 11:1-53

<u>Jezusi merr mesazhin se Llazari është sëmurë</u>

Lexo Gjoni 11:1-3

Përmbledhje: Ku jetonin Llazari, Marta dhe Maria? (Në Betani) Betania ishte shumë pranë Jerusalemit. Llazari dhe dy motrat e tij e donin shumë Jezusin dhe ishin miq të mirë të tij. Si mendoni se u ndien Marta dhe Maria kur Llazari u sëmur? (Të frikësuara, të trishtuara, etj.) Prandaj, ato dërguan dikë që t'i thoshte Jezusit se vëllai i tyre ishte shumë sëmurë. Dëgjoni se çfarë tha Jezusi kur dëgjoi lajmin për Llazarin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi tregon qëllimin e sëmundjes së Llazarit

Lexo Gjoni 11:4-6

Përmbledhje: Jezusi e dinte shumë mirë se çfarë po i ndodhte mikut të tij të dashur, Llazarit, edhe para se të ndodhte. Çfarë tha Jezusi për sëmundjen e Llazarit? (Nuk ishte për vdekje) Çfarë ndiente Jezusi për Martën, Marinë dhe Llazarin? (Jezusi i donte ata) Sa ditë priti Jezusi për të shkuar te Llazari? (Dy) Përse e bëri këtë? Përse nuk nxitoi për në Betania dhe ta ndihmonte mikun e tij të bëhej më mirë? Le të vazhdojmë leximin për ta kuptuar.

Jezusi ndjek planin e Atit të Tij

Lexo Gjoni 11:7-16

Përmbledhje: Përse kishin frikë dishepujt që Jezusi të shkonte për të ndihmuar Llazarin? (Sepse Llazari jetonte në Betania, që gjendej pranë Jerusalemit, ku shumë drejtues fetarë judenj donin ta vrisnin Jezusin; ata ishin shumë të zemëruar sepse shumë njerëz donin të ndiqnin Jezusin dhe jo ata) Edhe pse ishte e vërtetë, Jezusi nuk kishte frikë. Jezusi kishte një plan të madh për Llazarin, edhe pse Llazari kishte vdekur. Dishepujt shkuan në Betania me Jezusin. Le të shohim se ç'ndodhi kur mbërritën atje!

Jezusi mbërrin në Betania

Lexo Gjoni 11:17-24

Përmbledhje: Prej sa ditësh ishte varrosur Llazari kur Jezusi arriti në Betania? (Katër ditë) Bobo! Sa kohë e gjatë! Gjatë këtyre ditëve, kush kishte shkuar në Betania për të ngushëlluar Martën dhe Marinë? (Shumë judenj nga Jerusalemi) Edhe pse ishte një situatë shumë e keqe, a vazhdoi Marta t'i besonte Jezusit? (Po) Çfarë i tha Jezusi Martës se do të ndodhte me vëllanë e saj të vdekur? (Ai do të ringjallej – do të kthehej në jetë) Marta mendoi se Jezusi po fliste për ringjalljen që do të ndodhë kur Ai të kthehet e të marrë në qiell të gjithë ata që i kanë besuar Atij. Megjithatë, Jezusi nuk po fliste për këtë. Le të vazhdojmë leximin për të kuptuar më shumë.

Jezusi është jeta e përjetshme

Lexo Gjoni 11:25-27

Përmbledhje: Jezusi i tha Martës dy të vërteta shumë të rëndësishme. Së pari, kur i besojmë Atij për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit, edhe kur trupi ynë të vdesë, ne do të jetojmë në qiell. Së dyti, njerëzit që janë gjallë dhe i besojnë Jezusit, kur Ai të kthehet do t'i marrë menjëherë në qiell.

Shënim për mësuesin kryesor: Shih edhe 1 e Korintasve 15.

Kur të kalosh situata të vështira, a do të kujtosh që t'i besosh Perëndisë, në mënyrë që të kesh shpresë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi dëshiron të takojë Marinë

Parafrazim i Gjonit 11:28-37:

Jezusi dërgoi Martën që të thërriste Marinë. Kur ajo erdhi te Jezusi, po qante dhe i tha se Llazari nuk do të kishte vdekur nëse Ai do të kishte qenë atje. Kur Jezusi pa Marinë dhe shumë të tjerë bashkë me të që ishin aq të mërzitur, u trishtua. Ata shkuan te varri i Llazarit. Jezusi ishte aq i trishtuar, saqë qau.

Jezusi ringjall Llazarin

Lexo Gjoni 11:38-44

Përmbledhje: Ua! A nuk është e mrekullueshme? Llazari ishte varrosur katër ditë më parë dhe Jezusi e ringjalli! A e imagjinon dot se sa të gëzuar duhet të kenë qenë Marta, Maria dhe Llazari? Jezusi vërtet i donte ata. A e kupton se Jezusi – po ai që deshi Marinë, Martën dhe Llazarin – të do edhe ty?

Disa besojnë, e të tjerë jo

Parafrazim i Gjonit 11:45-53:

Shumë nga judenjtë në Jerusalem e panë që Jezusi e ringjalli Llazarin dhe besuan tek Ai. Mirëpo, disa të tjerë nuk besuan gjithsesi! Përkundrazi, u kthyen në Jerusalem dhe u treguan farisenjve se ç'kish ndodhur. Farisenjtë thurën plan për ta vrarë Jezusin. Ata madje donin të vrisnin edhe Llazarin! (Gjoni 12:10)

Përfundimi

Marta dhe Maria janë shembuj të shkëlqyer të rëndësisë që ka besimi në Jezusin. Jezusi shfaqi fuqinë e Tij të jashtëzakonshme kur ringjalli Llazarin edhe pse ishte varrosur katër ditë më parë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Po ti? Mendo për disa situata të mira dhe të vështira në jetën tënde. A i beson Jezusit edhe në kohë të mira edhe në kohë të vështira? Jam i sigurt se edhe tani je duke kaluar disa vështirësi. Ndoshta nuk ke një shok të mirë në shkollë, ndoshta prindërit grinden shumë me njëri-tjetrin, ose është sëmurë një i afërmi yt. Le të lutemi që Perëndia të të ndihmojë gjatë kësaj periudhe. *Jepu nxënësve kohë për të reflektuar dhe për t'u lutur.*

Po sikur të mos i kesh besuar kurrë Jezusit që të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit dhe të mos jesh pjesë e familjes së Perëndisë? Te kush do të mbështetesh në momentet e mira dhe të vështira? Jezusi është i vetmi që është përherë aty për ty. Kur i beson Jezusit, Ai është Bariu yt i Mirë. A do të doje t'i kërkoje Aij të të falë e të marrë ndëshkimin e mëkatit tënd, duke e bërë Atë udhëheqësin e jetës sate? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë".*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kur Jezusi mori vesh që Llazari ishte sëmurë, sa gjatë priti para se të shkonte atje? (Dy ditë)
2. Çfarë kishte ndodhur me Llazarin kur Jezusi arriti tek ai? (Kishte vdekur)
3. Çfarë ndiente Jezusi për Martën, Marinë dhe Llazarin? (A i donte ata)
4. Edhe pse ishte një periudhë e vështirë për Martën dhe Marinë, çfarë bënë ato? (Ato i besuan Jezusit)
5. Sa kohë kishte Llazari në varr kur Jezusi mbërriti tek ai? (Katër ditë)
6. Çfarë bëri Jezusi te varri? (A e ringjalli Llazarin)
7. Përmend një periudhë të vështirë në jetën tënde. A i beson Jezusit pavarësisht gjithçkaje?
8. Nese i ke besuar Jezusit si Shpëtimtar, a je plot shpresë për shkak se e di që Jezusi të do dhe se do të jetosh përgjithmonë, edhe pasi të vdesësh?

Shënim: Inkurajoji nxënësit të veshin çorape "të çuditshme" javën e ardhshme, nëse po planifikon të bësh "Ditën e çorapeve të çmendura".

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 5
Gjoni 13:1-17

Alternativë: Dita e çorapeve të çmendura! Kërkoju edhe fëmijëve edhe drejtuesve të veshin çorapet e tyre të preferuara në kishë dhe t'i heqin këpucët në hyrje të klasës së fëmijëve.

Kupto si duhet:	Jezusi lau këmbët e dishepujve.
Mendo si duhet:	"Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin." 1 e Korintasve 15:58 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të jem një shërbëtor i përulur.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i dashur kur u shërbej të tjerëve.

PËRGATITU!

Këtë javë do të mësojmë se si Jezusi lau me përulësi këmbët e dishepujve, duke caktuar shembullin se si të jetojmë si shërbëtorë të përulur. Kur lutemi për fëmijët dhe përgatitemi për t'u shërbyer, edhe ne modelojmë tek ata sjelljen e një shërbëtori të përulur.

Lutu: Falënderoje Perëndinë për nxënësit që ke dhe kërkoji t'i formësojë zemrat e tyre për të qenë shërbëtorë të përulur për Të gjatë gjithë jetës.

Lexo: Gjoni 13:1-17

Kupto si duhet: Jezusi lau këmbët e dishepujve
Jezusi kishte treguar përmes mrekullive dhe mësimeve të Tij se kush ishte dhe se koha e Tij e vdekjes po afrohej. Gjatë vaktit të tyre të fundit, Jezusi u mësoi dishepujve se çfarë do të thotë në të vërtetë të jesh drejtues shërbëtor. Jezusi, Ai përmes të cilit u bë bota, mori rolin e një shërbëtori të përulur dhe me dashuri lau dhe thau këmbët e dishepujve. Duke vepruar kështu, ai e ktheu përmbys botëkuptimin e dishepujve të Tij. Ky shembull i shërbesës së Shpëtimtarit na bind <u>të jemi shërbëtorë besnikë.</u>

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor: Ç'vend zë përulësia në një kulturë që vazhdimisht thotë: "Unë i pari"? Ndërsa shpjegon, kujto se kujt po i drejtohesh: fëmijët tanë rrethohen nga zëra që u thonë të "jenë më të mirët", "të bien në sy" dhe "të luftojnë për veten". Rrallëherë dëgjojnë t'u thuhet që t'i vendosin të tjerët të parët apo t'i vlerësojnë mbi veten (Filipianëve 2:3). Prandaj, ndërsa u mëson për përulësinë këtë javë, bëje praktike dhe personale. Tregoju se madhështia e vërtetë vjen kur u shërben të tjerëve, kur dëgjon para se të flasësh dhe kur i beson forcës së Perëndisë e jo tëndes. Ndihmoji të kuptojnë se të jesh i përulur nuk do të thotë të jesh i dobët – do të thotë të jesh si Jezusi, që ka të gjithë fuqinë, e prapëseprapë zgjedh të shërbejë.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Inskenoje ngjarjen. Përgatit një vakt, një legen me ujë dhe një peshqir për larjen e këmbëve. Drejtuesi i KZ-së ose ndihmësi mund të luajë rolin e Pjetrit.
2. Shkruaj në pjata plastike karakteristikat e një shërbëtori të vërtetë. Vari në një fije peri në mur.
3. Mblidh objekte që theksojnë pikat kryesore të mësimit si: bukë, sandale, legen me ujë, peshqir dhe një "Libër pa fjalë". Përdori objektet për të bërë përsëritje në fund.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Koha për të shërbyer

Qëllimi: T'u japim nxënësve një mundësi për t'u shërbyer të tjerëve.

Shënim: Në bazë të aktivitetit që do të zgjidhni, objektin që nxënësit do të formojnë do t'ua bëni dhuratë njerëzve në komunitet.

Udhëzim për ambientin: Stacioni duhet të ketë tavolina të mëdha me mbulesa me ngjyra dhe nxënësit duhet të qëndrojnë përreth tavolinave për të bërë projektin.

Aktiviteti 1: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Gjëra të ndryshme për të ngrënë (karamele, çokollata, biskota, patatina, fruta të thata)
- Lugë ose gota matëse
- Qeska të vogla dhuratash dhe fjongo
- Letra të lagura

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sigurohu që të gjithë nxënësit të lajnë duart mirë para se të filloni.
2. Ata do të përziejnë ushqime të ndryshme në një qeskë dhuratë për njerëzit në komunitet.
3. Kujtoju se nuk po i përgatisin për veten e tyre; ata po i përgatisin për të tjerët. Ata duhet **t'u shërbejnë me përulësi** të tjerëve duke punuar së bashku për t'i mbushur qeskat me ushqimet që keni.

Aktiviteti 2: Stacioni i artit A

Mjetet:



- Letra me ngjyra (burim i printueshëm)
- 12 vargjet kyç të printuara në etiketa (burim i printueshëm)
- Bojëra dhjami dhe lapustila

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:



1. Shpjegoju nxënësve se kemi një punë të rëndësishme sot. Ata do **t'u shërbejnë me përulësi të tjerëve** duke punuar së bashku për të bërë dhurata për njerëzit në komunitet.
2. Kërkoju të formojnë kartolinën me letrat me ngjyra, ta zbukurojnë dhe të zgjedhin një nga 12 vargjet kyç për ta ngjitur brenda kartolinës.
3. Sfidoji **t'u shërbejnë me përulësi** të tjerëve, duke bërë më të mirën e tyre me kartolinat.

Aktiviteti 3: Stacioni i artit B

Mjetet:

- Pjata të vogla plastike, të bardha (nga një për çdo nxënës; alternativë: priji paraprakisht në formë lulesh)
- Katrorë nga pecetat e duarve (për të shtuar ngjyrat)
- Furçë pikture
- Ngjitës
- Shkopinj lëpirësesh (mund të gjeni shkopinj të thjeshtë)
- Një shembull i lules

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Shpjegoju nxënësve se kanë një punë të rëndësishme për të bërë sot. Do t'u **shërbejnë me përulësi** njerëzve duke punuar së bashku për të bërë një dhuratë për njerëzit e komunitetit.
2. Thuaju të bëjnë lule plastike:

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Duke përdorur furçën, të lyejnë të gjithë pjatën plastike me një shtresë të hollë ngjitësi.
- Të ngjisin katrorët e pecetave të duarve te pjata dhe t'i ngjyrosin.
- Të ngjyrosin shkopin në ngjyrë të gjelbër.
- Ta ngjisin shkopin në pjesë e pasme të pjatës.

3. Sfidoji t'u **shërbejnë të tjerëve** me përulësi, duke u siguruar që bëjnë më të mirën e tyre për të krijuar lulen.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: A e vutë re se sot punuam të gjithë së bashku për t'i shërbyer me përulësi disa njerëzve në komunitetin tonë? Ndërsa ju shihja, vura re se disa prej jush ishit shërbëtorë të përulur e të tjerë jo. Çfarë e bën një "shërbëtor të përulur"? Sot do të mësojmë për një shërbëtor vërtet të përulur.

Lutu: *Lejo njërin nga nxënësit ta nisë mësimin me lutje. Inkurajoje t'i kërkojë Perëndisë t'i përdorë krijimet e tyre të "Kohës së zbulimit" për të inkurajuar dhe për të bekuar ata që do t'i marrin.*

Zbuloje: Mësimi i sotëm gjendet te Gjoni 13:1-17. A është Gjoni në Dhiatën e Re apo në Dhiatën e Vjetër? (Dh.R.)

Kronologjia: Mësimi i kësaj jave gjendet te Kronologjia. Personi i parë që e gjen, fiton pesë etiketa shpërblyese.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Gjatë këtyre javëve të fundit, kemi mësuar se si Jezusi shëroi një të paralizuar dhe një grua që kish qenë e sëmurë prej dymbëdhjetë vitesh. Mësuam se si ktheu në jetë një vajzë të vogël dhe një burrë që kishte vdekur prej katër ditësh! Pavarësisht se panë mrekullitë e Jezusit – gjëra që vetëm Perëndia mund t'i bënte – shumica e drejtuesve fetarë judenj nuk pranonin të besonin se Jezusi ishte Perëndia. Ata ishin përpjekur ta vrisnin Jezusin, mirëpo koha e Tij nuk kishte ardhur ende. Ai duhet të kalonte edhe pak kohë me dishepujt e Tij për t'u mësuar gjërat që duhej të dinin. Le të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na mësojë.

Përvijimi i Shkrimit: Gjoni 13:1-17

<u>Jezusi e di se do të vdesë së shpejti</u>

Lexo Gjoni 13:1

Përmbledhje: A e dinte Jezusi se do të vdiste së shpejti? (Po) A do të vdiste sepse ishte plani i Perëndisë apo i njeriut? (Plani i Perëndisë) Para se të vdiste, Jezusi u tregoi dishepujve se si të trajtonin të tjerët. Le të shohim se çfarë u mësoi Jezusi atyre!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi e di që Juda do ta tradhëtojë

Lexo Gjoni 13:2

Përmbledhje: Jezusi do të hante darkë me dymbëdhjetë dishepujt. Ai e dinte se Juda do ta tradhëtonte dhe se Ai do të vdiste. "Tradhëti" do të thotë ta trajtosh dikë si shok dhe pastaj të bësh diçka që e lëndon.

Jezusi e di se do të kthehet tek Ati i Tij në qiell

Lexo Gjoni 13:3

Përmbledhje: Ky varg na tregon se Perëndia i kishte dhënë Jezusit fuqi mbi gjithçka! Çfarë mendoni se bëri Jezusi me gjithë atë fuqi? Le ta shohim!

Jezusi lau këmbët e dishepujve

Lexo Gjoni 13:4-5

Përmbledhje: Çfarë bëri Jezusi me gjithë fuqinë që kishte? (Ai lau këmbët e dishepujve) Përse mendoni se kishin nevojë të laheshin këmbët e dishepujve? Në kohën e Biblës, rrugët ishin prej dheu dhe balte, ndërsa njerëzit vishnin sandale. Këmbët bëheshin gjithmonë pis. Kur dikush ftonte njerëz për darkë dhe donte t'i tregonte të ftuarit se sa i veçantë ishte, njëri nga shërbëtorët më të parëndësishëm i lante këmbët para se të hanin. Mirëpo, Jezusi nuk ishte një shërbëtor i parëndësishëm, apo jo? Ai ishte Biri i Perëndisë. Le të shohim se çfarë bënë dishepujt.

Pjetri përpiqet të refuzojë

Lexo Gjonin 13:6-8a

Përmbledhje: Simon Pjetri i tha Jezusit të mos ia lante këmbët. A mendoni se bëri mirë që i tha "jo" Jezusit? Pjetri mendonte se Jezusi ishte tepër i mirë për t'u përulur e për të larë këmbët e tij. Le të shohim se çfarë i tha Jezusi Pjetrit.

Pjetri i kërkon Jezusit t'i lajë duart dhe kokën

Lexo Gjonin 13:8b-9

Përmbledhje: Çfarë i kërkoi Pjetri Jezusit tani? (T'i lante duart dhe kokën gjithashtu) Pse? (Që të bëhej si Jezusi) Mirëpo, çfarë i tha Jezusi?

Jezusi shpjegon larjen (Ungjilli)

Lexo Gjoni 13:10-11

Përmbledhje: Le të mendojmë pak për atë që tha Jezusi. A mendoni se Jezusi po fliste vërtet për pastrimin e trupit të njeriut? Apo po fliste për të brendshmen – shpirtin? (Po) Ai përdori diçka që njerëzit mund ta shihnin që t'u mësonte për diçka që ata nuk mund ta shihnin. Ai po thoshte që, pasi një person beson në Jezusin dhe shpëton nga ndëshkimi i mëkatit, mëkati i tij lahet. Megjithatë, a mëkatojmë ne edhe pasi kemi besuar në Jezusin? (Po) Çfarë duhet të bëjmë për këtë? Kur mëkatojmë pasi jemi shpëtuar, a duhet të lutemi që të shpëtojmë

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

edhe njëherë nga i gjithë mëkati? (Jo, këtë e bëjmë vetëm një herë dhe të gjitha mëkatet tona falen) Çfarë duhet të bëjmë për këto mëkatet që vazhdojmë t'i kryejmë? A ju kujtohet "prano, rrëfe dhe pendohu"? Ne pranojmë që kemi mëkatuar, ia rrëfejmë Perëndisë dhe pendohemi – kthehemi nga bërja e gjërave siç na pëlqen ne, te bërja e gjërave siç i pëlqen Perëndisë. Sidoqoftë, Jezusi nuk po u mësonte vetëm kaq. Le të shohim se çfarë tjetër donte Ai që dishepujt e Tij dhe ne të mësojmë.

Jezusi na mëson të jemi shërbëtorë të përulur

Lexo Gjoni 13:12-17

Përmbledhje: A e dini se çfarë do të thotë të jesh i përulur? Kemi mësuar në mësimet paraardhëse për përulësinë. Do të thotë ta shohësh veten siç të sheh Perëndia, as më pak e as më shumë. Dikush ka thënë se, kur je vërtet i përulur, nuk mendon keq për veten, thjesht nuk mendon fare për veten. Pra, ti mendon për të tjerët në vend që të mendosh për veten. Këtë po bënte Jezusi kur me përulësi lau këmbët e dishepujve dhe u mësoi të lanin edhe ata këmbët e të tjerëve. Nëse Jezusi është udhëheqësi i jetëve tona, duhet të jemi të përulur dhe t'u shërbejmë të tjerëve siç bëri Ai. Mund të jetë e vështirë, por Ai vetë do të na ndihmojë. A ju kujtohet vargu nga "Mendo si duhet"? Kërkoju nxënësve të recitojnë 1 e Korintasve 15:58. Nëse nuk e dinë, ndihmoji ta mësojnë përmendsh në fund të mësimit.

Tani mendoni për këtë: Jezusi lau këmbët e të dymbëdhjetë dishepujve të Tij, apo jo? A e dini se kush përfshihej aty? Juda – dishepulli që do ta tradhëtonte. Jezusi i shërbeu me përulësi Judës, edhe pse e dinte shumë mirë se çfarë do të bënte.

Përfundimi

Jezusi është Udhëheqësi ynë, por Ai është një udhëheqës shërbëtor i përulur. Ai e përuli veten jo vetëm për të larë këmbët e pista të dishepujve, por për t'u rrahur, për t'u varë në kryq dhe për të vdekur për mëkatin tonë. Ai nuk e meritonte ndëshkimin tonë, ne e meritonim. Ai na tregoi se çfarë do të thotë vërtet përulësi. Në vend që të mendonte për Veten, Ai po mendonte për secilin prej nesh.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A ndihesh i përulur kur mendon për atë që bëri Jezusi? Mua më bën të ndihem i përulur. Duke ditur se çfarë shërbëtori i përulur është Jezusi, di gjithashtu se Ai mund të më ndihmojë të jem edhe unë një shërbëtor i përulur.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Referoju aktivitetit të "Kohës së zbulimit" dhe jepu disa shembuj nga e përditshmja se si mund të jenë shërbëtorë të përulur këtë javë. Kujtoju 1 e Korintasve 15:58 dhe se të qenët të përulur i lidh ata me këtë varg. Sfidoji nxënësit e shpëtuar të mendojnë se si mund të shërbejnë këtë javë. Kujtoju se shërbesa e përulur apo veprat e mira nuk na shpëtojnë, por kur shpëtohemi, duhet të shërbejmë për shkak se jemi mirënjohës që Jezusi na shërbeu neve!

Po sikur të mos i kesh kërkuar Jezusit të të falë dhe të marrë ndëshkimin e mëkatit tënd? Jezusi të shërbeu ty duke shkuar përulësisht në kryq, për të derdhur gjakun e Tij dhe për të marrë ndëshkimin dhe turpin e mëkatit tënd. A dëshiron t'i besosh Atij sot? *Mundësi për të shpallur Ungjillin dhe për të bërë ftesë për shpëtim duke përdorur "Librin pa fjalë".*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Cilat ishin dy gjërat e rëndësishme që dinte Jezusi, në mësimin që morëm sot? (Po afrohej koha e vdekjes së Tij dhe Juda do ta tradhëtonte)
2. Edhe pse Perëndia i kishte dhënë Jezusit fuqi mbi gjithçka, çfarë bëri Jezusi? (Ai u lau këmbët dishepujve)
3. Cili nga dishepujt nuk pranoi fillimisht që Jezusi t'i lante këmbët? (Pjetri)
4. Kur Jezusi tha se edhe një person i pastër ka nevojë të lajë këmbët, Ai nënkuptoi se edhe një person i shpëtuar duhet të bëjë çfarë? (Të pranojë me përulësi kur mëkaton)
5. Kur Jezusi lau këmbët e dishepujve, çfarë shembulli po u jepte atyre (T'u shërbejmë njerëzve me përulësi)
6. Përmend disa mënyra se si mund t'u shërbesh njerëzve me përulësi.
7. Përse duhet t'u shërbesh të tjerëve? (1 e Korintasve 15:58)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 6

Marku 14:12 – 15:47; Luka 22:31-34

Kupto si duhet:	Pjetri mohoi Jezusin.
Mendo si duhet:	"Sepse, unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson..." Romakëve 1:16a
Vepro si duhet:	Unë do të qëndroj me guxim për Jezusin.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt kur qëndroj me guxim për Jezusin.

PËRGATITU!

Edhe të rriturit, edhe fëmijët tundohen të kenë turp nga Jezusi. Madje, njëri nga vetë dishepujt e Jezusit e mohoi! Mirëpo, ashtu siç Jezusi përtëriu Pjetrin, Ai mund të na përtërijë neve kur dështojmë, dhe të na japë një mundësi tjetër për të shpallur me guxim përkushtimin tonë ndaj Tij. Ndërsa përgatitemi për këtë mësim, le të lutemi që Perëndia të na shfaqë fusha të jetës sonë ku duhet të jetojmë me guxim për Të.

Lutu: Lutu për çdo nxënës me emër. Kërkoji Perëndisë t'u japë siguri në Fjalën e Tij dhe në atë që Ai është, që të mos kenë turp. Lutu gjithashtu që Perëndia t'u japë një mik të mirë të krishterë, dikë që do të qëndrojë me ta kur besimi i tyre të sfidohet e të testohet.

Lexo: Marku 14:12 – 15:47; Luka 22:31-34
Shënim: Ka shumë pjesë nga Shkrimi që duhen lexuar ndërsa përgatitesh për këtë mësim rreth mohimit të Pjetrit, megjithatë është thelbësore të kuptohet konteksti i plotë i mësimit. Shumica e pasazheve do të parafrazohen gjatë mësimit.

Kupto si duhet: Pjetri mohoi Jezusin
Jezusi ua bëri të qartë dishepujve se do të tradhëtohej, do të vdiste dhe në ditën e tretë do të ringjallej, megjithatë dishepujt nuk e kuptuan. Në mënyrën e tij egoiste, Pjetri deklaroi një besnikëri të palëkundshme ndaj Jezusit, madje deri në vdekje, ndërsa Jezusi e përballi me të vërtetën. Para se gjeli të këndonte dy herë atë ditë, Pjetri do ta mohonte Jezusin tri herë. Megjithatë, Jezusi bëri edhe këtë premtim – Ai u lut që besimi i Pjetrit të mos mpakej dhe që Pjetri të kthehej për të forcuar vëllezërit. Kur parashikimi i Jezusit u bë realitet, Pjetri përjetoi agoninë e dështimit të tij. Kur ndodhi ringjallja e Jezusit, Pjetri përjetoi hirin e Shpëtimtarit të tij. Ndërsa kalojmë përmes Pashkës me Pjetrin, le të kujtohemi që me guxim të qëndrojmë të fortë për Jezusin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor:

- Ky mësim mbulon disa pasazhe të Shkrimit që kërkojnë parafrazim për shkak të kufizimit të kohës. Fokusi ynë është te sjellja e Pjetrit para dhe pas kryqëzimit dhe ringjalljes së Jezusit. Këtë javë do të studiojmë se si Pjetri ra dhe mohoi Jezusin. Në një nga mësimet e ardhshme do të mësojmë për sigurinë dhe përtëritjen që Jezusi i dha Pjetrit pas rënies. Te përvijimi gjen vargjet që duhen lexuar me intonacion.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

Për shkak të gjatësisë së mësimit, përdor objekte që e bëjnë sa më praktik.

1. Paraprakisht palos këmbët e tavolinave. Vendos bukë mbi tavolina dhe kërkoju nxënësve që, me qetësi, të ulen në tokë rreth tavolinave. Fik dritat dhe ndiz një llambë për të krijuar atmosferën e darkës së fundit. Pyeti nxënësit: "A ke turp për Ungjillin?" Shiko secilin nga nxënësit... dhe ndalo. Kur Jezusi ishte ulur në një tavolinë si kjo, ishte një person që mendonte se do të jetonte për Jezusin pavarësisht nga pasojat, por nuk e bëri. Më lejoni t'ju tregoj se ç'ndodhi... *Mësuesit duhet ta dinë mësimin dhe ta shpjegojnë si të ishin pjesë e Darkës së Fundit. Lexo herë pas here nga Bibla për të përforcuar pikat kryesore.*
2. Ndërkohë që shpjegon, nxirr objekte nga një kuti dhe vendosi objektet në tavolinë që t'i shohësh ndërsa flet. Ide për objektet: ujë (larja e këmbëve), një lule (kopshti), dymbëdhjetë figura LEGO (dishepujt), zbutës për buzët (puthja), batanije (gjumi), shpatë prej lodre (ushtarët), numrat 1, 2, 3 në ngjyrë të errët (mohimi), foto e një gjeli, një kryq, një kurorë me gjemba, etj.
3. Shkarko foto falas te faqja www.freebibleimages.org ose www.unfoldingword.org/sweet-publishing/ dhe ndërsa shpjegon vari diku si kronologji.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: A ke turp?

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e të jetuarit me **guxim** për Jezusin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Fletë punëdore ku shkruhet me shkronja të mëdha “UNË E DUA JEZUSIN!” bashkë me vargun nga “Mendo si duhet” (një fletë për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Alternativë: nëse doni t’i përdorni disa herë, mund t’i laminoni fletët
- Alternativë: kamera dhe printer



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Nxënësit do të bëjnë një poster me plastelinë duhe mbushur shkronjat me të.
2. Ndërkohë që nxënësit punojnë me posterat, tregoju disa mënyra se si mund të jetojnë me **guxim** për Jezusin – duke ftuar një shok në kishë, duke u bërë shok me dikë që nuk ka miq, duke u lutur për familjarët apo shokët që nuk e njohin Jezusin, duke folur për Jezusin në shkollë, etj. Thekso vargun nga “Mendo si duhet” që gjendet në fund të posterit.

Alternativë: Kërkoju nxënësve të ulen në tokë me posterat e përfunduar me plastelinë. Formo një zemër me posterat dhe thuaju fëmijëve të ulen pranë posterit të tyre. Bëju një foto nga lart. Mund t’i printoni fotot dhe t’ua jepni me vete. Sfidoji ta tregojnë foton në shkollë ose t’ua tregojnë miqve.

Aktiviteti 2: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Banderola të mëdhaja në letër tabak ku shkruhet “Ai është ringjallur!” me shkronja të mëdha (shkruaje para se të vijnë nxënësit, dhe gjithashtu, me një laps shkruaj lehtë në secilën shkronjë ngjyrën specifike me të cilën duhet mbushur; alternativë: mund të përdorësh më shumë se sa një ngjyrë për çdo shkronjë)
- Banderola të tjera shtesë sipas nevojës: kryq, varr bosh, Libri pa fjalë, Bibla
- Gota me bojëra në ngjyrat rozë, lejla dhe e gjelbër e hapur (për të ngjyrosur shkronjat)
- Furçë për pikturë

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Informoji nxënësit se këtë javë do të bëjmë një deklaratë të fortë për Jezusin. Nxënësit do të bëjnë një banderolë, që të gjithë të dinë se Jezusi është i vërtetë dhe i gjallë! Pyeti nëse u duket ide e mirë. Apo kanë turp?
2. Mbikëqyri ndërsa pikturojnë banderolat e mëdhaja që do t’i varin te dritaret, që njerëzit nga jashtë të shohin.
3. Ky është projekti i fëmijëve, ndaj ju lutem, drejtues, mos i ndihmoni.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Një listë me deklarata (i gjeni më poshtë) (burim i printueshëm)
- Zile
- Një vijë nisjeje dhe përfundimi (mjaftueshëm e gjatë që të gjithë të qëndrojnë njëri pas tjetrit; duhet të jenë 20 hapa larg – mund t'i caktosh vendet ku do të qëndrojnë me ngjitës ose konë; nxënësit lëvizin përpara kur u përgjigjen pyetjeve)
- Etiketa shpërblyese

Unë nuk kam turp për ungjillin... Romakëve 16Ga

1. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për sportin.
2. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për programin tim të preferuar.
3. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për filmin tim të preferuar.
4. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për kishën ku shkoj.
5. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për ushqimin që ha gjatë pushimit të madh.
6. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për marrëdhënien time me Jezusin.
7. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për një restorant tek i cili dua të shkoj.
8. Unë bëjmë me **guxim** pyetje për njësi shoki me mosnjohje.
9. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për njësi bëmçësi në vai bë kushtimet që kanë shkëputur.
10. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për zemërsiu sha shë shkoj rrëmet shoki me ndrrat.
11. Unë si mësues me **guxim** flisëim me shkollë, njësi mësuesi ka shokun mëhë mësojë si ma.
12. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për njësi mësuesie që mësojëpsim.
13. Unë flas me **guxim** me shokët e mi për mësuesat që dasun po mësojë ma mësëshë.
14. Unë lëngjëmëra me **guxim** ngja dëçkas e bamë që njësi shoki pra mësë lëngjas mësëshë.
15. Unë sa shpjegoj me **guxim** shokëshë pëlmë nuk bëçojëj mësëpasuna.
16. Unë sa shpjegoj me **guxim** shokëshë pëlmë nuk shoki fëlmë të pagëshëmjëshëm.
17. Unë i ëçj me **guxim** mësojë ta ëmëshëçëjna.
18. Unë i kam ëçua me **guxim** mësojë e ma mësëshë gjatë shë.
19. Unë i bëmëçj me **guxim** lëngjë e ëamëmë ma shokët, mësë i të mësë kushtëmëshë shëmëçëjna e ëbëmëshë.

Unë nuk kam turp për ungjillin... Romakëve 16Ga

Unë nuk kam turp për ungjillin... Romakëve 16Ga

Unë nuk kam turp për ungjillin... Romakëve 16Ga

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Rreshtoji nxënësit te vija e nisjes.
2. Thuaju: Sot do të bëjmë një "sondazh njerëzor", pra, të gjithë ju do të jeni pjesë e një eksperimenti që shqyrton se sa të guximshëm mund të jenë fëmijët sot.
3. Thuaju nxënësve se do t'u lexosh disa situata.
4. Nëse nxënësit e zbatojnë në jetën e tyre deklaratën, do të bëjnë një hap përpara. Inkurajoji të përgjigjen me sinqeritet. Shpjegoju se është sondazh e jo test. Të gjithë po mësojmë e po rritemi në besim.
5. Nëse nuk e zbatojnë zakonisht deklaratën në jetën e tyre, duhet të qëndrojnë te vendi ku janë.
6. Si fillim, lexoju nxënësve një nga deklaratat në listë dhe në bazë të përgjigjes ata mund të lëvizin përpara ose të qëndrojnë në vend.
7. Përsëriteni në varësi të kohës që keni në dispozicion, duke shtuar deklarata sipas nevojës, ose derisa të arrijë i pari te vija e përfundimit.
8. Për të inkurajuar përgjigjet e ndershme, etiketa shpërblyese nuk duhet t'i jepet nxënësit të parë që kalon në vijën e përfundimit. Folu për faktin se, të qenët i krishterë nuk ka të bëjë me fitimin e çmimeve... ka të bëjë me një mënyrë jetese që reflekton Jezusin pavarësisht pasojave.
9. Ja dhe deklaratat. Mund të shtoni pyetje që i sfidojnë nxënësit të mendojnë për besimin e tyre.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për sporte.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për programin tim të preferuar.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për filmin tim të preferuar.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për kishën ku shkoj.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për ushqimin që ha gjatë pushimit të madh.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për marrëdhënien time me Jezusin.
   - Unë flas me **guxim** me shokët e mi për një restorant tek i cili dua të shkoj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Unë lutem me **guxim** për një shok në nevojë.
- Unë flas me **guxim** me shokët e mi për një këngë të re të krishterë që kam dëgjuar.
- Unë flas me **guxim** me shokët e mi për vendin ku dua të shkoj nëse do të vdes.
- Unë e marr me **guxim** Biblën në shkollë, që të mund ta shohin edhe miqtë e mi.
- Unë flas me **guxim** me shokët e mi për një mësues/e që më pëlqen.
- Unë flas me **guxim** me shokët e mi për mësimet që Jezusi po më jep në kishë.
- Unë largohem me **guxim** nga diçka e keqe që një shok po më tregon në telefon.
- Unë ua shpjegoj me **guxim** shokëve përse nuk kopjoj në provim.
- Unë ua shpjegoj me **guxim** shokëve përse nuk shoh filma të papërshtatshëm.
- Unë i ftoj me **guxim** miqtë te festa ime e ditëlindjes.
- Unë i kam ftuar me **guxim** miqtë e mi në kishë gjatë vitit.
- Unë i këndoj me **guxim** këngët e famshme me shokët, teksti i të cilave kundërshton standardin e Perëndisë.
- Unë këndoj me **guxim** përpara shokëve këngë të krishtera.

10. Në mes të KZ-së, bjeri një zileje dhe thuaju nxënësve të "ngrijnë".
11. Thuaj: Nëse ke gënjyer te ndonjëra nga përgjigjet, bëj dy hapa mbrapa. Shpresojmë që nxënësit të kenë thënë të vërtetën, megjithatë, nëse dikush nuk ka treguar të vërtetën, do të duhet shumë guxim për të vepruar siç duhet. (Mësuesi kryesor: Kjo është një çështje e mirë për t'u theksuar edhe gjatë mësimit.)
12. Në fund pyeti: Përse ishte e vështirë, ose përse ishte e thjeshtë, të tregoheshit të ndershëm gjatë këtij "sondazhi"? Jepu etiketa shpërblyese atyre që japin përgjigje të sinqerta.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Kur ka qenë hera e fundit që i ke folur dikujt për Jezusin? Me sa guxim flet për Perëndinë kur nuk je në kishë? A je i guximshëm për besimin tënd, apo ke turp dhe frikë prej tij? Sot do të mësojmë për një person që mendonte se ishte i guximshëm për të folur për Jezusin, por guximi iu shua kur ishte nën trysni.

Lutu: *Jepi mundësinë njërit prej nxënësve ta nisë mësimin me lutje; kjo inkurajon udhëheqësinë frymërore. Kujtoju se, kur lutemi, flasim me Perëndinë.*

Zbuloje: Sot do t'i hapim Biblat te libri i Markut, kapitulli 14. A gjendet Marku në Dhiatën e Vjetër apo në të Renë? (Dh.R.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: *Kërkoju të gjejnë vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit në kronologji, dhe shpjegoju se ngjarjet në mësimin e sotëm, ndodhën pikërisht para tyre.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: A ju kujtohet se çfarë është një profeci? (Kur Perëndia na tregon diçka që do të ndodhë në të ardhmen) Perëndia i jep profecitë përmes njerëzve të quajtur profetë. Siç e mësuam javën e kaluar, Jezusi e dinte se do të vdiste në kryq. Para se të shkonte në kryq, u dha dishepujve disa profeci. Njëra prej tyre ishte që Juda do ta tradhëtonte. Ndërsa sot do të mësojmë për disa profeci të tjera shumë të rëndësishme që Jezusi dha për dishepujt, sidomos për Simon Pjetrin.

Përvijimi i Shkrimit: Marku 14:12 – 15:47; Luka 22:31-34

Jezusi profetizon se dishepujt do të shpërndaheshin dhe se Simon Pjetri do ta mohonte

Parafrazim i Markut 14:12-26:

Dishepujt ishin miqtë më të ngushtë të Jezusit në tokë. Jezusi i donte dishepujt e Tij. Ai i mësoi, i mbrojti, dhe siç mësuam edhe javën e kaluar, Ai madje u lau edhe këmbët me përulësi. Mirëpo ishte afruar koha kur Jezusi duhej të kryqëzohej për mëkatet tona. Kjo do të ishte shumë e vështirë për dishepujt e Jezusit. Jezusi foli me ta që t'i përgatiste për kohët e vështira që i prisnin. Le të lexojmë se çfarë tha Jezusi.

Lexo Marku 14:27-28

Përmbledhje: Jezusi u tha dishepujve se ata do shpërndaheshin e do të iknin prej Tij. Simon Pjetri e donte Jezusin dhe besonte se ishte Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtari. Mirëpo Pjetri kishte për zakon të keq që të mbështetej te mençuria e vet e jo te Jezusi. Këtë e pamë edhe kur Jezusi donte t'i lante këmbët Pjetrit. Në vend që t'i bindej Jezusit, Pjetri e kundërshtoi. Dëgjoni se çfarë i tha Jezusi Pjetrit.

Lexo Luka 22:31-32 *(ngjarja paralele te Marku 14:29-31)*

Përmbledhje: Edhe pse Pjetri besonte në Jezusin si Shpëtimtari i Tij, Satani do ta sprovonte. Jezusi i tha Pjetrit se ai nuk do të qëndronte me guxim për Të – Ai nuk do të qëndronte me Jezusin. Jezusi u lut që Pjetri të kishte besim. Ja se çfarë i tha Pjetri Jezusit:

Lexo Luka 22:33

Përmbledhje: Pjetri vazhdonte të mendonte se do të ishte një dëshmitar i guximshëm i Jezusit, madje deri në vdekje. Pastaj Jezusi i jep Pjetrit këtë profeci:

Lexo Luka 22:34

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusi lutet, por dishepujt flenë

Parafrazim i Markut 14:32-42:

Pasi Jezusi përfundoi së foluri me dishepujt, shkuan në kopshtin e Gjetsemanisë, ku Ai fliste me Atin e Tij Qiellor. Jezusi mori Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin me vete dhe u tha të ruanin dhe të luteshin, duke i kërkuar Perëndisë t'i ndihmonte. Ai u kthye tri herë për të parë Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin. A mendoni se ata po ruanin dhe po luteshin, siç u kishte thënë Jezusi? (Jo!) Çfarë mendoni se po bënin? (Ata po flinin!) Pastaj, krejt papritur...

Juda tradhëton Jezusin dhe Jezusi arrestohet

Parafrazim i Markut 14:43-52:

Juda erdhi me një turmë njerëzish për ta arrestuar Jezusin. Ai e puthi Jezusin për t'ua treguar të tjerëve se cili nga ata ishte; Juda e tradhëtoi. Pastaj ata e morën Jezusin. A e gjeni dot se çfarë bënë dishepujt? (Të gjithë ia mbathën)

Stop! Ndoshta po mendojmë se sa frikacakë u treguan dishepujt, megjithatë, mendo pak veten tënde. Kur je në shkollë, në ngjarje sportive, në shtëpinë e një shoku, a e tradhëton ndonjëherë Jezusin? Ndalu dhe jepu mjaftueshëm kohë nxënësve ta mendojnë këtë pyetje.

Kur gjendemi në këto situata, duhet të mendojmë siç duhet, duke u përqendruar te Romakëve 1:16. *Kërkoju ta gjejnë vargun në Bibël. Njëri nga nxënësait le ta lexojë me zë.*

Jezusi paraqitet para Sinedrit

Parafrazim i Markut 14:53-65:

Jezusin e çuan para kryepriftit jude, dhe Pjetri e ndoqi nga larg për të parë ç'ndodhte. Ata e pyetën Jezusin nëse Ai ishte Biri i Perëndisë dhe Ai u tha se ishte. Për shkak se ata nuk besonin se Jezusi po thoshte të vërtetën, kërkuan që Ai të vdiste. Kujtoni se Jezusi nuk kishte bërë as edhe një gjë të gabuar, megjithatë shumë prej udhëheqësve judenj donin ta vrisnin. Ata e pështynë, ia lidhën sytë dhe e rrahën.

Pjetri e mohon Jezusin tri herë para se gjeli të këndonte dy herë

Parafrazim i Markut 14:66-72:

Gjatë gjithë kësaj, Pjetri qëndronte në oborrin e kryepriftit, duke u ngrohur pranë zjarrit për shkak se ishte ftohtë. Disa prej njerëzve që ishin aty me Pjetrin e njohën se ai ishte njëri nga dishepujt e Jezusit. Pjetri tha tri herë se nuk e njihte Jezusin. A po gënjente Pjetri kur tha se nuk e njihte Jezusin? (Po) A e gjeni dot se ç'ndodhi herën e tretë kur Pjetri tha se nuk e njihte Jezusin? (Gjeli këndoi dy herë) Çfarë ndodhi tjetër? (Jezusi pa drejtpërdrejt Pjetrin!) Ua! Gjithçka ndodhi siç kishte thënë Jezusi. Pjetri kujtoi gjithçka që Jezusi kishte

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

profetizuar. Pjetri ishte aq i trishtuar për atë që kishte bërë, saqë doli jashtë dhe qau me hidhërim.

Ndaluni. Rrini për pak kohë në heshtje. Sfidoji nxënësit të reflektojnë mbi jetën e tyre, nëse e kanë mohuar ndonjëherë Jezusin.

Pilati e dënon Jezusin me vdekje dhe ushtarët e tallin dhe e rrahin

Parafrazim i Markut 15:1-20:

Udhëheqësit fetarë judenj e dërguan Jezusin te guvernatori romak i quajtur Pilat. Shumë nga judenjtë kërkuan me britma që Jezusi të kryqëzohej, kështu Pilati u dha urdhër ushtarëve. Fillimisht ata e fshikulluan Jezusin. Pra, e rrahën me kamxhikë. Pastaj, i veshën një mantel të purpurt dhe një kurorë me gjemba dhe e goditën në kokë me shkop, e pështynë dhe e tallën.

Jezusi kryqëzohet dhe varroset

Parafrazim i Markut 15:21-47:

Ata e morën Jezusin dhe e kryqëzuan. Të gjitha këto ishin ndëshkime që ne i meritojmë për shkak të mëkatit. A e imagjinon sikur të t'i bënin ty këto gjëra? Jezusi e mori këtë ndëshkim për ne.

Përfundimi

Gjithçka ndodhi pikërisht siç kishte thënë Jezusi. Edhe pse dishepujt i besonin Jezusit, kur situata u vështirësua, ata u shpërndanë dhe e lanë Jezusin vetëm. Pjetri gënjeu tri herë dhe tha se as që e njihte Jezusin! Imagjino si është ndier Jezusi, ndërkohë që merrte ndëshkimin që të gjithë ne meritojmë. Kjo është një pjesë shumë e trishtë e historisë, por nuk është fundi! Jezusin e varrosën dhe e dini se çfarë ndodhi? Tri ditë më vonë, Jezusi u ringjall dhe është i gjallë edhe tani. Në dy javët e ardhshme do të zbulojmë më shumë se si u ringjall Jezusi. A ju kujtohet se Jezusi i tha Pjetrit se ishte lutur për të? Do të mësojmë edhe se ç'ndodhi me Jezusin dhe Pjetrin. Nuk duhet ta humbisni!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Shumë prej nesh besojnë te Jezusi, njësoj si dishepujt. Megjithatë, ndonjëherë jemi si Pjetri. Trembemi ose kemi turp t'u tregojmë njerëzve se e njohim Jezusin dhe se besojmë tek Ai si Zoti dhe Shpëtimtari ynë. Në vend që t'u tregojmë të tjerëve për Jezusin, tërhiqemi dhe nuk e tregojmë të vërtetën. A e dini se Jezusi lutet për ne siç u lut për Pjetrin? *(Gjoni 17:20-26)* Kur ne besojmë tek Ai për të shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit, Ai na jep Frymën e Tij të Shenjtë që të jetë me ne dhe të na ndihmojë. Nëse mësojmë të varemi te Jezusi kur kemi frikë, Ai do të na ndihmojë të ndihemi të guximshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Nëse nuk e ke kuptuar kurrë se përse Jezusi vdiq në kryq, por tani e kupton dhe dëshiron që Ai të falë mëkatin tënd dhe të të shpëtojë nga ndëshkimi, a dëshiron të flasim tani? *Mundësi për të ndarë Ungjillin përmes Librit pa fjalë dhe për të bërë ftesë për ta pranuar Atë si Shpëtimtar.* Le të lutemi!

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë tha Jezusi se do të bënin dishepujt? (Ata do të shpërndaheshin dhe do ta linin)
2. Çfarë do të bënte Pjetri para se gjeli të këndonte dy herë? (Ai do të gënjente tri herë se nuk e njihte Jezusin)
3. Çfarë bënë dishepujt kur u arrestua Jezusi? (Ata u shpërndanë dhe e lanë Jezusin vetëm)
4. Çfarë bëri Pjetri kur njerëzit i thanë se ai ishte njëri nga dishepujt e Jezusit? (Ai gënjeu tri herë para se gjeli të këndonte dy herë)
5. Çfarë bëri Jezusi për të ndihmuar Pjetrin? (Ai u lut që besimi i Pjetrit të mos mpakej dhe që, kur të kthehej te Jezusi të forconte dishepujt e tjerë)
6. Si u ndie Pjetri pasi gënjeu për Jezusin? (Ai ishte shumë i trishtuar, doli jashtë dhe qau me hidhërim)
7. A do t'u tregosh me guxim të tjerëve se beson në Jezusin? Përse po ose jo?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 7

Marku 16:1-8; Gjoni 20:2-10, 20:19-20, 21:1-17

Kupto si duhet:	Jezusi iu shfaq dishepujve dhe të tjerëve.
Mendo si duhet:	"...dhe se u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve, dhe se iu shfaq Kefës, pastaj të Dymbëdhjetëve." 1 e Korintasve 15:4b-5
Vepro si duhet:	Unë do të di se Jezusi e vërtetoi se është i gjallë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt sepse e di që Jezusi është gjallë.

PËRGATITU!

A nuk është inkurajuese të dish se Shpëtimtari u ringjall fizikisht? Jezusi mposhti mëkatin dhe vdekjen dhe Ai është i gjallë! Në mësimin e kësaj jave do të zbulojmë provat që vërtetojnë se Jezusi është gjallë. Ndërsa lexon pasazhet nga Shkrimi dhe mësimin, reflekto se si kjo e vërtetë mund të të japë shpresë e guxim si i krishterë.

Lutu: Lutu që nxënësit e tu të gjejnë gëzim ndërsa mësojnë e festojnë për shkak se Jezusi është gjallë. Kërkoji Perëndisë të largojë çdo shpërqendrim dhe t'i mbushë fëmijët me gëzimin e Jezusit. Lutu specifikisht që ata ta njohin Jezusin në një mënyrë që do të ketë ndikim për gjithë jetën.

Lexo: Marku 16:1-8; Gjoni 20:2-10, 20:19-20, 21:1-17

Kupto si duhet: Jezusi iu shfaq dishepujve dhe të tjerëve
Pasi Jezusi vdiq dhe u ringjall, Pjetri dhe dishepujt e tjerë panë me sytë e tyre që Jezusi ishte gjallë, sërish në formë njerëzore. Provat vërtetuan se Ai ishte i gjallë: Ai hëngri, bisedoi, eci dhe bëri mrekulli. Nuk ka dyshim se Ai e mposhti mëkatin dhe vdekjen, prandaj ne mund të dimë me siguri se Jezusi dha prova se është i gjallë.

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor: Ky mësim është shkruar për të theksuar periudhën kohore pas ringjalljes së Jezusit, ndërkohë që Ai ecte në tokë, para ngjitjes në qiell. Është thelbësore që nxënësit të kuptojnë se ka prova që na vërtetojnë se Jezusi u ringjall. Bazuar në studimet e mëparshme dhe në provat historike, nxënësit duhet ta dinë se Bibla është e vërtetë. Sot do të zbulojmë provat që Jezusi dha në Bibël për të vërtetuar se ishte fizikisht gjallë, në trup njerëzor, pas vdekjes dhe ringjalljes.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Ndërsa shpjegon mësimin, thuaju nxënësve të bëhen detektivë dhe të dëgjojnë me vëmendje për të kuptuar provat që vërtetojnë se Jezusi u ringjall në formë njerëzore. Alternativë: Kërkoju nxënësve të ngrihen në këmbë, ose të ngrenë dorën, sa herë që dëgjojnë një provë.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Kam prova!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kërkojnë **prova** dhe të mendojnë si detektivë.

Alternativa 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Bojëra që lahen, në ngjyra të ndryshme
- Fletë punëdore ku shkruhet me shkronja të mëdha "Jezusi është i gjallë!" (burim i printueshëm)
- Xham zmadhues (nga një për çdo nxënës) (jo i domosdoshëm)
- Lapsa (një për çdo nxënës)
- Letra të lagura
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi çdo nxënësi një fletë punëdore.
2. Qëllimi për secilin është të marrë shenjën e gishtit të të gjithëve, brenda shkronjave të mëdha. Personi i parë që merr shenjën e gishtit të gjithë të tjerëve, fiton pesë etiketa shpërblyese.
3. Kur njëri nga nxënësit të thotë se i ka marrë të gjitha shenjat e gishtërinjve, thuaji se për të shpallur fituesin na duhen **prova**.
4. Jepi çdo nxënësi nga një laps. Thuaju të gjejnë shenjën e tyre te posteri i fituesit dhe pranë të shënojnë inicialet. Ngjyrat e ndryshme dhe xhamat zmadhues i ndihmojnë të identifikojnë shenjën e tyre.
5. Po të keni kohë, thuaju t'i mbushin shkronjat e punëdores së tyre me shenja gishtërinjsh në ngjyra të ndryshme.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Alternativa 2: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Kuti plasteline boshe (plastelinën vendoseni në qese apo kosha të tjerë)
- Mjete për të punuar plastelinën
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Stacioni i plastelinës duhet të duket si një vend gati për aktivitet dhe kutitë e plastelinës, që në fakt janë boshe, duhen grupuar sipas ngjyrave (çdo skuadre me rreth tetë nxënës, duhet t'i caktohet një ngjyrë plasteline). Krijo shtigje me copëza plasteline sipas ngjyrave specifike të skuadrave. Copëzat duhet të jenë të vogla, të shpërndara në mënyrë sporadike dhe duhet të çojnë te plastelina (që gjendet në qese apo kuti të tjera), e cila duhet të jetë e fshehur pas diçkaje apo nën diçka. Shënim: është shumë e rëndësishme që aktiviteti të jetë entuziazmues dhe sfidues. Shtegu duhet të jetë paksa i vështirë për t'u ndjekur dhe duhet të kërkojë punë në grup.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra, me jo më shumë se tetë nxënës secila. Secila skuadër duhet të ketë një ngjyrë specifike. Të gjithë duhet të ulen nëpër tavolina pa prekur asgjë.
2. Informoji nxënësit se duhet të krijojnë bukë, një peshk dhe një varkë me ngjyrën specifike të skuadrës. Do të kenë dhjetë minuta kohë dhe duhet të punojnë si skuadër. Sa më shumë detaje të kenë objektet, aq më tepër gjasa kanë për të fituar.
3. Thuaju të fillojnë. Kur të hapin kutitë e plastelinave do të kuptojnë se nuk ka plastelinë brenda tyre.
4. Thuaj: "Oh, pa prisni! Duhet të bëni edhe diçka tjetër para se të fillojmë... duhet të bëheni detektivë! Që të gjurmoni plastelinën e munguar, duhet të mendoni si detektivë dhe së bashku të kërkoni të dhëna".
5. Nxënësit duhet të shohin shtegun e copëzave të plastelinës që përkon me ngjyrën e skuadrës së tyre. Ata duhet të ndjekin shtegun e tyre për të gjetur plastelinën e fshehur.
6. Kur të gjendet plastelina, skuadra duhet të nxitojë për të formuar tre objektet.
7. Pasi të përfundojë koha, vlerëso produktet e përfunduara dhe jepu anëtarëve të skuadrës fituese nga tre etiketa shpërblyese.
8. Thuaj: Për të fituar edhe pesë etiketa shpërblyese, kam një tjetër mister për ju. A mund t'i përdorni të dhënat për të zbuluar se cili nga drejtuesit e ka fshehur plastelinën e skuadrës tuaj? Ndërsa nxënësit sugjerojnë emra, pyeti: "A keni ndonjë **provë**?" *Thuaju të kërkojnë prova dhe të vendosin se cili drejtues e fshehu plastelinën. Shënim: Drejtuesi që fshehu plastelinën duhet të ketë copëza plasteline në ngjyra të ndryshme te këpucët.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 3-të, tremujori i 3-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Çfarë ndodhi gjatë "Kohës së zbulimit" sot? A zbuluat ndonjë të dhënë apo gjetët ndonjë provë për diçka? A ishte e thjeshtë apo e vështirë? Në mësimin e sotëm do të zbulojmë se Jezusi u ringjall. Mirëpo, si ta dimë se është e vërtetë? Le të mendojmë si detektivë dhe të kërkojmë prova.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, bëni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta nisë mësimin me lutje. Inkurajoje të adhurojë Zotin ndërsa lutet, duke shprehur mirënjohjen për ringjalljen e Shpëtimtarit tonë.*

Zbuloje: Mësimi i sotëm nga Bibla vjen nga libri i Markut, kapitulli 16 dhe Gjoni kapitujt 20 dhe 21. Këta libra gjenden në Dhiatën e Re. Përgatituni për t'i gjetur ndërsa zbulojmë provat që na tregojnë se Jezusi u ringjall dhe iu shfaq shumë njerëzve.

Kronologjia: A e gjeni dot se te cila figurë e kronologjisë gjendemi sot? *Kërkoju nxënësve të drejtohen atje.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të bëjmë një përsëritje të shpejtë. E diela e palmave është dita kur Jezusi hyri në Jerusalem mbi një gomar dhe njerëzit bërtisnin: "Hosana! I bekuar është ai që vjen në emër të Zotit! I bekuar mbreti i Izraelit!". Ata po adhuronin Jezusin, pra, ata po i tregonin se sa i çmuar ishte Ai. Mirëpo, disa ditë më vonë, diçka shkoi keq. Njerëzit bërtitën: "Kryqëzojeni!" dhe Pilati e dënoi Jezusin me vdekje në kryq. Çfarë ndodhi? Si mund të kalonin njerëzit nga adhurimi i Jezusit te urrejtja ndaj Tij? Si ndryshuan mendje? Edhe Pjetri, ai që e donte aq shumë Jezusin, e mohoi atë tri herë duke thënë se nuk e njihte.

Në të premten e mirë, ne kujtojmë se Jezusi vdiq në kryq. Mirëpo, a mbeti Jezusi i vdekur? (Jo!) Pashka është dita kur festojmë ringjalljen e Jezusit. Ai mposhti vdekjen dhe mëkatin! Sot do të shohim edhe njëherë Simon Pjetrin, ndjekësin dhe mikun e afërt të Jezusit, ai që tha se nuk e njihte Jezusin. Ai tha se nuk e njihte Jezusin jo një herë, as dy, por *tri* herë. Le të zbulojmë se çfarë ndodhi me të pasi Jezusi u ringjall.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Marku 16:1-8; Gjoni 20:2-10, 20:19-20, 21:1-17

Jezusi ringjallet

Lexo Marku 16:1-8

Përmbledhje: Gratë që shkuan te varri i Jezusit e donin dhe donin të kujdeseshin për trupin e Tij. A ishte Jezusi në varr kur ato mbërritën atje? (Jo) Kush ishte atje? (Një engjëll) Çfarë u tha engjëlli grave? (Jezusi ishte ringjallur!) Kjo quhet ringjallje. A nuk është e mrekullueshme? Jezusi është aq i fuqishëm saqë mposhti vdekjen! Po të kishte mbetur i vdekur, nuk do të mund të na shpëtonte nga mëkati. Mirëpo, Ai nuk mbeti i vdekur; Ai u ringjall!

Engjëlli u dha grave një punë të rëndësishme, që t'u tregonin të tjerëve se çfarë kishte ndodhur. Kujt duhet t'u tregonin fillimisht gratë për ringjalljen e Jezusit? (dishepujve të Jezusit dhe Pjetrit) Hm... ato duhet të shkonin te dishepujt – që ia kishin mbathur dhe e kishin lënë Jezusin vetëm, dhe *te Pjetri* – ai që gënjeu tri herë dhe tha se nuk e njihte Jezusin. Interesante! Pyes veten se përse vallë engjëlli donte që gratë t'u tregonin atyre. Le ta zbulojmë. Do të lexojmë Gjonin 20:2.

Maria Magdalena i tregon Pjetrit dhe Gjonit për ringjalljen e Jezusit

Lexo Gjoni 20:2-10

Përmbledhje: Thuhet se Pjetri vrapoi te varri dhe u fut brenda. Ai vërtet donte të dinte se çfarë kishte ndodhur me Jezusin, dhe do ta zbulonte shumë shpejt! Pjetri po kërkonte prova. Ku ishte Jezusi? Dishepujt u kthyen të hutuar në shtëpi, duke mos kuptuar se çfarë kishte ndodhur.

Jezusi iu shfaq dishepujve

Lexo Gjoni 20:19-20

Përmbledhje: Po të ishe një nga dishepujt, dhe ta shihje Jezusin për herë të parë pas vdekjes në kryq dhe varrosjes, si do të ndiheshe? Çfarë do të bëje? Si mendon se u ndie Pjetri? Përse mendoni se Jezusit iu desh t'u tregonte dishepujve duart dhe brinjët? Përse është kjo provë që vërteton se Jezusi ishte vërtet gjallë? Le të vazhdojmë leximin për të zbuluar se çfarë bëri tjetër Jezusi pasi u ringjall.

Jezusi ha dhe flet me dishepujt

Lexo Gjoni 21:1-14

Përmbledhje: Jezusi foli me Pjetrin dhe dishepujt e tjerë, dhe bëri mrekulli, siç ishte kapja e shumë peshqve nga dishepujt. Padyshim që Jezusi ishte ringjallur e kishte fituar mbi vdekjen. Dhe ne e dimë se ai u ringjall në trupin e Tij fizik, njerëzor, për shkak se libri i Lukës na thotë se Jezusi vetë hëngri

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

peshk. *Shih Luka 24:36-43*. Një shpirt/frymë nuk ka nevojë të hajë! Ishte i njëjti Jezus, në formë njerëzore, që kishte vdekur në kryq – jo thjesht shpirti i Tij! Te vargjet nga "Mendo si duhet", 1 e Korintasve 15:4b-5, si dhe në vargun 6, shohim më tepër prova – fakte që vërtetojnë se Jezusi është gjallë. *Lexo 1 e Korintasve 15:4b-6.*

Jezusi përtërin Pjetrin

Lexo Gjoni 21:15-17

Përmbledhje: Jezusi i dha Pjetrit një mundësi për t'i treguar se vërtet donte ta ndiqte. Pastaj Jezusi e sfidoi të shkonte dhe t'u tregonte të tjerëve për Të.

Përfundimi

Çfarë duhet t'u tregonte Pjetri të tjerëve? Jezusi i tha Pjetrit të shkonte dhe t'u tregonte njerëzve se sa shumë i do Perëndia, që Ai do që të jenë pjesë e familjes së Tij dhe se Ai krijoi një vend të jashtëzakonshëm për ta në qiell. *Trego faqen e artë të "Librit pa fjalë".* Qielli është një vend i përsosur ku nuk ka mëkat. Tingëllon si diçka e mrekullueshme, apo jo? Mirëpo, ka një problem të madh. Romakëve 3:23 thotë se të gjithë kemi mëkatuar. *Trego faqen e errët.* Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë kundër Perëndisë. Ndëshkimi për mëkatin është të mos shkuarit në qiell e të mos qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Ky është lajmi i keq; mirëpo ka Lajm të Mirë! Perëndia na deshi aq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij të vetëm, të përsosur, Jezusin, që të vdiste në kryq për mëkatin tonë. *Trego faqen e kuqe të librit.* Sapo mësuam se Ai nuk mbeti i vdekur! Ai u ringjall dhe tani është në qiell, duke përgatitur një vend për ata që besojnë tek Ai. Jezusi fitoi mbi vdekjen! Nëse pranojmë se kemi mëkatuar, dhe besojmë se Jezusi vërtet vdiq për ne, mund të shpëtojmë nga ndëshkimi i mëkatit dhe të nisim një jetë të re me Perëndinë si Ati ynë qiellor. Veprat 16:31 na thotë se po të besojmë, do të shpëtohemi. *Trego faqen e bardhë.*

Pyetja e rëndësishme për sot është: A e ke pranuar dhuratën falas nga Perëndia? A i ke treguar Jezusit se ke mëkatuar dhe a i ke kërkuar të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit? Kjo është një zgjedhje që të takon vetëm ty; askush nuk e merr dot vendimin për ty. Është një vendim që do të ta ndryshojë jetën përgjithmonë! Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të flasësh me një nga drejtuesit pas mësimit.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Nëse tashmë e ke marrë vendimin për t'i besuar Jezusit, Perëndia është Ati yt qiellor. Ai ka një plan të jashtëzakonshëm për ty dhe të do përtej imagjinatës sate. Kemi mësuar nga Bibla sot se ka prova që vërtetojnë se Jezusi është gjallë! Le të vendosim të jemi të guximshëm dhe t'u tregojmë të tjerëve Lajmin e Mirë të Jezusit me bindje dhe siguri.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë u kishte thënë Jezusi dishepujve se do të ndodhte në ditën e tretë pas vdekjes së Tij? (Ai do të ringjallej)
2. Çfarë bëri Jezusi në ditën e tretë pas vdekjes? (Ai u ringjall)
3. Kush e pa Jezusin pasi u ringjall? (Pjetri, dishepujt dhe mbi 500 besimtarë të tjerë)
4. Çfarë bëri Jezusi për të treguar se ishte ringjallur dhe se ishte i gjallë vërtet? (Ai hëngri peshk, foli me dishepujt e Tij, varri ishte bosh, u tregoi dishepujve shenjat, bëri mrekulli)
5. A beson se Jezusi është i gjallë edhe sot?
6. Si mund t'ua tregosh të tjerëve këtë Lajm të Mirë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 8
Veprat 1:1 – 2:4

Kupto si duhet:	Jezusi ngjitet në qiell dhe nis epoka e kishës.
Mendo si duhet:	"Zemra juaj mos u trondittë; besoni në Perëndinë dhe besoni në mua! Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj të përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis një vend, do të kthehem përsëri dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju." Gjoni 14:1-3
Vepro si duhet:	Unë do të jem gati për t'iu bindur Jezusit.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem besnik kur jam gati për t'iu bindur Jezusit.

PËRGATITU!

Të jetuarit e një jete në bindje ndaj Jezusit do të thotë se duhet të jemi të vëmendshëm e të përgatitur për momentet kur Ai të na japë mundësinë për t'iu bindur. Këtë javë do të shohim se si dishepujt dëgjuan mësimet dhe premtimet e Jezusit dhe pastaj morën iniciativën për t'u bindur kur erdhi koha për epokën e kishës. Ndërsa përgatitemi këtë javë, le të lutemi që Perëndia të na shfaqë mundësitë për t'u bindur dhe që ne të jemi gati për ato mundësi.

Lutu: Lutu që fëmijët të kenë dëshirën për t'iu bindur Jezusit dhe që mësimi i sotëm t'i inkurajojë të gjejnë mënyra për të qenë gati për bindje. Lutu gjithashtu për të pashpëtuarit që ke në klasë – duhet të kemi një marrëdhënie shpëtuese me Jezusin para se të mund t'i bindemi Atij; lutu që sytë e tyre të jenë të hapur dhe që ata të dorëzohen me bindje dhe dëshirë te Jezusi si Zoti dhe Shpëtimtari i tyre.

Lexo: Veprat 1:1 – 2:4

Kupto si duhet: Jezusi ngjitet në qiell dhe fillon epoka e kishës
Jezusi kaloi 40 ditë në tokë pas ringjalljes, duke mësuar dishepujt dhe duke i përgatitur për çfarë do të vinte. Para se të ngjitej në qiell, Jezusi u dha një premtim dhe një mision të fundit. Ai premtoi se Fryma e Shenjtë do të vinte e do t'i pajiste, që të bëheshin dëshmitarë dhe të shpallnin Ungjillin nëpër botë. Mirëpo fillimisht dishepujt duhej të përgatiteshin. Pasi Jezusi u ngjit në qiell, dishepujt u bindën. Ata u kthyen në Jerusalem dhe u përgatitën për të qenë dëshmitarë. Shembulli i tyre na tregon se mund <u>të jemi gati për t'iu bindur Jezusit.</u>

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Qëllimi është t'u mësojmë nxënësve se dëshira jonë për t'iu bindur Perëndisë rrjedh nga marrëdhënia jonë me Të. Ne "Veprojmë si duhet" sepse ne "Kuptojmë si duhet". Dishepujt ishin gati të bindeshin, sepse kishin një marrëdhënie me Jezusin.
- Vazhdo t'i nxitësh nxënësit të luten për të nisur takimin. Kjo i ndihmon, tani dhe në të ardhmen, që të luten para njerëzve.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Ndërsa lexon pasazhin nga Shkrimi, shëno në tabelë një listë me premtimet, urdhërimet dhe mënyrat se si u përgatitën dishepujt.
2. Kërkoju ndihmësve të lexojnë me intonacion pjesët e dialogut.
3. Rregulloje ambientin e klasës si të ishte një takim i kishës së hershme në shtëpinë e dikujt, ndërkohë që ti rrëfen ngjarjet. Mund të vendosësh jastëkë nëpër klasë, t'i ulësh nxënësit në dysheme, etj.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: A jeni gati?

Qëllimi: T'u japim nxënësve mundësinë për t'u **përgatitur** dhe për të **qenë gati**.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Furça të pista
- Kova me ujë (për të larë furçat e pista)
- Bojëra dhe paleta boje
- Copëza letrash me ngjyra, fleta me ngjyra dhe kartonë të bardhë (të gjitha së bashku)
- Gërshërë
- Ngjitës pluhur (i papërzier) dhe mjetet për përzierien (tasa, lugë, ujë)
- Mbulesa plastike për tavolinat

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Informoji nxënësit se sot do të bëhen artistë! Secili do të ketë mundësinë të përdorë një sërë materialesh për të bërë një kryevepër që përfaqëson qiellin dhe gjërat që atyre u kujtojnë qiellin.
2. Para se artistët të nisin punën, duhet të **përgatisin** mjetet. Tregoju nxënësve materialet e ndryshme me të cilat duhet të punojnë dhe shpjegoju se çfarë duhet **përgatitur** (furçat duhen larë, duhet përzier ngjitësi pluhur, bojërat duhen vënë te paletat e bojës, duhen ndarë letrat e vogla me ngjyra, duhen zgjedhur fletët me ngjyra, etj.).
3. Jepu pesë minuta kohë për të **përgatitur** mjetet.
4. Kur nxënësit të jenë **gati**, mund të fillojnë punën me kryeveprën e tyre. Ndërkohë që ata punojnë, përsërit faqen e artë të "Librit pa fjalë" (Jezusi po **përgatit** një vend në qiell për ne).

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:



- Katër gota plastike
- Katër lugë
- Një kuti e vogël me përzierje pudingu që përgatitet në çast (kuti që ka 4 racione)
- Dy gota qumësh
- Katër biskota *Oreo* në një qese plastike
- Katër karamele *Haribo* në formë krimbash në një qese plastike
- Një tas për t'i përzier
- Një rrahës për përzierjen e përbërësve
- Një lugë e madhe për ta shpërndarë pudingun nëpër gota
- Një thikë plastike për të prerë karamelet *Haribo*
- Objekte për t'u përdorur si shpërqendrim (miell, gota matëse, sheqer, copëza çokollate, pirunj, etj.)
- Një letër me recetën (burim i printueshëm)

Udhëzime për ambientin: Të gjitha mjetet dhe përbërësit e mësipërm, duhen vendosur në të njëjtën tavolinë për të gjitha skuadrat dhe duhen përzier. Secila skuadër duhet të përdorë recetën për të kuptuar se cilat objekte dhe përbërës duhet të marrë.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga katër anëtarë; secila skuadër duhet të ketë hapësirën e vet për të përgatitur mjetet.
2. Skuadrat duhet të përdorin recetën për të mbledhur mjetet dhe përbërësit e duhur nga tavolina e madhe dhe për t'i çuar te hapësira e skuadrës së tyre.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Brenda skuadrës, secili duhet të ketë një rol të rëndësishëm në **përgatitjen** e gjërave (përzierja e pudingut, thyerja e biskotave *Oreo*, prerja e karameleve *Haribo*, shpërndarja e gotave dhe lugëve). Ndërkohë që nxënësit punojnë, thekso rëndësinë e **përgatitjes** dhe ndjekjes me kujdes të recetës, që të mund të shijojnë gjërat e mira.
4. Të gjithë mjetet/përbërësit dhe ambienti duhen **përgatitur** para se të fillohet me mbushjen e gotës.
5. Pasi nxënësit t'i kenë **përgatitur** të gjithë përbërësit, mund të fillojnë mbushjen e gotave. Kur të përfundojnë, mund të shijojnë ushqimet.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 3-të, tremujori i 3-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Përgatitja paraprake ishte shumë e rëndësishme për "Kohën e zbulimit" sot. Si ia bëtë të funksionojë aktiviteti me skuadrën tuaj? Ftoji nxënësit për diskutim. Ka shumë gjëra për të cilat mund të përgatitemi në jetën tonë. A e dini se mund të përgatiteni për t'iu bindur Jezusit? Sot do të mësojmë se si disa nga ndjekësit e Jezusit, dishepujt, u përgatitën për t'iu bindur Atij.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, bëni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve ta nisë mësimin me lutje. Kujtoju se kur lutemi, po flasim me Perëndinë. Ai i dëgjon gjithmonë lutjet tona dhe i pëlqen kur i drejtohemi Atij në lutje.*

Zbuloje: Këtë javë do të drejtohemi te libri i Veprave të Apostujve! A gjendet ai në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh.R.) Veprat e Apostujve është libri në Bibël që dokumenton se çfarë ndodhi pasi Jezusi u ringjall dhe filloi epoka e kishës.

Kronologjia: A më dëgjuat që përmenda "epokën e kishës"? Ku gjendet ajo në kronologji? Kërkoju nxënësve të drejtohen aty. Mësimi i sot ndodh në fillim të epokës së kishës! A e dini se ne jemi pjesë e epokës së kishës? Epoka e kishës mbulon gjithçka që ka ndodhur pasi Jezusi u ngjit në qiell. Do të flasim pas pak për këtë.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam se si Jezusi u tregoi dishepujve se vërtet ishte ringjallur dhe është i gjallë! A ju kujtohet diçka specifike që Jezusi bëri ose tha? *Jepu kohë nxënësve të përgjigjen; përgjigjet mund të jenë: Ai iu shfaq fizikisht dishepujve dhe mbi 500 njerëzve, Ai hëngri, Ai u tregoi dishepujve shenjat e Tij, Ai bëri mrekulli, etj.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Veprat e Apostujve 1:1 – 2:4

Para se të ngjitet në qiell, Jezusi mëson dishepujt

Lexo Veprat e Apostujve 1:1-5

Përmbledhje: Këto vargje bëjnë një përmbledhje të 40 ditëve gjatë së cilave Jezusi kaloi në tokë pas ringjalljes: duke mësuar njerëzit! Për çfarë i mësoi? (Për Mbretërinë e Perëndisë).

Jezusi u dha edhe një urdhërim të rëndësishëm. Çfarë u tha të bënin? (Të qëndronin në Jerusalem dhe të prisnin dhuratën që do të vinte) Cila ishte dhurata që mendoni se po vinte? (vargu 5 – Fryma e Shenjtë).

Jezusi u jep dishepujve një premtim dhe një mision

Lexo Veprat e Apostujve 1:6-8

Përmbledhje: Çfarë pyetjeje i bënë dishepujt Jezusit? (E pyetën nëse Ai do ta rivendoste mbretërinë e Tij në Izrael) Ne e dimë se ku po e ndërton Jezusi mbretërinë e Tij, edhe dishepujt e dinin. Cili nga 12 vargjet kyç na tregon se ku po e përgatit Jezusi një vend për ne? (Gjoni 14:2)

Përse mendoni se dishepujt e pyetën Jezusin nëse do ta rivendoste mbretërinë e Tij në Izrael, duke qenë se e kishin dëgjuar premtimin e Tij për qiellin? Dishepujt po shpresonin që Jezusi t'i çlironte nga Roma, mirëpo Jezusi kishte një plan më të mirë. Le të shohim vargun 8. *Lexoni me zë vargun 8.* Jezusi u jep dishepujve një premtim dhe një mision!

Cili është premtimi? (Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ta dhe ata do të marrin fuqi)

Cili është misioni? (Dishepujt do të jenë dëshmitarë për Jezusin nëpër botë!)

Çfarë është një dëshmitar? *Jepu kohë nxënësve të përgjigjen.* Një dëshmitar për Jezusin është ai që u tregon apo thotë njerëzve të vërtetën për Perëndinë dhe mënyrën e shpëtimit nga mëkati. A mund të jemi dëshmitarë për Jezusin sot? (Po!) Sa entuziazmuese! Le të lexojmë se ç'ndodhi pas kësaj.

Jezusi kthehet në qiell dhe engjëjt bëjnë një premtim

Lexo Veprat e Apostujve 1:9-11

Përmbledhje: Menjëherë pasi Jezusi dha premtimin dhe misionin, u rikthye në qiell! Kjo quhet ngjitja e Jezusit. Ai është në qiell edhe sot, duke përgatitur një vend për ne! A ju kujtohet vargu nga Gjoni 14:2? Le të lexojmë së bashku Gjonin 14:1-6. Jezusi premtoi se po përgatit një vend për ne dhe se një ditë Ai

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

do të kthehet të na marrë me vete. Duket si premtimi i bërë nga engjëjt. Le të lexojmë edhe njëherë Veprat 1:11.

Ku shkoi Jezusi? (Në qiell) Çfarë po bën atje? (Po përgatit një vend për ne) A do të kthehet Jezusi? (Po!) Kur? (Nuk e dimë, ndaj duhet të jemi gati, siç duhet të ishim gati në "Kohën e zbulimit" sot)

Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe Gjonit 1:1-6, duke theksuar premtimet e Jezusit dhe faktin se Ai është e vetmja rrugë.

Dishepujt luten dhe përgatiten

Parafrazim i Veprave të Apostujve 1:12-26:

Pasi engjëjt folën me dishepujt, ata iu bindën Jezusit dhe u kthyen në Jerusalem. Le të shohim se çfarë bënë kur u kthyen. ***Lexo Veprat e Apostujve 1:14.*** Ata u mblodhën dhe kaluan kohë duke u lutur.

Pas kësaj, ata zgjodhën një burrë të quajtur Matia, që t'u bashkohej dishepujve për të zëvendësuar Judën, i cili kishte tradhëtuar Jezusin.

A po tregoheshin të bindur dishepujt? (Po) Ata kaluan kohë në lutje dhe përgatitje për t'u bërë dëshmitarë për Jezusin.

Fryma e Shenjtë i pajis dishepujt për t'u bindur

Lexo Veprat e Apostujve 2:1-4

Përmbledhje: Ashtu siç kishte premtuar Jezusi, dishepujt morën Frymën e Shenjtë dhe u pajisën për të qenë dëshmitarë për Jezusin nëpër botë. Dita kur ata morën Frymën e Shenjtë quhet Pentekost. Kjo është gjithashtu nisja e epokës së kishës. *Referoju kronologjisë dhe drejtohu te epoka e kishës aty.*

Ashtu siç kishte premtuar Jezusi, dishepujt u bënë dëshmitarë. Ata filluan menjëherë t'u tregonin njerëzve Lajmin e Mirë të Jezusit dhe shumë besuan. Të gjithë ata që besuan u bënë pjesë e kishës nëpër botë. Prandaj quhet epoka e kishës! Do të mësojmë më shumë për këta besimtarë dhe për kishën e hershme gjatë javëve të ardhshme.

Përse dishepujt ishin gati për të qenë dëshmitarë? Ata ishin gati sepse kishin kaluar kohë me Jezusin, kishin kaluar kohë në lutje, kishin përgatitur skuadrën dhe kishin marrë Frymën e Shenjtë.

Përfundimi

Njësoj si dishepujt, edhe ne jemi pjesë e epokës së kishës, sepse të gjithë të krishterët janë pjesë e kishës nëpër botë! *Referoju kronologjisë dhe drejtohu te epoka e kishës*.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Çdo person që beson në Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar merr Frymën e Shenjtë dhe pajiset për të qenë dëshmitar për Jezusin. Epoka e kishës do të vazhdojë derisa të kthehet Jezusi, siç ka premtuar.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Ashtu siç ishin dishepujt të përgatitur për t'iu bindur Jezusit, edhe ne mund të përgatitemi. Kur i kërkojmë Jezusit të jetë Zoti dhe Shpëtimtari ynë, Ai na fal, na pastron dhe na jep Frymën e Shenjtë si dhuratë! Fryma e Shenjtë jeton brenda nesh dhe na ndihmon të jetojmë siç i pëlqen Perëndisë.

Si mund ta ndjekim shembullin e dishepujve dhe të përgatitemi për t'iu bindur Jezusit? *Ftoji nxënësit në diskutim; përgjigjet duhet të përfshijnë lutjen, studimin e Fjalës së Perëndisë, dëgjimin e personave të perëndishëm (prindër, drejtues, miq), t'u shërbejmë të tjerëve, të jemi të gatshëm për të shpallur Ungjillin, etj.*

Si mund të ndihemi kur jemi të përgatitur? *Ftoji nxënësit në diskutim; përgjigjet mund të jenë: të ngushëlluar, të sigurt, të gëzuar, në paqe, etj.* Kur jam i përgatitur, ndihem besnik. A e dini se çfarë do të thotë *besnik*? Do të thotë se jam i qëndrueshëm dhe i besës. Do të thotë se i mbaj premtimet dhe se u bindem udhëzimeve që më jep Jezusi. Ndihem mirë kur jam besnik!

Le të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë të jemi vigjilentë dhe gati për mundësitë që Ai do të na japë për t'iu bindur! *Mbylle me lutje.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë bëri Jezusi ndërsa ishte ende në tokë? (Ai u dha dishepujve prova se ishte gjallë dhe i mësoi ata)
2. Çfarë u premtoi Ai dishepujve para se të rikthehej në qiell? (Se ata do të merrnin Frymën e Shenjtë)
3. Ku shkoi Jezusi? (Në qiell)
4. Çfarë u thanë engjëjt dishepujve? (Jezusi do të rikthehej në të njëjtën mënyrë siç po largohej)
5. Çfarë bënë dishepujt pas rikthimit të Jezusit në qiell? (Ata u përgatitën për të qenë dëshmitarë)
6. Si i pajisi Perëndia dishepujt për të qenë dëshmitarë? (Ai u dha atyre Frymën e Shenjtë)
7. Çfarë është epoka e kishës? (Koha nga Pentekosti derisa të kthehet Jezusi)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 9
Veprat 4:32 – 5:11

Kupto si duhet:	Anania dhe Safira gënjejnë.
Mendo si duhet:	"Mos vidhni, mos gënjeni dhe mos mashtroni njëri-tjetrin." Levitiku 19:11
Vepro si duhet:	Unë do të tregoj të vërtetën.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i ndershëm kur tregoj të vërtetën.

PËRGATITU!

Ashtu si Anania dhe Safira, edhe ne mund të tundohemi të gënjejmë që të dukemi mirë para të tjerëve. Perëndia njeh zemrën tonë dhe sheh dëshirat e vërteta. Në mësimin e kësaj jave, Perëndia i jep Kishës së hershme (dhe neve) një paralajmërim të qartë për të jetuar një jetë të ndershme që nderon Perëndinë.

Lutu: Kërkoji Perëndisë t'i ndihmojë nxënësit të jenë të ndjeshëm ndaj mëkatit, që të mund ta dallojnë shpejt, e t'ia mbathin prej tij.

Lexo: Veprat e Apostujve 4:32 – 5:11

Kupto si duhet: Anania dhe Safira gënjejnë
Kisha e krishterë filloi pas ringjalljes dhe ngritjes së Jezusit në qiell. Ndjekësit e Jezusit ishin të përkushtuar dhe ndanin me guxim Ungjillin, si dhe ndanin gjithçka në përbashkësi me njëri-tjetrin. Uniteti i tyre është një dëshmi e mrekullueshme e një jete të përqendruar te Krishti. Një përjashtim i këtij uniteti ishte Anania dhe Safira, një burrë dhe një grua mes të krishterëve të hershëm, që provokuan Frymën e Shenjtë, duke u përpjekur të mashtronin për kontributin që jepnin nga pasuria e tyre. Ndëshkimi për ta ishte i ashpër. Rasti i tyre shërben si një shembull tronditës që na ndihmon të kujtojmë <u>të themi të vërtetën.</u>

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Para se të fillojë mësimi, zgjidh dy nxënës që do të përfaqësojnë Ananian dhe Safirën. Tregoju se do të jenë pjesë e dramës dhe jepu disa para false që përfaqësojnë fitimet e tyre financiare. (Mund të jetë ndihmë t'i kontaktoni paraprakisht prindërit, që nxënësit të vijnë të përgatitur për rolet e tyre.) Ndërkohë që nxënësit hyjnë në klasë, jepu edhe të tjerëve disa para false. Inskeno kishën e hershme ndërsa tregon mësimin. Thuaju nxënësve t'i japin paratë me gëzim si në familje, sepse të gjitha nevojat e tyre do të plotësohen.
2. Krijo një mister nga mësimi i sotëm. Bëj siluetën e dy trupave (përdor ngjitës) në dysheme dhe përreth tyre hidh monedha ari. Thuaju nxënësve kur të vijnë se kanë vdekur dy persona dhe është sfida e tyre të zgjidhin çështjen; të gjejnë se kush, çfarë, ku dhe pse ka ndodhur, deri në fund të mësimit.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Thuaj të vërtetën!

Qëllimi: Të përforcojmë rëndësinë e **thënies së të vërtetës.**

Aktiviteti 1: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Dyzet kuti
- Katër grupe me fleta ku shkruhen fjalët nga Levitiku 19:11 – dy grupe printoji në të njëjtën ngjyrë dhe dy të tjerat në një ngjyrë tjetër; ngjiti te kutitë (burim i printueshëm)
- Poster me vargun nga Levitiku 19:11, ose shkruaje vargun në tabelë (burim i printueshëm)
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për ambientin: Kutitë duhen ngatërruar/përzier.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Në fillim të aktivitetit cakto dy ndihmës si "kapitenë skuadre" që t'i ndihmojnë e t'i motivojnë nxënësit.
2. Ndaji nxënësit në dy skuadra dhe caktoji një ngjyrë specifike secilës.
3. Sfidoji t'i vendosin kutitë mbi njëra-tjetrën duke formuar vargun nga Levitiku 19:11, *dy herë.* Përdorni murin si mbështetje për kutitë.
4. Para se të filloni, tregoju se ka edhe një udhëzim shtesë për këtë aktivitet: nxënësit mund të përdorin vetëm njërën dorë.
5. Niseni sfidën. Kapitenët duhet t'i inkurajojnë nxënësit dhe t'u kujtojnë se mund të përdorin vetëm njërën dorë. Gjithashtu duhet të shohin me kujdes se mos ndonjëri nga ata, padashje apo me qëllim, përdor të dyja duart.
6. Skuadra që i vendos e para, dhe saktë, kutitë mbi njëra-tjetrën, fiton! Jepu anëtarëve të asaj skuadra nga dy etiketa shpërblyese.
7. Mblidhi të gjithë dhe pyeti: "A përdorët vetëm njërën dorë?" Inkurajoji nxënësit të thotë të vërtetën: "po" ose "jo". Çdo nxënës që thotë të vërtetën do të fitojë një etiketë shpërblyese shtesë (edhe nëse i kanë përdorur të dyja duart – synimi është të tregohet e vërteta).

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Një pako me karamele *Haribo* në formë krimbash
- Përbërës për çdo nxënës:
  - ½ gote me puding çokollate
  - Një biskotë me çokollatë
  - Një gotë pastike
  - Lugë plastike

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe dhe shpjegoju se do të punojnë me njëri-tjetrin për të bërë "ëmbëlsira balte" për sot.
2. Shpjegoju si të thërrmojnë biskotat dhe të shtojnë pudingun.
3. Para se të nisni, lajmëroi se ka dhe një udhëzim shtesë për këtë aktivitet: ata duhet të përdorin vetëm njërën dorë. Duhet të punojnë me njëri-tjetrin për ta përgatitur ushqimin.
4. Fillojeni sfidën. Drejtuesit duhet t'i inkurajojnë nxënësit dhe t'u kujtojnë se mund të përdorin vetëm njërën dorë. Gjithashtu duhet të shohin se mos nxënësit, pa dashje apo qëllimisht, përdorin të dyja duart.
5. Kur të jenë përgatitur "embëlsirat prej balte", mblidhi nxënësit dhe pyeti: "A përdorët vetëm njërën dorë?" Inkurajoji të thonë të vërtetën, "po" ose "jo". Çdo

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

nxënës që thotë të vërtetën do të fitojë karamele *Haribo* për t'ia shtuar ëmbëlsirës (edhe po t'i kenë përdorur të dyja duart – qëllimi është të tregojnë të vërtetën).

6. Nxënësit mund t'i konsumojnë embëlsirat e tyre prej balte.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Sot u sfiduat gjatë aktivitetit të "Kohës së zbulimit" që të përdornit vetëm njërën dorë. Jam i sigurt se ishte e vështirë. Qoftë nëse përdorët vetëm njërën dorë apo të dyja, a treguat të vërtetën në fund? Sa e rëndësishme mendoni se është të themi të vërtetën? Do ta zbulojmë tani!

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve të nisë mësimin me lutje. Kujtoju të tjerëve se duhet të përqendrohen ndërsa njëri prej tyre lutet me zë.*

Zbuloje: Ku mësojmë për kishën që nisi pasi Jezusi u ngrit në qiell? (Në Dhiatën e Re te libri i Veprave të Apostujve) Mësimi i sotëm fillon te libri i Veprave të Apostujve, kapitulli 4, vargu 32.

Kronologjia: *Te prezantimi i mësimit nga Bibla i referohemi kronologjisë.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: *Përdor kronologjinë e Biblës ndërsa bën këtë prezantim.* Së fundmi kemi festuar Pashkën, ditën kur Jezusi u ringjall pasi u kryqëzua për mëkatin tonë. Ishte një ditë e mrekullueshme që ndryshoi tërë botën. Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm e të përsosur, Jezusin, që të na shpëtonte nga ndëshkimi i mëkatit, që ne të merrnim faljen e të mirëpriteshim si anëtarë të familjes së Tij të përjetshme. Pasi Jezusi u ringjall, qëndroi në tokë dyzet ditë para se të shkonte në qiell te Ati i Tij. Pas kësaj, në ditën e Pentekostit, Jezusi dërgoi Frymën e Shenjtë që të banonte brenda të gjithë atyre që besojnë tek Ai. Fryma e Shenjtë i ndihmoi dishepujt të bënin mrekulli dhe t'u tregonin njerëzve për Jezusin. Gjithnjë e më tepër njerëz besuan në Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar dhe u bënë pjesë e asaj që ne quajmë "kisha e krishterë". Ishte një periudhë shumë e rëndësishme, sepse atëherë krishterimi, pra, besimi në Jezu Krishtin, u përhap nëpër botë.

Sot do të mësojmë diçka tronditëse që ndodhi në kishën e hershme. A jeni gati për ta zbuluar?

Përvijimi i Shkrimit: Veprat e Apostujve 4:32 – 5:11

<u>Ka unitet në kishë</u>

Lexo Veprat e Apostujve 4:32-37

Përmbledhje: Duhet të ketë qenë fantastike të ishe një nga besimtarët në atë kohë. Ata e donin Jezusin dhe njëri-tjetrin aq shumë, saqë ndanin gjithçka

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

kishin! Çfarë mendoni se po bënin dishepujt e Jezusit? (Po u tregonin njerëzve për Jezusin)

Duke qenë se dishepujt ishin të zënë duke u folur njerëzve për Jezusin, nuk po fitonin para nëpër punët e tyre. Nëse dishepujt kishin nevojë për para, një nga besimtarët shiste një copë tokë, madje edhe shtëpinë, për të siguruar për nevojat e dishepujve ndërsa u flisnin njerëzve për Jezusin. A nuk është e mrekullueshme? Cili ishte një nga të krishterët e hershëm që shiti tokë dhe ua dha paratë dishepujve? (Barnaba) Barnaba e donte Perëndinë dhe bëri shumë për të ndihmuar kishën e hershme. Gjërat po shkonin shumë mirë, mirëpo erdhën telashet!

Anania dhe Safia thurin një plan

Lexo Veprat e Apostujve 5:1-2

Përmbledhje: Çfarë bëri Anania dhe Safira? (Shitën një copë toke, mbajtën për vete një pjesë të parave dhe pjesën tjetër ua dhanë dishepujve) A e kuptoni? Anania dhe Safira donin që njerëzit të mendonin që ata ishin bujarë si Barnaba. Ata donin që Perëndia dhe njerëzit në kishë të besonin diçka që nuk ishte e vërtetë. Çfarë quhet kjo? (Gënjeshtër) Gjatë aktivitetit të "Kohës së zbulimit" sot, a treguat të vërtetën, apo gënjyet? Për çfarë gënjejnë zakonisht fëmijët? *Jepu mundësinë të përgjigjen.* Çfarë është gënjeshtra? (Mëkat) *Trego faqen e errët të "Librit pa fjalë".* A mendoni se Anania dhe Safira ia hodhën me gënjeshtrën e tyre? Le ta shohim.

Gënjeshtra e Ananias del në dritë

Lexo Veprat e Apostujve 5:3-4

Përmbledhje: Ua! Si e dinte Pjetri që Anania dhe Safira po gënjenin? E po, mendojeni pak. A mund t'i fshehim ndonjë gjë Perëndisë? (Jo) Pra, Ai di gjithçka për ne? (Po) Perëndia e dinte se Anania dhe Safira po gënjenin dhe ia tregoi Pjetrit përmes Frymës së Shenjtë. Ma merr mendja se Anania dhe Safira nuk e prisnin fare këtë. Kush donte që Anania dhe Safira të gënjenin? (Satani) Në vend që t'i bënin gjërat siç i pëlqen Perëndisë, Anania dhe Safira i bënë gjërat siç i pëlqen Satanit. Satani do që të gjithë ne të dështojmë si Anania dhe Safira.

Le të sigurohemi se e kemi kuptuar pamjen e plotë. A ishte problem fakti që Anania dhe Safira mbajtën një pjesë të parave që morën nga toka? (Jo, nuk ishte mëkat mbajtja e parave) Cili ishte mëkati? (Ata gënjyen Perëndinë? A ka ndonjë rast kur justifikohet gënjeshtra ndaj Perëndisë? (Jo) Nëse ne gënjejmë Perëndinë, a e di Ai të vërtetën? (Po, Ai di gjithçka) Çfarë mendoni se ndodhi më pas?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Anania ndëshkohet

Lexo Veprat e Apostujve 5:5-6

Përmbledhje: Ndëshkim shumë i keq, apo jo? Le të shohim se çfarë ndodhi me Safirën.

Gënjeshtra e Safirës del në dritë

Lexo Veprat e Apostujve 5:7-8

Përmbledhje: Ups! A e gënjeu edhe Safira Perëndinë? (Po) Le të shohim se ç'ndodhi me të.

Safira ndëshkohet

Lexo Veprat 5:9-11

Përmbledhje: A e mendonit se edhe Safira do të vdiste? *Jepu mundësinë nxënësve të përgjigjen.* Si u ndien njerëzit në kishë, edhe të tjerët, kur morën vesh se ç'kishte ndodhur me Ananian dhe Safirën? (Ata patën frikë) A duhet të kemi frikë nga Perëndia? A e dini se Psalmi 111:10 thotë: "Frika e Zotit është fillimi i urtësisë"? Duhet të kuptojmë se Perëndia e di shumë mirë se ç'ka në zemrën tonë. Ne mund t'ua hedhim njerëzve, por kurrë Perëndisë. Mendoni si do të ishte nëse Perëndia nuk do të ndëshkonte Ananian dhe Safirën. Njerëzit do të fillonin të mendonin se nuk ka problem të gënjesh e të mashtrosh kishën. Nëse njerëzit në kishë gënjejnë dhe mashtrojnë njëri-tjetrin, a i ndihmojnë të tjerët të njohin Jezusin dhe të shpëtojnë nga ndëshkimi i mëkatit? (Jo) Perëndia përdori si shembull të keqen që bëri Anania dhe Safira për t'u mësuar njerëzve në kishë të ishin të sinqertë dhe t'i besonin Atij me gjithçka. A ju kujtohet vargu nga "Mendo si duhet"? Le ta themi. *Nxënësit të recitojnë Levitikun 19:11. "Mos vidhni, mos gënjeni dhe mos mashtroni njëri-tjetrin."*

Përfundimi

Pasi ndodhi kjo situatë me Ananian dhe Safirën, Perëndia vazhdoi t'i ndihmonte njerëzit që besonin tek Ai. Dishepujt bënë shumë mrekulli dhe u treguan njerëzve për Jezusin. Gjithnjë e më shumë njerëz besuan te Jezusi për falje dhe shpëtim nga ndëshkimi i mëkatit, dhe kisha vazhdoi të rritej. Perëndia vepron gjithmonë drejt!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Anania dhe Safira nuk treguan të vërtetën. Përkundrazi, gënjyen. Perëndia e përdori marrëzinë e tyre në pandershmëri për të na mësuar neve se duhet të jemi të sinqertë dhe të tregojmë të vërtetën në çdo kohë. Kur veprojmë kështu, mund të ndihemi të besueshëm! Sa i sinqertë je ti? Asnjëri prej nesh nuk mund të jetë tërësisht i sinqertë pa u varur te Jezusi për ndihmë. A i ke besuar Jezusit për shpëtim nga ndëshkimi i mëkatit? A është Ai udhëheqësi i jetës sate? A do të doje të mësoje se si t'i kërkosh

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Jezusit të të falë e të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë".*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Si i ndihmonin dishepujt njerëzit e kishës së hershme? (Ata shisnin tokat dhe shtëpitë e tyre dhe u jepnin para dishepujve që të mund të vazhdonin t'u flisnin njerëzve për Jezusin)
2. Kur Anania dhe Safira shitën pronën e tyre, çfarë bënë me paratë e fituara? (Ata e mbajtën një pjesë për vete dhe një pjesë ia dhanë dishepujve)
3. Çfarë donin ata që të mendonin njerëzit? (Që ua kishin dhënë të gjitha paratë dishepujve)
4. A ishte mëkat që Anania dhe Safira të mbanin një pjesë të parave? (Jo)
5. Po cili veprim i tyre ishte mëkat? (Ata gënjyen Perëndinë)
6. Çfarë ndodhi me Ananian dhe Safirën? (Ata vdiqën)
7. Çfarë ndodhi me dishepujt dhe kishën? (Dishepujt bënë shumë mrekulli, u treguan njerëzve për Jezusin, kështu më shumë besuan dhe kisha rritej)
8. A je i vendosur ti që të tregosh të vërtetën?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 10
Veprat 6:1 – 8:3

Kupto si duhet:	Stefani qëndroi i patundur për Jezusin.
Mendo si duhet:	"Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin." 1 e Korintasve 15:58
Vepro si duhet:	Unë do të qëndroj i patundur për Jezusin.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt kur qëndroj i patundur për Jezusin.

PËRGATITU!

Këtë javë do të mësojmë për Stefanin, martirin e parë të kishës së hershme. Ai qëndroi i patundur për Jezusin, duke e zbatuar vargun nga 1 e Korintasve 15:58. Ndërsa studiojmë mësimin, le të lutemi që do të qëndrojmë të patundur për Jezusin në jetën tonë.

Lutu: Fëmijët kanë një presion të jashtëzakonshëm për të mëkatuar. Lutu që ata të mund të mendojnë përmes një botëkuptimi biblik. Kur ata MENDOJNË për atë që kanë KUPTUAR si duhet nga Shkrimi, do të mund të VEPROJNË si duhet, që do t'i bëjë të NDIHEN si duhet, duke marrë vendimet e drejta, pavarësisht kostos.

Lexo: Veprat e Apostujve 6:1 – 8:3

Kupto si duhet: Stefani qëndroi i patundur për Jezusin
E vërteta e Ungjillit vazhdoi të mbillej, dhe kisha e hershme u rrit shpejt. Kjo rritje bëri që dymbëdhjetë dishepujt të kërkonin ndihmë për të plotësuar nevojat e ndjekësve të Jezusit. Të dymbëdhjetët zgjodhën shtatë burra besnikë si ndihmës, njëri prej të cilëve quhej Stefan. Stefani bëri shenja të mrekullueshme si dëshmi e pranisë së Perëndisë dhe kjo nxiti kundërshtime të forta nga armiqtë e Jezusit. Kur dolën dëshmitë e rreme kundër Stefanit, ai e tregoi i patrembur historinë e Izraelit dhe i përballi akuzuesit e tij me vrasjen e Shpëtimtarit. Për këtë e vranë me gurë, kështu ai u bë martiri i parë i krishterë. Me vdekjen e tij, Stefani na tregoi koston e mundshme kur <u>qëndrojmë të patundur për Jezusin.</u>

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënim për mësuesin kryesor: Ky mësim është mundësia e përsosur për ta përdorur kronologjinë e Biblës për të treguar pamjen e madhe të planit sovran të Perëndisë për shpëtimin nga mëkati. Stefani na kthen në ditët e Abrahamit, Jakobit dhe dymbëdhjetë bijëve të tij, robërisë në Egjipt dhe çlirimit të Izraelit përmes Moisiut. Në fund, fjalimi i Stefanit arrin kulmin me refuzimin që drejtuesit fetarë judenj i bënë Jezusit.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Bëj shigjeta të mëdha dhe vendosi te vendi përkatës në kronologji ndërsa shpjegon mësimin.
2. Ndërkohë që shpjegon, inkurajoji nxënësit ta vënë veten në vendin e Stefanit dhe pyeti rreth asaj që mendojnë se si mund të jetë ndier ai. Përdor posterin "Ndihu si duhet" për të marrë ide.
3. Nëse ke nxënës të rritur, krijo një gur varri për Stefanin. Ndërkohë që hyjnë nxënësit, mbaj qetësi në klasë dhe thuaj: "Më lejoni t'ju tregoj se ç'ndodhi me këtë njeri të mirë që quajtur Stefan." Përfundoje mësimin duke pyetur: "Nëse Stefani do të shkruante një varg në gurin e tij, cili do të ishte?"

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Pamja e madhe!

Qëllimi: Të rishikojmë kronologjinë e Biblës – **pamjen e madhe** të planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga mëkati – siç bëri Stefani kur u mor në pyetje nga armiqtë e Jezusit.

Shënim: Është e rëndësishme të mos e shndërrosh në leksion, por në një rishikim argëtues.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Stacioni i artit



Mjetet:

- Letër punëdore, e ndarë në shtatë katrorë, te të cilët do të vendosen numrat nga njëshi te shtata (burim i printueshëm)
- Gjashtë figura nga kronologjia e Biblës (vari diku që nxënësit t'i shohin ndërsa tërheqin) – 1. Abrahami dhe Sara (duke parë qiellin me yje), 2. Jozefi (me mantelin shumëngjyrësh), 3. Moisiu (me bastunin), 4. Jozueu (dhe muret e Jerikos), 5. Mbreti David (me Goliathin), 6. Jezusi (burim i printueshëm)
- Lapustila, lapsa me ngjyra dhe bojëra dhjami

Këshillë për "Kohën e zbulimit": Kërkoji njërit prej drejtuesve të vizatojë në tabelë ndërkohë që nxënësit vizatojnë te letrat e tyre, për t'i ndihmuar apo për t'u dhënë ide.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi çdo nxënësi letër punëdoren dhe kërkoji të shënojnë emrin e tyre në pjesën e pasme të fletës.
2. Pyeti nëse kanë bërë histori me vizatime më parë.
3. Thuaju se do të vizatojnë histori shumë të veçanta sot.
4. Tregoju se do t'u shfaqësh **pamjen e madhe** të planit të Perëndisë dhe ata do të vizatojnë çdo skenë në secilin prej katrorëve të punëdores.
5. Filloni me kutinë 1 dhe përfundoni me kutinë 6, flisni për secilën nga skenat me radhë dhe jepu një minutë kohë për të vizatuar një figurë të thjeshtë për secilën skenë (kutia 7 do të ketë një foto/figurë të tyren).
   - Kutia 1: Perëndia i premton një burri të quajtur Abraham se do të kishte po aq pasardhës sa ka yje në qiell, edhe pse ishte i moshuar dhe nuk kishte fëmijë. Kur Abrahami ishte 100 vjeç dhe gruaja e tij Sara ishte 90 vjeç, premtimi i Perëndisë u bë realitet. Ata lindën një djalë të quajtur Isak! (Pamja e thjeshtë: një burrë i moshuar, mbi të cilin të shkruhet "100 vjeç"; një grua e moshuar mbi të cilën të shkruhet "90 vjeç"; një foshnjë, yje në qiell)
   - Kutia 2: Isakut i lindi një bir i quajtur Jakob, i cili pati një bir të quajtur Jozef. Jakobi i dha Jozefit një dhuratë të veçantë – një mantel shumëngjyrësh. Vëllezërit e Jozefit ishin xhelozë për të, ndaj e shitën si skllav në Egjipt. (Figura e një burri të veshur me një mantel shumëngjyrësh)
   - Kutia 3: Familja e Jakobit u shpërngul në Egjipt dhe vazhdoi të rritej në numër. Quheshin izraelitë. Ata u shtuan aq shumë, saqë egjiptasit patën frikë prej tyre

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dhe i skllavëruan. Perëndia dërgoi Moisiun që t'i shpëtonte dhe ndau Detin e Kuq që ata të largoheshin! (Shumë njerëz që kalojnë Detin e Kuq)

- Kutia 4: Pas Moisiut erdhi Jozueu, i cili i udhëhoqi izraelitët në tokën e premtuar dhe ndoqi planin e Perëndisë për të rrëzuar muret e Jerikos. (Një burrë pranë një muri)
- Kutia 5: Mbreti David njihej për dashurinë që kishte për Perëndinë; kur ishte i ri, vrau një gjigant të quajtur Goliath. (Dy burra, një i madh një i vogël; një hobe dhe një gur)
- Kutia 6: Mbreti David ishte i rëndësishëm, sepse prej familjes së tij do të vinte një person shumë i veçantë. Ky person i veçantë ishte Shpëtimtari i botës, që erdhi të na shpëtojë nga mëkati. Emri i tij është Jezus! (Një kurorë dhe një shigjetë që drejtohet te Jezusi; foshnja Jezus në një grazhd)

6. Tregoju se gjithçka që kanë vizatuar është plani i Perëndisë për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit. Në kutinë e fundit duhet të vizatojnë veten. Nëse e kanë marrë vendimin për t'i besuar Jezusit për shpëtim nga mëkati, duhet të vizatojnë një kryq pranë fotos së tyre.
7. Thuaju ta marrin punëdoren dhe ta përdorin gjatë mësimit, si dhe t'ia tregojnë familjes kur të kthehen në shtëpi.

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit



Mjetet:

- Përbërës për të bërë biskota
- Shtatë karta/letra me përshkrime për kronologjinë e Biblës – secilën vendose pranë njërit prej përbërësve: miell, sheqer, vezë, etj. (burim i printueshëm)
- Dy tabela të vogla
- Dy lapustila
- Ndihmës për të pjekur biskotat pasi t'i kenë bërë gati nxënësit dhe të jenë duke marrë mësimin
- Tasa, lugë, letër pjekjeje, sobë, etj. (për të bërë dhe për të pjekur biskotat)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra dhe cakto dy drejtues si kapitenë skuadrash.
2. Shpjegoju se njëra nga skuadrat, ose të dyja, mund të fitojnë biskota të sapopjekura duke iu përgjigjur saktë pyetjeve. Çdo përgjigje e saktë fiton një përbërës për biskotat.
3. Thuaju nxënësve se Bibla është si biskotat. Çdo libër i Biblës është si një përbërës dhe ka një qëllim; secili ka rolin e vet për të na shfaqur planin e madh të Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Lexo një të dhënë nga karta e parë. Secila skuadër duhet të mblidhet me kapitenin e vet për të gjetur një përgjigje. Kapitenët e skuadrave duhet t'i udhëheqin anëtarët drejt përgjigjes së saktë. Anëtarët duhet ta shënojnë përgjigjen te tabela tyre.
5. Pasi të kesh numëruar deri në tre, të dyja skuadrat duhet të ngrenë lart tabelën e tyre. Nëse përgjigjja është e saktë, e fitojnë përbërësin.
6. Nëse skuadrat i fitojnë të gjithë përbërësit, ndihmësi do t'i bëjë e do t'i pjekë biskotat, pastaj do ua japë në fund të mësimit.

Kartat me përshkrime për kronologjinë e Biblës:

- Karta 1: Perëndia premtoi se ky burrë i moshuar do të kishte një familje shumë të madhe, me po aq pasardhës sa ka yje në qiell, edhe pse ai ende nuk kishte fëmijë. Ky burrë dhe gruaja e tij, Sara, lindën Isakun kur ishin shumë të moshuar, pikërisht siç kishte premtuar Perëndia. (Abrahami)
- Karta 2: Ky burrë ishte biri i Isakut dhe kur u rrit, kishte dymbëdhjetë bij. (Jakobi)
- Karta 3: Ky ishte një nga dymbëdhjetë bijtë e Jakobit dhe vëllezërit u bënë aq xhelozë për ta, saqë e shitën si skllav në Egjipt. (Jozefi)
- Karta 4: Ky ishte burri që Perëndia dërgoi për t'i udhëhequr izraelitët jashtë Egjiptit, dhe ata e kaluan Detin e Kuq në tokë të thatë. (Moisiu)
- Karta 5: Ky burrë i udhëhoqi izraelitët për në tokën e premtuar dhe ndoqi planin e Perëndisë për të rrëzuar muret e Jerikos. (Jozueu)
- Karta 6: Ky ishte një mbret shumë i rëndësishëm në Izrael, i cili njihej se e donte Perëndinë. Kur ishte i ri, vrau një gjigand të quajtur Goliath. (David)
- Karta 7: Ky është një nga pasardhësit e mbretit David. Ai lindi për të shpëtuar njerëzit nga mëkati. (Jezusi)

<u>**Aktiviteti 3:** Stacioni i plastelinës</u>



Mjetet:

- Shtatë karta/letra me përshkrime për kronologjinë e Biblës (si te stacioni i ushqimit) (burim i printueshëm)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në shtatë skuadra.
2. Thuaju skuadrave se të gjitha skuadrat së bashku mund të krijojnë kronologjinë e Biblës – pamja e madhe e planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit.
3. Jepi çdo skuadre një kartë përshkruese.
4. Sfidoji skuadrat ta lexojnë kartën dhe ta krijojnë me plastelinë skenën apo personin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

5. Drejtuesit mund të japin ndihma për krijimet, por ky nuk është momenti për t'u mësuar atyre kronologjinë.
6. Sigurohu që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për kohën që kanë në dispozicion pastaj filloni.
7. Kur të përfundojë koha, thirri skuadrat sipas radhës nga njëshi te shtata dhe rreshtoni punimet me plastelinë në një tavolinë për të formuar pamjen e madhe të planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit tonë. Fol shkurtimisht për kronologjinë dhe bëju një foto të gjithëve me punimet e tyre.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: Çfarë krijuat gjatë aktivitetit të "Kohës së zbulimit"? (Një kronologji të Biblës – pamja e madhe e planit të Perëndisë për të na shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit) A e kuptoni se Perëndia ka patur në plan të na shpëtonte nga mëkati që prej fillimit të kohës, kur krijoi botën? Ai përdori shumë njerëz gjatë mijëra viteve *(drejtohu nga kronologjia)* për të sjellë Shpëtimtarin tonë, Jezusin, në botë, që të vdiste për mëkatin tonë. Këtë Ai e bëri për ne! Prandaj, pyetja ime është: A do të qëndrosh ti i patundur për Të?

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve ta nisë mësimin me lutje. Lejoje të lutet nga zemra për kishën (grupin e fëmijëve) dhe për ju, drejtuesit e grupit.*

Zbuloje: Mësimi i sotëm gjendet te libri i Veprave të Apostujve, kapitulli 6, duke nisur nga vargu 1. Veprat e Apostujve gjendet në Dhiatën e Re dhe na mëson për kishën.

Kronologjia: A mund të gjeni një figurë të "Epokës së kishës" në kronologjinë tuaj?

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Pasi Jezusi u ringjall dhe u ngrit në qiell, filloi kisha e krishterë. Ndjekësit e Jezusit morën Frymën e Shenjtë dhe bënin mrekulli të mahnitshme. Ata u tregonin me guxim njerëzve se si Jezusi mund t'i shpëtonte nga mëkati. Shumë judenj besuan në Jezusin dhe u bënë anëtarë të kishës, megjithatë shumica nuk besuan. Madje, disa i përndoqën dishepujt e Jezusit dhe u thanë të mos flisnin më për Të. Përndjekje do të thotë se u treguan mizorë dhe të këqinj me të krishterët. Disa nga dishepujt i futën në burg, mirëpo ata thanë se do t'i bindeshin Perëndisë pavarësisht se çfarë mund t'u bënin njerëzit. Kjo ishte një kohë shumë e bukur për kishën e krishterë, sepse po rritej shpejt, megjithatë ishte edhe një kohë shumë e rrezikshme. Sot do të mësojmë se sa e rrezikshme ishte. Le të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na mësojë nga Fjala e Tij.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përvijimi i Shkrimit: Veprat 6:1 – 8:3

Dishepujt kanë nevojë për ndihmë

Parafrazim i Veprat e Apostujve 6:1-7:

Kisha po rritej kaq shpejt, saqë dishepujt kishin nevojë për ndihmë. Ata zgjodhën shtatë burra që të shpërndanin ushqimin tek të vejat, që dishepujt të mund t'u tregonin njerëzve për Jezusin. Njëri nga shtatë ndihmësit quhej Stefan. Le të zbulojmë se ç'ndodhi me Stefanin.

Stefani akuzohet për blasfemi

Parafrazimi i Veprat e Apostujve 6:8 – 7:1

Stefani e donte Perëndinë dhe e tregonte me guxim të vërtetën për Jezusin. Disa nga drejtuesit fetarë judenj e akuzuan për blasfemi, që do të thotë të mos respektosh Perëndinë. A mendoni se Stefani qëndroi i fortë? Le ta shohim.

Stefani u kujton drejtuesve fetarë historinë e Izraelit duke nisur me Abrahamin

Parafrazim i Veprat e Apostujve 7:2-8

Përdor kronologjinë e Biblës për të treguar historinë e planit të Perëndisë.

Stefani u kujtoi judenjve planin e veçantë që Perëndia kishte patur para se të krijonte botën. Ai nisi me Abrahamin. A ju kujtohet Abrahami? Perëndia kishte një plan shumë të veçantë për familjen e Abrahamit. Shumë kohë para se të lindte Jezusi, Perëndia i tha Abrahamit të largohej nga vendi ku jetonte dhe të shkonte diku tjetër. Perëndia i kishte bërë një premtim të veçantë Abrahamit. Perëndia i tha atij se do të kishte një familje shumë të madhe dhe se do t'i jepte një tokë të re. *Drejtohu te kronologjia*. Mirëpo, kishte një problem. Abrahami ishte 75 vjeç dhe nuk kishte fëmijë! A mendoni se ky ishte problem për Perëndinë? (Jo) Kur Abrahami ishte 100 vjeç, u bë me një djalë të quajtur Isak! Perëndia i tha edhe diçka tjetër shumë të rëndësishme Abrahamit. Perëndia tha se familja e Abrahamit do të skllavërohej dhe do të keqtrajtohej për 400 vite në tokë të huaj. Abrahamit i lindi Isaku, pastaj Isakut Jakobi, dhe ky i fundit pati dymbëdhjetë bij. *Drejtohu te kronologjia.* Jakobi dhe dymbëdhjetë bijtë e tij quheshin izraelitët.

Izraelitët bëhen skllevër në Egjipt

Parafrazim i Veprat e Apostujve 7:9-19:

A ju kujtohet ndonjëri nga djemtë e Jakobit? (Jozefi) *Drejtohu te kronologjia.* Vëllezërit e Jozefit e shitën si skllav në Egjipt. Edhe pse vëllezërit po përpiqeshin ta lëndonin Jozefin, Perëndia ishte me të dhe u kujdes. Kur ndodhi zia e bukës, e gjithë familja e Jakobit u shpërngul në Egjipt. Familja e Jakobit vazhdoi të rritej, por diçka e keqe ndodhi. Ata u skllavëruan në Egjipt për 400

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

vite, ashtu siç i kishte thënë Perëndia Abrahamit. Egjiptasit ishin shumë mizorë me izraelitët, prandaj ata i klithën Perëndisë për ndihmë.

Perëndia dërgon Moisiun për të shpëtuar izraelitët

Parafrazim i Veprat e Apostujve 7:20-36:

A ju kujtohet personi që Perëndia thirri për t'i shpëtuar izraelitët nga Egjipti? (Moisiu) Si e mbrojti Perëndia Moisiun kur ishte foshnjë? (Faraoni urdhëroi vrasjen e të gjithë foshnjave, por mamaja e Moisiut e vuri në një shportë mbi lum. Bija e Faraonit e gjeti dhe e rriti si të vetin) Kur Moisiu u rrit, izraelitët nuk besuan se Perëndia e kishte dërguar Moisin për t'i nxjerrë nga Egjipti, prandaj mbetën skllevër për 40 vite të tjera. E dini se ç'ndodhi më pas? (Perëndia iu shfaq Moisiut në shkurren që digjej dhe i tha t'i udhëhiqte izraelitët jashtë Egjiptit) Çfarë ndodhi kur Faraoni nuk po i linte të shkonin? (Perëndia i ndëshkoi Egjiptasit me dhjetë plagë) Në fund, Faraoni i la dhe ata u çliruan. Ata kaluan Detin e Kuq dhe shkuan në malin e quajtur Sinai.

Izraeli refuzon Perëndinë

Parafrazim i Veprat e Apostujve 7:37-50:

A ju kujtohet se çfarë i dha Perëndia Moisiut dhe izraelitëve në malin Sinai? (Dhjetë Urdhërimet) Çfarë bënë izraelitët kur Moisiu ishte në mal me Perëndinë? (Bënë një idhull, një viç të artë, që ta adhuronin) A ju besohet që pas gjithçkaje që Perëndia kishte bërë për ta, ata nuk i besonin Atij? Përkundrazi, ata vendosën t'i besonin një viçi të artë që e kishin bërë me duart e tyre.

Megjithatë, Perëndia ishte ende me ta. Moisiu u tha izraelitëve se Perëndia do të dërgonte një person shumë të veçantë tek ata. Ky person i veçantë do të ishte profet dhe do të vinte nga familja e tyre. Perëndia u tha izraelitëve të dëgjonin gjithçka që do t'u thoshte ky profet. A mendoni që e dini se cili është ky person i veçantë? Nëse e dini, mos e thoni! Le ta shohim nëse e keni gjetur.

Stefani deklaron se drejtuesit fetarë judenj e kishin tradhëtuar dhe vrarë profetin e veçantë

Më në fund izraelitët po jetonin në tokën që Perëndia u kishte premtuar, mirëpo ata nuk i besuan gjithmonë Perëndisë. Kjo nisi kohën e gjyqtarëve, si Samsoni (*drejtohu te kronologjia*) dhe kohën e mbretërve, si Davidi (drejtohu te kronologjia). Me kalimin e kohës izraelitët u pushtuan dhe u shpërndanë në shtete të ndryshme. Mirëpo, Perëndia ishte gjithmonë me ta. Ai do të sillte personin më të veçantë të botës prej familjes së tyre. Më shumë se 400 vite më pas *(drejtohu te kronologjia)* ndodhi.

Lexo Veprat e Apostujve 7:51-53

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Kush ishte profeti i veçantë që do ta tradhëtonin e do ta vrisnin? (Jezusi) *Drejtohu te kronologjia.* A mendoni se drejtuesve fetarë judenj u pëlqeu ajo që dëgjuan? Çfarë mendoni se i bënë Stefanit?

Stefani vritet me gurë

Lexo Veprat e Apostujve 7:54-60

Përmbledhje dhe parafrazim i Veprat e Apostujve 8:1-3: Ata e vranë Stefanin! Pasi vranë Stefanin, vranë edhe shumë të tjerë në kishë. Ata bënë diçka të tmerrshme, mirëpo ku shkoi Stefani? (Në qiell!) Ai do të ishte me Jezusin përgjithmonë! Çfarë i tha Stefani Perëndisë para se të vdiste? (I kërkoi të mos ua ngarkonte atyre mëkatin së tij)

A ju kujtohet vargu nga "Mendo si duhet"? Le ta themi tani. *Kërkoju nxënësve të recitojnë 1 e Korintasve 15:58.* A qëndroi i patundur Stefani dhe a e dha plotësisht veten për veprën e Zotit? (Po, ai dha gjithçka kishte!)

Përfundimi

Stefani ishte plot siguri! Ai qëndroi i patundur dhe u tregoi drejtuesve fetarë planin e Perëndisë dhe të vërtetën e Jezusit. Ata e kishin tradhëtuar dhe vrarë profetin e veçantë që kishte dërguar Perëndia. Jezusi ishte Ai që erdhi t'i shpëtonte nga ndëshkimi i mëkatit të tyre, por ata nuk i besuan Atij, ndaj e kryqëzuan. Stefani donte që ata të kuptonin veprimin e tmerrshëm që kishin bërë, që të besonin në Jezusin dhe të shpëtoheshin, përkundrazi ata u zemëruan aq shumë, saqë e vranë.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Shumë njerëz duhet të dëgjojnë për Jezusin. Disa do të besojnë, të tjerë jo. Nëse ti e ke pranuar Jezusin si Shpëtimtarin tënd dhe u tregon të tjerëve për Të, disa njerëz mund të zemërohen me ty dhe të mos jenë më miqtë e tu. Mirëpo ti nuk duhet të kesh frikë. Perëndia është me ty. Ai të ka dhënë Frymën e Tij të Shenjtë për të të ndihmuar të qëndrosh i patundur dhe që t'u tregosh me bindje njerëzve të vërtetë për Jezusin, siç bëri Stefani. Perëndia dëshiron të na përdorë ne që t'i ndihmojmë njerëzit të shpëtojnë nga mëkati dhe të shkojnë në qiell.

Po ti? A ke besuan në Jezusin? A duhet të dëgjosh më shumë për faljen e Tij? *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes "Librit pa fjalë" dhe për të bërë një ftesë që ta pranojnë Atë si Shpëtimtar.*

Javën e ardhshme do të mësojmë për një person tjetër që përdori Perëndia. Gjatë kësaj jave trego qëndrueshmëri dhe foli dikujt për Jezusin!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Kush ishte Stefani? (Një nga shtatë ndihmësit e dishepujve)
2. Përse kishin nevojë për ndihmë dishepujt? (Kisha po rritej shumë shpejt)
3. Për çfarë e akuzuan drejtuesit fetarë Stefanin? (Për blasfemi – se nuk po respektonte Perëndinë)
4. Çfarë u shpjegoi Stefani drejtuesve fetarë? (Ai u shpjegoi planin e Perëndisë dhe të vërtetën se çfarë i kishin bërë ata Jezusit, Birit të Perëndisë)
5. Çfarë i bënë drejtuesit fetarë Stefanit kur ai tregoi të vërtetën për Jezusin? (Ata e vranë me gurë)
6. Çfarë i tha Stefani Perëndisë para se të vdiste? (I kërkoi të mos ua llogariste atyre mëkatin e vrasjes së tij)
7. Ku shkoi Stefani pasi vdiq? (Në qiell)
8. A je gati të qëndrosh i palëkundur dhe t'u tregosh njerëzve të vërtetën për Jezusin?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 11
Veprat 8:1-5, 8:26-40

Kupto si duhet:	Filipi i tregon etiopasit për Jezusin.
Mendo si duhet:	"Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos mburret. Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezusin për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to." Efesianëve 2:8-10
Vepro si duhet:	Unë do t'i shërbej Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar kur Perëndia më lejon t'i shërbej.

PËRGATITU!

Këtë javë do t'i nxisim fëmijët që të mendojnë se si mund t'i shërbejnë Perëndisë. Shumë prej tyre mund të kenë mundësinë të dishepullojnë fëmijë të tjerë në të ardhmen – siç po bën ti! Inkurajohu se kjo është një thirrje e lartë dhe e shenjtë, që t'i përdorësh dhuntitë e tua për të shpallur Ungjillin me fëmijët dhe që t'u mësosh atyre se çfarë do të thotë të ndjekësh Jezusin.

Lutu: Perëndia i njeh të gjithë fëmijët që ke në klasë dhe e di të ardhmen e tyre. Lutu që, përmes këtij mësimi, ata të kenë dëshirë ta lejojnë Perëndinë të përdorë dhuntitë, talentet dhe gjithë jetën e tyre për qëllimin dhe lavdinë e Tij.

Lexo: Veprat 8:1-5, 8:26-40

Kupto si duhet: Filipi i tregon etiopasit për Jezusin
Vdekja e Stefanit u ndoq nga një sërë përndjekjesh ndaj atyre që ndiqnin Jezusin. Një nga rezultatet e kësaj përndjekjeje ishte shpërndarja e dishepujve në veri dhe në jug të Izraelit. Kështu, mesazhi i Ungjillit u shpërnda ngado dhe trupi i besimtarëve të krishterë u rrit. Perëndia po vepronte dhe plani i Tij nuk do të dështonte. Pjesë e këtij plani ishte takimi i Filipit me një zyrtar të lartë të mbretëreshës së Etiopisë. Etiopasi ishte një eunuk që po kthehej në shtëpi nga një udhëtim adhurimi në Jerusalem. Takimi i caktuar prej së larti e arriti qëllimin kur Perëndia e përdori Filipin që ta çonte eunukun drejt shpëtimit në Krishtin. Kjo ngjarje na tregon se sa e rëndësishme është që, pavarësisht rrethanave, të jemi gati për t'i shërbyer Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor: Për hir të këtij mësimi, do të themi se një eunuk është një zyrtar i veçantë i pallatit mbretëror.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Duke përdorur letër duarsh në tub, krijo një shteg. Kërkoju nxënësve të ulen përgjatë shtegut (me Biblat e tyre) ndërkohë që ti shpjegon. Thekso ngjarjet e ndryshme që ndodhën në pasazhin nga Shkrimi.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Shërbeji Perëndisë!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të mendojnë se si **Perëndia mund të përdorë pasionet e tyre për t'i shërbyer Atij** dhe për të ndërtuar kishën.

<u>**Aktiviteti 1:** Stacioni i artit</u>

Mjetet:

- Fletë punëdore, në të cilën është vizatuar një siluetë njeriu dhe ku shkruhet: "**Perëndia mund t'i përdorë pasionet e mia!**" (burim i printueshëm)
- Bojëra dhjami, lapustila dhe lapsa me ngjyra

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit që për pak çaste të mendojnë për gjërat që **u pëlqen të bëjnë** dhe pastaj të mendojnë se si **Perëndia mund t'i përdorë ato pasione për t'i shërbyer Atij**. Bëju pyetjet e mëposhtme që të mendojnë:
   - Çfarë të pëlqen të bësh?
   - Si mund ta **përdorë Perëndia pasionin tënd**, që të tjerët të mësojnë për Të?
   - Ndoshta të pëlqen të vizatosh. Si mund ta përdorë Perëndia këtë talent që t'u mësojë të tjerëve për Jezusin?
   - Po nëse të pëlqejnë video-lojërat, si mund ta përdorë Perëndia këtë pasion?
   - Nëse të pëlqejnë avionët, a mund të të përdorë Perëndia si misionar në një vend të largët?
   - Po nëse dëshiron të punosh shumë e të bësh para? Perëndia mund të të përdorë që të financosh projekte misioni apo kisha.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Shpërndaju fletëpunëdoret dhe lajmëro se do të ketë një garë për pikturën më të bukur që tregon se si Perëndia mund t'i përdorë pasionet tona. Nxënësi me pikturën më të mirë do të fitojë dhjetë etiketa shpërblyese.
3. Mësuesit dhe ndihmësit duhet të flasin vazhdimisht me nxënësit, duke i sfiduar që të mendojnë përtej ëndrrave të tyre... të mendojnë me "përmasat" e Perëndisë.
4. Varini pikturat te "stacioni i artit" që t'i shohin të tjerët.

Aktiviteti 2: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Kartonë të vegjël me figurat e këtyre objekteve: një avion, lapustila, një makinë, një kompjuter, një top basketbolli, një top futbolli, matematikë, një laps (shkrimi), qepje, gatimi, mjete për ndërtim, një këpucë (vrap), nota muzike (këngë), një piano, një biçikletë dhe një foshnjë (kujdesi për fëmijët e vegjël) (burim i printueshëm)
- Një tabelë për të shënuar pikët
- Etiketa shpërblyese



Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në disa skuadra.
2. Zgjidh një person nga çdo skuadër që të vijë te drejtuesi i KZ-së, i cili do të t'i tregojë vetëm atij një nga letrat/kartonët me figura. Kur ta kenë parë letrën e tyre, ata do të nxitojnë te skuadra për ta krijuar objektin me plastelinë, por pa folur. Skuadra e parë që e gjen se çfarë po formon shoku i tyre, fiton pesë pikë.
3. Pastaj pyeti: "Si mund ta përdorë Perëndia këtë objekt/veprim për shërbesë (për t'i drejtuar njerëzit te Perëndia)?" Skuadra e parë që përgjigjet do të fitojë pesë pikë.
4. Përsëriteni derisa të përfundojë koha.
5. Skuadra me më shumë pikë në fund, do të fitojë nga dy etiketa shpërblyese për çdo anëtarë.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 3-të, tremujori i 3-të.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesi kryesor – Lidhja e KZ-së me mësimin: A mundet vërtet Perëndia të përdorë pasionet e tua që njerëzit të mësojnë më shumë për Jezusin? Çfarë të pëlqen të bësh? A mendon se Ai mund të përdor talentin tënd në futboll për të nisur një kamp sportiv, ku fëmijët mësojnë më shumë për futbollin dhe gjithashtu dëgjojnë Ungjillin? Apo aftësinë tënde për të ndërtuar me LEGO, që të projektosh një kishë apo një spital?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: *Kërkoji njërit prej nxënësve që të lutet specifikisht që Perëndia t'i sfidojë sot që t'i përdorin dhuntitë e tyre për t'i shërbyer Perëndisë.*

Zbuloje: A gjendet libri i Veprave të Apostujve në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh.R.) Le t'i hapim Biblat te libri i Veprave të Apostujve, kapitulli 8.

Kronologjia: *Gjatë mësimit do t'i referohemi kronologjisë.*

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Para se Jezusi të shkonte në qiell, u dha dishepujve një udhëzim shumë të rëndësishëm. Te Mateu 28:19-20 Ai tha: "Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, duke i mësuar të mbajnë të gjitha sa ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.". Kjo quhet Porosia e Madhe. Perëndia dëshiron që në na përdorë për t'u treguar të tjerëve se Jezusi mund t'i falë e t'i shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit. A nuk je mirënjohës që dishepujt e Jezusit iu bindën urdhërimeve të Tij?

Javën e kaluar mësuam se Stefani (*drejtohu te kronologjia*) u përndoq dhe u vra me gurë kur e tregoi me guxim të vërtetën e Jezusit. Sot do të mësojmë se çfarë ndodhi pasi Stefani vdiq dhe u ngjit në qiell.

Përvijimi i Shkrimit: 1 i Mbretërve 19:19-21; 2 i Mbretërve 2:1-18

Kisha përndiqet dhe shpërndahet

Lexo Veprat e Apostujve 8:1-5

Përmbledhje: Përndjekja duhet të ketë qenë shumë e vështirë për dishepujt e Jezusit. Por Perëndia ynë është kaq i mrekullueshëm! Edhe pse përndjekja ishte e vështirë, Perëndia e përdori për mirë dhe i përdori dishepujt e shpërndarë kudo që t'u tregonin edhe popujve të tjerë për Jezusin. Do të mësojmë për një popull tjetër tani.

Një engjëll e dërgon Filipin në një rrugë të shkretë

A ju kujtohet që dishepujt e Jezusit zgjodhën shtatë burra që t'i ndihmonin? Stefani, për të cilin mësuam javën e kaluar, ishte njëri prej tyre. Një tjetër nga të shtatët ishte Filipi. Perëndia kishte një punë të veçantë për Filipin. A ju kujtohet vargu nga "Mendo si duhet", Efesianëve 2:8-9? Le ta themi së bashku. *Recitoni së bashku Efesianëve 2:8-9 dhe pastaj ti recito/lexo Efesianëve 2:10: "Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to."* Le të zbulojmë se çfarë vepre të mirë donte Perëndia që të bënte Filipi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo Veprat e Apostujve 8:28

Përmbledhje: Ua!... një engjëll i Zotit i tha Filipit të shkonte në një rrugë të shkretë. Përse do t'ia kërkonte një engjëll këtë? Pyes veten nëse Filipi iu bind engjëllit. Mendoje pak. Miku i tij, Stefani, sapo ishte vrarë, sepse i shërbeu Perëndisë duke u folur njerëzve për Jezusin. A mendoni se Filipi ishte gati t'i shërbente Perëndisë pasi kishte ndodhur kjo? Le ta zbulojmë.

Filipi takon etiopasin

Lexo Veprat 8:27-30a

Përmbledhje: Që takoi gjatë rrugës Filipi? (Një burrë nga Etiopia) Etiopia është larg Jerusalemit. Mbretëresha e Etiopisë quhej Kandace. Etiopasi ishte zyrtari i lartë përgjegjës për të gjitha pasuritë e mbretëreshës Kandace. Përse shkoi në Jerusalem ky etiopas? (Për të adhuruar Perëndinë) Edhe pse ai jetonte në një shtet tjetër, ai shkoi deri në Jerusalem për të adhuruar Perëndinë, siç bënin judenjtë. Çfarë po lexoni ai kur Filipi u has me karrocën? (Fjalën e Perëndisë te libri i Isaias; Isaia ishte profet) A gjendet libri i Isaias në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Në Dhiatën e Vjetër) Le të zbulojmë se përse etiopasi po lexonte librin e Isaias.

Etiopasi është kërkues

Lexo Veprat e Apostujve 8:30b-31

Përmbledhje: *Kërkoju nxënësve të gjejnë figurën e Filipit dhe etiopasit në kronologji.* A e kuptonte etiopasi se çfarë po lexonte në Bibël? (Jo) Për çfarë tha ai se kishte nevojë? (Për dikë që t'ia shpjegonte) A mendoni se ishte gjë e mirë që etiopasi donte që dikush t'ia shpjegonte Fjalën e Perëndisë? (Po!) Ne i quajmë "kërkues" njerëzit që po përpiqen të zbulojnë të vërtetën për Perëndinë dhe Fjalën e Tij, "sepse ata po kërkojnë të vërtetën". A mendoni se Perëndia donte që Filipi t'i shërbente duke ndihmuar etiopasin kërkues? (Po) A duket se Filipi është gati t'i shërbejë Perëndisë? (Po!) Le të dëgjojmë se çfarë po përpiqej të kuptonte etiopasi.

Etiopasi po lexon profeci për Jezusin

Lexo Veprat e Apostujve 8:32-33

Përmbledhje: Kujtoni që Isaia është një nga profetët e Perëndisë. Ai u dha njerëzve mesazhin e Perëndisë për çfarë do të ndodhte në të ardhmen. Le të vazhdojmë të lexojmë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Filipi i tregon etiopasit për Jezusin

Lexo Veprat e Apostujve 8:34

Përmbledhje: Etiopasi donte të dinte se kush ishte burri për të cilin u dha profecia. A mendoni se e dini ju? A do të mund ta kishit ndihmuar etiopasin të kuptonte Fjalën e Perëndisë? Për kë mendoni se është profecia? *Lexoni sërish pasazhin nga Isaia nëse është e nevojshme (Veprat 8:32-33). Jepu mundësinë nxënësve të përgjigjen.*

Le të shohim se çfarë i tha Filipi dhe nëse e keni gjetur edhe ju.

Jezusi është përgjigjja

Lexo Veprat e Apostujve 8:35

Përmbledhje: Keni të drejtë! Profecia është për Jezusin! Pastaj Filipi i tregoi etiopasit Lajmin e Mirë se si mund të shpëtonte nga mëkati!

Ungjilli

Po ti? A ke besuar në Lajmin e Mirë? *Trego faqen e zezë, të kuqe dhe të bardhë të "Librit pa fjalë"*. A mendon se etiopasi zgjodhi të besonte në Jezusin për të shpëtuar nga mëkati? Le ta zbulojmë!

Etiopasi shpëton nga mëkati

Lexo Veprat 8:36-40

Përmbledhje: A besoi etiopasi në Jezusin për të shpëtuar nga mëkati? (Po) Si e tregoi? (Ai i kërkoi Filipit ta pagëzonte në ujë) A mendoni se Filipi ishte gati për t'i shërbyer Perëndisë? Si e dini këtë? (Po, ai vazhdoi të udhëtonte dhe t'u tregonte njerëzve për Jezusin) Le të mendojmë për gjithçka që kemi mësuar.

Përfundimi

Edhe pse vrasja me gurë e Stefanit ishte e gabuar, a e përdori Perëndia për mirë? (Po) Si? (Dishepujt u shpërndanë dhe u treguan njerëzve nëpër vendet e tjera për Jezusin) Edhe pse duhet të ketë qenë periudhë e frikshme, a ishte Filipi gati për t'i shërbyer Perëndisë? (Po) Si e përdori Perëndia Filipin? (Ai u tregoi njerëzve dhe etiopasit se si Jezusi mund t'i shpëtonte nga ndëshkimi i mëkatit)

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Nëse Perëndia do të të kërkonte t'i përdorje dhuntitë e tua për t'i shërbyer Atij (*referoju "Kohës së zbulimit"*), a do ta bëje? Efesianëve 2:10 e bën të qartë se Perëndia ka një plan për ty dhe aftësitë e tua – Ai ka planifikuar paraprakisht dicka të madhe për ty. T'i shërbesh Perëndisë është një nder dhe një aventurë emocionuese!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Çfarë ndodhi me dishepujt e Jezusit pasi Stefanin e vranë me gurë? (Ata u shpërndanë nëpër vende të tjera)
2. Kë donte Perëndia që të takonte Filipi? (Etiopasin)
3. A besonte etiopasi në Perëndinë? Si e dini këtë? (Po, ai kishte shkuar në Jerusalem për të adhuruar Perëndinë dhe po lexonte Fjalën e Perëndisë)
4. Çfarë problemi kishte etiopasi? (Ai nuk e kuptonte Fjalën e Perëndisë)
5. Çfarë donte Perëndia që të bënte Filipi për etiopasin? (T'i shpjegonte se si Jezusi mund ta shpëtonte nga mëkati)
6. Çfarë ndodhi kur Filipi i tregoi etiopasit për Jezusin? (Ai besoi dhe u pagëzua)
7. Përse donte të pagëzohej etiopasi? (Që të tregonte se besonte në Jezusin)
8. A je gati për t'i shërbyer Perëndisë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 12
Dita e përsëritjes

Kupto si duhet:	Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht." 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të kujtoj Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem plot urtësi kur kujtoj Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

Një temë që përsëritet vazhdimisht në Shkrim është udhëzimi që Perëndia i jep popullit të tij për të marrë kohë për të kujtuar gjërat që Ai ka bërë. Pikërisht këtë gjë bëjmë çdo tremujor; e ndërpresim rrjedhën e zakonshme për të kujtuar e festuar për gjërat që Perëndia na ka mësuar për Veten përmes Fjalës së Tij. Ndërsa përgatitemi këtë javë le të kalojmë disa çaste për të rishikuar mësimet dhe për të falënderuar Perëndinë për çfarë na ka mësuar dhe për rritjen e nxënësve tanë. Le të shijojmë e festojmë së bashku ndërsa kujtojmë mirësinë e Perëndisë!

Lutu: Ndërsa bëjmë rishikimin këtë javë, lutu që nxënësit e tu të kujtojnë çfarë kanë mësuar dhe të jenë të zellshëm për ta zbatuar në jetën e tyre.

Kupto si duhet: Urtësia e vërtetë vjen nga Fjala e Perëndisë
Tanimë përfundon studimi ynë i Dhiatës së Re, ndërsa në këtë ditë kujtojmë të vërtetat e rëndësishme që kemi mësuar për t'u rritur në hirin dhe njohjen e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë. Pas disa javësh do të rikthehemi në kohët entuziazmuese të Dhiatës së Vjetër, ku do të shohim veprat e mrekullueshme dhe të fuqishme të Perëndisë në jetën e shumë njerëzve. Deri atëherë, kujtojmë Fjalën e Perëndisë dhe e zbatojmë çdo ditë të jetës.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit

Shënim: Nuk do të ketë "Kohë zbulimi" këtë javë për shkak të aktivitetit ndërveprues rishikues.

Aktiviteti i rishikimit në klasë: Garë përreth klasës!

Lutu: *Sfido njërin nga nxënësit ta nisë mësimin me lutje. Kjo do t'i ndihmojë të luten në publik, të fitojnë siguri dhe të zhvillojnë aftësitë e udhëheqësisë frymërore.*

Mjete për aktivitetin:

- Letra A4 me ngjyra të ndryshme ose katrorë të vegjël me ngjyra (vendosi në dyshme, jashtë skajeve të dhomës; vija e parë duhet caktuar si "nisje" dhe e fundit duhet caktuar si "përfundim"; është më mirë të mos ketë tavolina në klasë)
    - **Ide alternative:** Në vend të letrave të mëdha përdor katrorë të vegjël dhe vendosi rreth skajeve të një tabele dhe thuaju nxënësve të garojnë përreth tabelës në vend që të garojnë përreth klasës.
- Një rrotë fati me numrat 1-4, ku të paktën në njërën nga hapësirat të shkruhet "Kthehu 3 hapësira mbrapa" dhe njëra "mos hidh një radhë" (ose përdor një zar të madh dhe zëvendëso numrat "5" dhe "6" me "shko 3 hapësira mbrapa" dhe "mos hidh një radhë")
- Nga një kon për skuadër (ose lapustila të vogla nëse po përdor tabelën)
- Pyetjet e rishikimit të mësimeve
- Pyetjet e hartës së gjurmuesit (gjenden te shtojca)
- Letra/kartonë të vegjël (një për çdo nxënës)
- Lapsa me ngjyra, lapsa plumbi ose lapustila të holla

Kioskë dhuratash: Krijoni një kioskë tërheqëse në korridor apo jashtë klasës; ky do të jetë vendi ku do të marrin çmimet. Disa ide për ushqimet e kioskës: dhurata të vogla (libërshënues, byzylykë të "Librit pa fjalë", etj.), ushqime, fruta, lëngje frutash, karamele, petulla, etj. **Ide alternative:** Krijo një kuti të vogël thesari ku nxënësit të marrin dhuratat.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzimet:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me gjashtë deri në tetë nxënëse dhe jepi secilit një kon me ngjyrë.
2. Cakto drejtues që: të lëvizin konët, të bëjnë pyetjet dhe të "vrapojnë me fëmijët" për te kioska e dhuratave.
3. Konët e skuadrave duhet të jenë te vija e nisjes.
4. Një nxënës nga secila skuadër duhet të rrotullojë rrotën e fatit, që do të përcaktojë se cila skuadër nis e para. Skuadra me numrin më të madh nis e para.
5. Bëj pyetjen e parë. Nëse përgjigjen saktë, mund të rrotullojnë rrotën dhe ta lëvizin konin e skuadrës po aq hapësira sa numri që u ka rënë. Nëse nuk përgjigjen saktë, u kalon radha.
6. Pyetja e radhës i bëhet skuadrës tjetër. Edhe për ata, nëse përgjigjen saktë, mund të rrotullojnë rrotën dhe të lëvizin konin po aq vende sa pikë marrin. Nëse gabojnë, u kalon radha. (Këshillë: Për ta shpejtuar lojën, nise pyetjen ndërkohë që skuadra pararendëse po lëviz konin.)
7. Loja vazhdon derisa njëra nga skuadrat mbërrin në katrorin e fundit (emërtuar "e përfundimit") të fushës së lojë. Kur të ndodhë kjo, skuadra nxiton për te kioska e dhuratave për të marrë çmimin.
8. Loja duhet bërë me ritme të shpejta. Ndërkohë që skuadra fituese shkon te kioska e dhuratave, loja nuk ndalon. Skuadra tjetër vazhdon me pyetjet.
9. Kur skuadra e radhës të arrijë te katrori i fundit, e gjithë skuadra shkon te kioska e dhuratave.
10. Skuadrat duhet të nxitojnë për të shkuar dhe për t'u kthyer nga kioska që të kenë mundësi të fitojnë sërish.
11. Vazhdojeni lojën derisa të kenë mbetur dhjetë minutat e fundit.
12. Shpërndaju letrat/kartonët e vegjël dhe kërkoju të shkruajnë se çfarë kanë mësuar gjatë tremujorit dhe si do ta zbatojnë në jetën e tyre, si dhe të shënojnë një kërkesë lutjeje për të cilën drejtuesi mund të lutet gjatë verës. Kujtoju të shënojnë emrat e tyre.
13. Ndërsa fëmijët largohen, mblidh letrat/kartonët e vegjël.

Alternativë: Mësuesi mund të shkruajë një shënim inkurajues në pjesën e pasme të letrës/kartonit dhe t'ua dërgojë më vonë nxënësve.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shtojca

Harta e gjurmuesit

Mësimi tematik: Lajmi i mirë!

Kupto si duhet:	Jezusi është i gjallë!
Mendo si duhet:	"Por ta falënderojmë Perëndinë që na jep fitore me anë të Zotit tonë Jezu Krisht." 1 e Korintasve 15:57
Vepro si duhet:	Unë do ta jetoj jetën, duke ditur se Jezusi është i gjallë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem plot vetëbesim, duke ditur se Jezusi është i gjallë.

PËRGATITU!

Pashka është koha kur festojmë faktin që Jezusi është i gjallë. Ai fitoi mbi vdekjen! Sa bukur të dish se, Ai që vdiq për mëkatin tonë është i gjallë edhe sot! Le të festojmë me gëzim për këtë fitore të jashtëzakonshme!

Lutu: Lutu për çdo fëmijë që do të vijë sot. Kërkoji Perëndisë t'u japë sigurinë e nevojshme për ta ndarë kuptimin e vërtetë të Pashkës me të afërmit e tyre pas takimit.

Lexo: Vargje të ndryshme (shih mësimin)

Kupto si duhet: Jezusi është i gjallë!

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Gjatë Pashkës vijnë shumë vizitorë për herë të parë. Përdore mësimin për të treguar qartësisht kuptimin e Pashkës dhe për të shpallur Ungjillin. Përdore gjithashtu si mundësi për të sfiduar nxënësit që vijnë rregullisht, që ta ndajnë Ungjillin me prindërit dhe me të afërm të tjerë sot.
- Kontrollo kronologjinë. A e keni vendosur një kryq te figura e ringjalljes në kronologji? Kryqi duhet të jetë epiqendra e planit të mrekullueshëm të Perëndisë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ide krijuese për mësimin biblik:
Përdor objektet e renditura më poshtë për të shpjeguar mësimin (sa më të mëdha objektet, aq më mirë). Në fund të mësimit nxënësit mund të hanë një ose dy karamele që përkojnë me temën për të cilën do të flisni.

a. Një zemër e artë në të cilën shkruhet "Perëndia të do!"
b. Fjala "mëkat" me shkronja të mëdha dhe të errëta (mund t'i prisni në kartonë ose në sfungjerë)
c. Fjala "Jezus" me shkronja të mëdha, të kuqe (mund t'i prisni në kartonë ose në sfungjerë)
d. Tabelë dhe lapustilë
e. Fjala "Rritu" me shkronja të mëdha, të gjelbra dhe një bimë me lule

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Fabrika e karameleve

Qëllimi: T'u prezantojmë "Librin pa fjalë" atyre që janë për herë të parë dhe t'i sfidojmë ata që vijnë rregullisht që ta përdorin "Librin pa fjalë" si mjet për të shpallur kuptimin e vërtetë të Pashkës me familjet e tyre.

<u>Vendndodhja: Hapësirë e madhe</u>
Mjetet:



- Bileta të arta për në fabrikën e karameleve (burim i printueshëm)
- Karamele me ngjyrat e "Librit pa fjalë" (3-5 për çdo ngjyrë, për çdo nxënës)
- Qese të vogla (për t'i marrë karamelet me vete)
- Lapustila (që të shkruajnë emrat te qeset e tyre)
- Etiketa shpërblyese
- Fletushkat "E beson apo jo" (nga një për çdo nxënës)
- Fabrika e karameleve
    - Krijo një vendndodhje argëtuese (ose tendë), ku karamelet me ngjyrat e "Librit pa fjalë" mund të lëshohen përmes një tubi në qeset e nxënësve. Përgatiti paraprakisht racionet e karameleve (3-5 për çdo ngjyrë), në mënyrë që "Punëtorët e karameleve" t'i hedhin te tubi, prej nga do të përfundojnë te qeset e nxënësve. Përdorni një zile për t'u lajmëruar

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

punëtorëve të fabrikës së karameleve se kur t'i "lëshojnë" karamelet. Vendi duhet të jetë tërheqës – mendo filmin "Çarli dhe fabrika e çokollatës". Pasi të kenë kapur karamelet, duhet të shënojnë emrin e tyre te qesja dhe të kthehen te loja. Alternativë: Përgatite një javë përpara ambientin që të nxitet entuziazmi për ditën e Pashkës.

- Objekte me ngjyrat e "Librit pa fjalë" (nëpër të gjithë ambientin krijo pesë hapësira të ndryshme; secila duhet të përkojë me njërën nga ngjyrat e "Librit pa fjalë"; ide: tullumbace, konë, flamuj, letra me ngjyra, etj.)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Nxënësit do të ulen në qendër të ambientit.
2. Thuaju se do të luajnë për të fituar një biletë për te "Fabrika e karameleve".
3. Thuaj: "Flasim shpeshherë për pesë ngjyra të veçanta. Secila prej tyre ka një kuptim specifik. Le të bëjmë një përsëritje të shkurtër. E arta = dashuria e Perëndisë/qielli, E zeza = mëkati, E kuqja = Jezusi vdiq për ne (gjaku), E bardha = I falur/pastër, E gjelbra = Rritu në ngjashmëri me Jezusin".
4. Shpjegoju se si mund ta fitojnë biletën për te "Fabrika e karameleve": Do të vini re se këto ngjyra janë të shpërndara nëpër klasë. Unë do të them një fjalë dhe ju duhet të vraponi te ngjyra që i përket. (Shënim: Në bazë të numrit të nxënësve, përshtat edhe sasinë.) Unë do të them fjalët njëra pas tjetrës dhe ju duhet të vraponi te ngjyra përkatëse. Pesë nxënësit e fundit do të fitojnë biletën për te "Fabrika e karameleve"!
5. Thuaju: "Pa merak! Pasi të shpallen pesë fituesit e parë, do të luajmë edhe disa raunde të tjera, derisa të gjithë të kenë fituar mundësinë për të shkuar te "Fabrika e karameleve". Nëse fitoni më shumë se një herë, do të merrni etiketa shpërblyese në vend të karameleve, ndaj nxitoni!"
6. Sigurohu që nxënësit të mos i hanë menjëherë karamelet. Do t'i përdorim gjatë mësimit.
7. Nxënësit që digjen mund të ndihmojnë për të parë kush digjet.
8. Pas raundit të parë, fillojeni sërish lojën dhe përsëriteni derisa të gjithë të kenë shkuar te "Fabrika e karameleve".
9. Kur të jeni afër fundit, jepu bileta edhe atyre që nuk kanë fituar, që të mund të shkojnë te fabrika.



Shënim: Kjo lojë ka për qëllim përsëritjen e ngjyrave dhe fjalëve kyç të "Librit pa fjalë".

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Në çfarë ngjyrash i keni karamelet? A mund të më tregojë ndonjëri nga ju se çfarë i kujton secila nga ngjyrat? Mbajeni para vetes qesen me karamele ndërsa shpjegoj mësimin.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të nisë mësimin me lutje. Kujtoju se kur lutemi, flasim me Perëndinë.*

Zbuloje: Sot do t'i hapim Biblat te libri i Markut, kapitulli 15. A gjendet Marku në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh.R.)

Kronologjia: Le ta gjejmë Dhiatën e Re te kronologjia! *Drejtohu te kronologjia e Biblës.* Aty mësojmë për vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Sot është Pashka, mirëpo, përse është kaq e veçantë Pashka? Unë do t'ua tregoj juve, pastaj ju duhet t'ua tregoni prindërve, gjyshërve dhe miqve duke përdorur karamelet që keni.

Përvijimi i Shkrimit

Perëndia të do

Lexo Gjonin 3:16a

Përmbledhje: Kur të shihni ngjyrën e verdhë ose të artë *(drejtohu për nga zemra e artë),* dua të mendoni se sa shumë ju do Perëndia. Ky varg thotë: "Sepse Perëndia e deshi aq botën..." Perëndia e krijoi botën dhe njerëzit. Për këtë mund të lexojmë te Zanafilla, kapitulli 1. *Drejtohu te fillimi i kronologjisë.* E po, edhe ju jeni pjesë e "botës"! Sa shumë ju do Perëndia? Ai ju do aq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij të vetëm e të përsosur që të vinte në këtë botë. Përse e bëri këtë? Ai e dërgoi Birin e Tij për të na shpëtuar. Për këtë shpëtim do t'ju flas pas pak. Në Krishtlindje ne festojmë për lindjen e Birit të Tij, Jezusit. *Drejtohu te fjala "Jezus".* Jezusi lindi në një qytet të quajtur Bethlehem, u rrit në një vend të afërt të quajtur Nazaret dhe jetoi një jetë të vërtetë, si ju. Ai ishte një fëmijë i vërtetë që luajti, punoi, hëngri dhe fjeti, megjithatë, mes Jezusit dhe fëmijëve të tjerë kishte një ndryshim SHUMË të madh – Jezusi ishte Perëndi!

Ai është plotësisht i përsosur, plotësisht i shenjtë dhe plotësisht i mirë. Ai nuk ka mëkatuar kurrë dhe asnjëherë nuk ka bërë ndonjë gabim. Kjo e bën Atë të Vetmin që mund të na shpëtojë.

Shënim për mësuesin kryesor: Do t'i referohemi qiellit edhe në fund të mësimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mëkati

Mirëpo, nga çfarë duhet të shpëtohemi? (Nga ndëshkimi për mëkatin tonë) *Drejtohu te fjala "mëkat".* Çfarë është mëkati dhe çfarë është ndëshkimi për mëkat? (Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë kundër Perëndisë) Bibla na e tregon shumë qartë se si duhet të jetojmë. Por, kur ne zgjedhim të themi: "Nuk do të veproj siç i pëlqen Perëndisë, do veproj si dua vetë", bëjmë mëkat. Mëkati shkakton dhimbje, lëndim dhe trishtim. Mund të mos e kuptosh fillimisht, mirëpo depërton ngadalë brenda teje dhe të shkatërron. Ndëshkimi për mëkatin është ndarja e përjetshme nga Perëndia, që do të thotë se nuk mund të kesh marrëdhënie me Të dhe nuk mund të shkosh në qiell.

Lexo Romakëve 3:23
Përmbledhje: Ky varg na thotë se mëkati na ndan nga Perëndia. *Merr fjalën "mëkat" dhe largoje nga "dashuria e Perëndisë".*

Ky është lajm i keq. A ju kujtohet që ju thashë se Perëndia dërgoi Jezusin për të na shpëtuar? E po, ja nga çfarë duhet të na shpëtojë.

Jezusi

Jezusi jetoi një jetë të përsosur këtu në tokë, ndryshe nga çdo person tjetër. Në Bibël mësojmë se njerëzit filluan ta fajësonin Jezusin se kishte bërë gjëra të gabuara. Ata madje donin ta vrisnin, edhe pse sunduesi i kohës, i quajtur Pilat, e deklaroi Jezusin të pafajshëm.

Lexo Markun 15:13-14
Përmbledhje: Jezusi vdiq. Ai vdiq që të na shpëtonte nga faji dhe ndëshkimi i mëkatit.

Lexo Hebrenjve 9:22b
Përmbledhje: Bibla na mëson se mund të shpëtojmë nga mëkati vetëm nëse një njeri i përsosur do të vdiste në vendin tonë. Jezusi është ai person. Perëndia e dinte që prej fillimit se do ta dërgonte Birin e Tij, Jezusin, në tokë si foshnjë, se Ai do të vdiste që ne (ti dhe unë) të mund të shpëtonim. *Drejtoju kryqit te kronologjia.*

Mësimi nuk ka mbaruar ende... Jezusi nuk mbeti i vdekur. *Drejtohu te ringjallja e Jezusit në kronologji.* Jezusi fitoi mbi vdekjen dhe u ringjall! Ai u rikthye në jetë!

Lexo 1 e Korintasve 15:3b-6a

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Jezusi u ringjall dhe iu shfaq njerëzve. Prandaj e festojmë Pashkën. Jezusi është i gjallë!

I pastër

Lexo Veprat e Apostujve 16:31

Përmbledhje: Sa lajm i mirë! Nëse beson në Jezusin, mund të marrësh falje dhe të shpëtosh nga ndëshkimi i mëkatit. Le të shohim tabelën. Mëkati e pushton jetën tonë. Shkruaj lloje të ndryshme mëkati në tabelë si: gënjeshtra, vjedhja, sjellja e keqe dhe egoizmi. Mirëpo, për shkak të asaj që Jezusi bëri në kryq, Ai mund të na shpëtojë nga ndëshkimi për këto mëkate, duke na falur. Fshije tabelën. Kur ne pranojmë Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, mëkatet tona hiqen dhe falen përgjithmonë.

Jezusi është i Vetmi që mund ta fshijë mëkatin tonë. Megjithatë, secili prej nesh duhet të zgjedhë t'i kërkojë Atij që ta fshijë mëkatin. Ai nuk detyron askënd ta marrë këtë vendim. Ai të lejon të zgjedhësh të besosh. A dëshiron që Jezusi të të shpëtojë? A i ke kërkuar Jezusit të falë ose të fshijë mëkatin tënd? Le të mendojmë pak për këtë.

1. A e pranon se ke mëkatuar?
2. A dëshiron që Jezusi të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit?
3. A dëshiron që Jezusi të jetë udhëheqësi i jetës sate?

Le të ndalemi. Nëse u je përgjigjur me "po" të treja pyetjeve, dua që të kalojmë disa çaste për të folur me Të:

I dashur Perëndi, unë e pranoj se jam mëkatar dhe se kam nevojë për një Shpëtimtar. Unë besoj se Biri yt i përsosur, Jezusi, vdiq në kryq për të marrë ndëshkimin e mëkatit tim. Të lutem më fal dhe bëhu udhëheqësi i jetës sime. Në emrin e Jezusit, Amen.

E gjelbër dhe e artë

Lexo 2 e Pjetrit 3:18a

Përmbledhje: E gjelbra duhet të na kujtojë të rritemi si kjo bima. Tregoju bimën. Jo fizikisht, por frymërisht; ne duhet të rritemi në njohjen e Tij dhe në ngjashmëri me Të. Këtë e bëjmë duke lexuar Biblën, duke shkuar në kishë dhe duke u lutur. Nëse tashmë je lutur dhe i ke kërkuar Jezusit të të falë mëkatin, mund të jesh super i lumtur, sepse je pjesë e familjes së Perëndisë përjetë. Ja një tjetër arsye përse na pëlqen ngjyra e artë. Drejtohu te zemra e artë. Ajo na kujton se Perëndia na do aq shumë saqë ka një vend ku ne do të kalojmë përjetësinë; ky vend quhet qiell. Sa emocionuese!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Le të nxjerrim karamelet dhe të bëjmë një përsëritje të shpejtë ndërsa i hamë sipas radhës. *Përsërisni ngjyrat e "Librit pa fjalë" dhe pikat kyç, duke i lejuar nxënësit të hanë një ose dy nga çdo ngjyrë.*

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

A jeni të gëzuar që Jezusi është i gjallë sot? Le t'i përdorim karamelet që na kanë mbetur për t'ia treguar dikujt tjetër këtë lajm të mirë sot!

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. Si e di që Perëndia të do? (Gjoni 3:16a: "Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin...)
2. Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm e të përsosur, që të vdiste për mëkatin tonë. Si quhet Ai? (Jezusi)
3. A është i vdekur Jezusi? (Jo, Ai është gjallë edhe sot!)
4. A ke mëkatuar ti? Me çfarë mëkatesh sfidohen bashkëmoshatarët e tu?
5. A i ke kërkuar Jezusit të të falë mëaktin dhe të bëhet udhëheqësi i jetës tënde?
6. Si mund të rritesh në ngjashmëri me Jezusin? (Duke marrë pjesë në kishë, duke lexuar Biblën, duke u lutur, etj.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Harta e gjurmuesit
Mësimi tematik: Qielli

Kupto si duhet:	Jezusi po përgatit një vend të quajtur "qiell" për ata që besojnë tek Ai si Shpëtimtar.
Mendo si duhet:	"Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis një vend, do të kthehem përsëri dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju." Gjoni 14:2-3
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se mund të jetoj përgjithmonë në qiell.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar që mund të jetoj përgjithmonë në qiell.

PËRGATITU!

Ky mësim është shkruar për t'i prezantuar nxënësit me vendin e përsosur, qiellin. Ne mund t'i ndihmojmë të kuptojnë se qielli është një vend për të cilin duhet të kemi gëzim, sepse do të jemi në praninë e Perëndisë 24/7/365 – përgjithmonë! Kjo qëndron në kontrast të fortë me realitetin e ferrit, që është ndarje e përjetshme nga Perëndia. Nuk ka asnjëfarë mirësie, bukurie apo dashurie në ferr. Ndërsa në qiell nuk ka asnjëfarë të keqeje, gjëje të dëmshme apo të frikshme. As edhe një hije mëkati nuk ekziston në qiell. Sa vend i mrekullueshëm që e presin me padurim ata që kanë besuar në Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tyre!

Lutu: Lutu që Perëndia t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë pak nga qielli. Lutu që të largohen nga mësimi shpresëplotë, edhe pse ka kaq shumë për qiellin që ne ende nuk e kuptojmë.

Lexo: Gjoni 14:2-3, Zbulesa 21, Mateu 25:31-46, Gjoni 3:36, Filipianëve 3:21, 1 e Korintasve 15:52b

Kupto si duhet: Jezusi po përgatit një vend të quajtur "qiell" për ata që besojnë tek Ai si Shpëtimtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënime për mësuesin kryesor:

- Ka shumë gjasa që nxënësit do të kenë shumë pyetje për qiellin për të cilat nuk kemi përgjigje. Kur të të pyesin, nuk ka problem të thuash që nuk e di përgjigjen. Në këtë mësim do të merremi me tre pyetjet më të zakonshme:
  - Si është qielli?
  - A shkojnë të gjithë njerëzit në qiell?
  - Si të shkojmë në qiell?

  Përgjigjet për këto tri pyetje mund të ngrenë pyetje të tjera. Çdo pyetje që të bëhet merre si tregues që nxënësit po mendojnë për atë që po mësojnë dhe se vërtet po e përvetësojnë!
- T'i ndihmosh nxënësit të kuptojnë sadopak për qiellin dhe të flasin lirisht për të mund të zgjojë pasion të ri brenda tyre. Pasi problemet, lëndimet dhe sfidat tona në këtë botë të marrin fund, do të shijojmë praninë e Perëndisë përgjithmonë! Ndërkohë, jemi thirrur të jetojmë të shpenguar këtu në tokë, duke e modeluar Krishtin për botën dhe duke u prezantuar të tjerëve mundësinë e qiellit. Duhet të kemi njëfarë nxitimi për ta bërë këtë, sepse, pasi të largohemi nga kjo botë, nuk do të kemi më kurrë mundësinë për ta shpallur Ungjillin, apo të ndihmojmë dikë në nevojë në emrin e Jezusit, apo t'i gjendemi pranë dikujt që ka humbur një njeri të dashur. Duhet të ripërkushtohemi që t'i nxisim fëmijët t'i mbajnë sytë drejt përjetësisë dhe të duam që edhe të tjerë t'u bashkohen në vendin që Jezusi po përgatit.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Mblidh objekte për çdo pyetje të mësimit dhe krijo një "muzeum" në klasë (shih sugjerimet e mëposhtme):
   a. "Si është qielli?": Xixa të arta, shembuj të bukur të krijimit (objekte, foto, bimë, etj.), objekte që përfaqësojnë faqen e zezë të "Librit pa fjalë", objekte që përfaqësojnë sëmundje/vdekje (paterica/objekte mjekësore/aparate), posteri "Ndihu si duhet" për të treguar emocionet e dhimbshme që nuk do t'i përjetojmë në qiell (zemërimi, trishtimi, mërzia, shqetësimi, etj.)
   b. "A shkojnë të gjithë në qiell?": Dele dhe dhi (foto ose pelusha), një top leshi për të ilustruar përjetësinë (kërkoji njërit prej nxënësve të kapë njërën anë dhe ta tërheqë derisa të hapet i gjithë topi – duhet të jetë i gjatë! Përjetësia do të jetë e ngjashme, por pa fund.)
   c. "Si të shkojmë në qiell?": Objekte për të përfaqësuar ngjyrat e "Librit pa fjalë"
2. Krijo një poster, ose përdor tabelën ndërsa shpjegon, dhe listo disa gjëra kyç të qiellit: Jezusi, rrugët e arta, përsosmëri, bukuri, lumturi, përjetësi, asnjë mëkat, asnjë lot, etj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Jepi secilit prej nxënësve një letër të artë dhe një letër të zezë. Sa herë që përshkruan diçka të përsosur dhe të bukur që do të ketë në qiell, kërkoju të ngrenë letrën e artë. Sa herë që përshkruan diçka të dhimbshme apo mëkatare (që nuk do të jetë në qiell), kërkoju të ngrenë letrën e zezë.

NISU

Loja e përsëritjes para takimit dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje, ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Vizatoje!

Qëllimi: T'i nxisim fëmijët të mendojnë se si është qielli.

Vendndodhja: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Kartonë të bardhë (nga një për çdo nxënës)
- Bojëra dhjami, lapsa me ngjyra dhe/ose lapustila

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi secilit prej nxënësve një karton dhe mjetet për vizatim.
2. Pyeti: "A keni menduar ndonjëherë se si do të jetë qielli?"
3. Udhëzoji të vizatojnë qiellin, siç mendojnë ata se do të jetë. Tregoju se nuk po kërkon një përgjigje specifike. Ky ushtrim është një mënyrë për të hedhur në letër çfarë kemi mësuar e kuptuar deri më tani.
4. Kërkoju t'i marrin me vete edhe gjatë shpjegimit të mësimit.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – Lidhja e KZ-së me mësimin: Hidhuni një sy vizatimeve tuaja të qiellit. Çfarë keni vizatuar? *Jepu katër ose pesë nxënësve mundësinë për të treguar se çfarë kanë përfshirë ata në vizatimin e tyre të qiellit.* Në vizatimet tona kemi treguar gjërat fizike që mendojmë se mund të gjenden në qiell. *Përmend disa nga objektet fizike që kanë vizatuar nxënësit si ndërtesa, pemë, re, rrugë, etj.* Qielli është një vend i vërtetë që Perëndia e ka krijuar. Është një vend i përsosur ku mund të jetojmë me Perëndinë përgjithmonë. Sot do të mësojmë më shumë për qiellin.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Para se të luteni, kujtoju atyre se po flasin me Krijuesin e universit.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Zbuloje: Vargu nga "Mendo si duhet" është Gjoni 14:2-3. Vargu i parë është një nga 12 vargjet kyç (Gjoni 14:2), kështu që shumë prej jush e njohin. A gjendet ky varg në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (Dh. R.) Le t'i hapim Biblat dhe ta zbulojmë.

Prezantimi me mësimin nga Bibla:
Kemi shumë pyetje për qiellin. Nuk i kemi të gjitha përgjigjet, sepse Bibla nuk na tregon gjithçka për qiellin. Mirëpo, na tregon mjaftueshëm sa për t'iu përgjigjur tri pyetjeve:

1. Si është qielli?
2. A shkojnë të gjithë në qiell?
3. Si të shkojmë në qiell?

Do të punojmë së bashku për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.

Përvijimi i Shkrimit

Pyetja 1: Si është qielli?

Qielli është një vend i vërtetë
Qielli nuk është një ëndërr apo diçka e trilluar. Është një vend i vërtetë. *Lexo Gjoni 14:2-3 me zë.* Jezusi tha se është një vend që Ai po e përgatit për ne.

Perëndia është në qiell
Gjëja më e bukur e qiellit është fakti se atje është Perëndia! Te Zbulesa 21:3, lexojmë se Perëndia jeton në qiell dhe se një ditë edhe ne do t'i bashkohemi atje! A e imagjinoni dot? Nëse ke besuar në Jezusin si Shpëtimtar, atëherë një ditë do të shkosh në qiell dhe do ta shohësh Jezusin vetë! Çfarë mendoni se do të thotë? *Nxiti të përgjigjen; përgjigjet mund të jenë: "Mirë se erdhe në shtëpi!", "Kam qenë duke përgatitur një vend për ty këtu!", "Jam shumë i gëzuar që erdhe!", etj.* Dua të mendoni se si ndiheni kur shkoni në shtëpi pas një dite të gjatë e të lodhshme; lumturinë që ndieni kur shihni familjen dhe shtëpinë tuaj. Është ndjesi e mirë, apo jo? Ndiheni të ngushëlluar, të sigurt e të mirëpritur. Atë ndjesi shumëfishojeni me njëmijë, edhe prapë as që i përafrohet asaj që do të ndiejmë kur të jemi në qiell!

Qielli është shumë i bukur
Qielli është më i bukur se çdo vend që mund të kemi parë në tokë! Ka gjëra në këtë tokë që janë shumë të bukura dhe ne i duam. Ndoshta nuk e imagjinojmë dot të jetojmë pa to. Mirëpo, qielli është shumë herë më mirë se çfarëdolloj gjëje që kemi këtu. Në fakt, do të jetë i përsosur! Ne e duam krijimin e mrekullueshëm të Perëndisë në këtë tokë dhe i çmojmë njerëzit që na duan dhe që kujdesen për ne, por asgjë nuk krahasohet me qiellin. Qielli është shumë herë më mirë!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mbyllini sytë dhe më dëgjoni ndërsa lexoj disa vargje që përshkruajnë se sa i bukur do të jetë qielli. *Lexo Zbulesa 21:11, 21:21b dhe 22:1-2a.* Këto vargje përshkruajnë rrugë të bukura të arta, fronin e Perëndisë dhe një lumë të bukur... e kjo është vetëm një pamje shumë e vogël e qiellit që do të jetë i jashtëzakonshëm!

Ne do të adhurojmë Perëndinë në qiell
Qielli do të jetë i jashtëzakonshëm! Do të jetë plot gëzim dhe adhurim. Do të jetë si një festë e madhe, e gëzueshme! Ne do të jemi të lumtur se do të adhurojmë e do t'i shërbejmë së bashku Perëndisë! A e dini se në qiell do t'i shërbejmë Perëndisë përmes pasioneve tona? Çfarë ju pëlqen juve të bëni? *Nxiti fëmijët të përgjigjen.*

Qielli është i përsosur
Kam edhe një varg tjetër për t'ju lexuar. *Lexo Zbulesa 21:5.* Në këtë varg Perëndia thotë se po bën gjithçka të re. Kjo është shumë e rëndësishme. Në qiell nuk do të ketë asnjë mëkat.

Çfarë është mëkati? (Gjithçka mendojmë, themi apo bëjmë kundër Perëndisë) Kur Perëndia e krijoi botën, ajo ishte e përsosur. Mirëpo, kur Adami dhe Eva zgjodhën të mos bindeshin, mëkati i ndryshoi gjërat. Kur mëkati hyri në botë, bashkë me të erdhën sëmundjet, vetmia dhe trishtimi. Të gjitha gjërat e këqija të botës vijnë prej mëkatit. Ndërsa në qiell nuk do të ketë asnjë mëkat, sepse Perëndia është atje dhe Ai është i përsosur e mëkati nuk mund t'i afrohet Atij.

Çfarë nuk do të ketë në qiell?
Duke qenë se e dimë se nuk do të ketë mëkat në qiell, atëherë jemi të sigurt se disa gjëra nuk do të jenë atje. Do t'ju lexoj disa vargje. *Lexo Zbulesa 21:3-4.*

Kur të jemi me Perëndinë në qiell, këto gjëra nuk do të ekzistojnë më:
1. Nuk do të ketë sëmundje. Imagjino një grumbull të madh me paterica, karroca me rrota, aparate frymëmarrjeje, etj., në dalje të qiellit. Çdo njeri do të jetë i ri dhe trupi i tyre nuk do të ketë më sëmundje.
2. Nuk do të ketë më vdekje dhe trishtim.
3. Nuk do të ketë më frikë; gjithçka që të frikëson do të zhduket.
4. Nuk do të ketë më të qara. Asnjë nuk do të të lëndojë. Nuk do të ketë aksidente. Gjërat që të bëjnë të qash nuk do të jenë në qiell.
5. Nuk do të ketë zemërim apo zënka. Nuk do të ketë më të bërtitura. Mendojeni pak... nuk do të ketë më luftra!
6. Nuk do të ketë më urrejtje. Nuk do të ketë tallës. Të gjithë do ta duan njëri-tjetrin. Urrejtja e tmerrshme që na ndan nga njerëzit nuk do të ekzistojë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

7. Nuk do të ketë më vetmi. Në qiell do të rrethohesh nga njerëz që e duan Perëndinë. Ata do të jenë kudo!
8. Nuk do të ketë më mërzi. Disa njerëz mendojnë se qielli është një vend ku njerëzit rrinë ulur duke u rënë harpave ose duke mos bërë asgjë. Mendoni pak për të gjitha gjërat që janë këtu në tokë që nuk na lënë të mërzitemi. Qielli do të jetë shumë më mirë! Krijuesi, Perëndia, po krijon qiellin, që do të jetë shumë më i mrekullueshëm se çdo gjë në tokë. Do të jetë një festë dhe festat nuk janë të mërzitshme!

Ne do të transformohemi në qiell

Kur të shkojmë në qiell, do të transformohemi! A ju kujtohet vargu që lexova nga Zbulesa 21:5? Ashtu siç po e bën Perëndia gjithçka të re, Ai do të na bëjë edhe neve të rinj. *Lexo Filipianëve 3:20-21 dhe 1 e Korintasve 15:51-52*

Ne do të jemi po ne, por me trupa qiellorë të lavdishëm, si Jezusi! Trupat tanë do të jenë të përsosur... ne do të shohim, dëgjojmë dhe lëvizim përsosmërisht! Ne do të jetojmë përgjithmonë (përjetësisht) me Jezusin!

Një tjetër gjë që duhet të dini për qiellin është se zgjat përjetësisht – pra, përgjithmonë! Jeta në tokë ndalon, por nuk do të ndalet kurrë më pasi të shkosh në qiell.

<u>Pyetja 2: A shkojnë të gjithë në qiell?</u>

Përgjigjja e thjeshtë për këtë është: "Jo!" E po, edhe kush *do të* shkojë është përgjigje e thjeshtë.

Te Mateu 25, Jezusi i përgjigjet kësaj pyetjeje. Ai tha se Ai do të ishte si një bari që ndan delet nga dhitë. Bariu dërgon delet në të djathtë dhe dhitë në të majtë. Ai do t'i ndajë njerëzit në dy grupe: njerëzit që kanë besuar tek Ai dhe i kanë shërbyer të tjerëve në emrin e Tij dhe njerëzit që nuk kanë besuar tek Ai dhe nuk janë kujdesur për njerëzit përreth tyre.

Ngri lart faqen e bardhë të "Librit pa fjalë". Njerëzit që kanë ndjekur Jezusin do ta kalojnë përjetësinë me Të në qiell. *Ngri lart faqen e zezë të "Librit pa fjalë".* Njerëzit që nuk e kanë ndjekur Atë, do ta kalojnë përjetësinë të ndarë nga Perëndia, në ferr.

Lexo Gjoni 3:36. Nëse besojmë në Jezusin si Shpëtimtari ynë, jemi të shpëtuar përjetë. Kjo do të thotë se mund të dimë me siguri se e kemi jetën e përjetshme në qiell me Jezusin. Kushdo që ka besuar në Jezusin si Shpëtimtar do të jetë në qiell.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A e dini se do t'i njohim njerëzit në qiell. Nëse njerëzit që duam kanë besuar në Jezusin, ne do t'i njohim kur t'i shohim në qiell. Sa gëzim!

Pyetja 3: Si të shkojmë në qiell?

Të gjithë njerëzit në qiell kanë një të përbashkët të madhe. Kur ishin në tokë, në trupat e tyre tokësorë, e vendosën besimin në Jezusin, që Perëndia e dërgoi për të qenë Shpëtimtari i tyre. Ata e kanë pranuar mëkatin e tyre dhe besojnë se Jezusi është Ai që mori ndëshkimin për mëkatin e tyre. I kanë kërkuar falje Perëndisë. Kushdo që e ka bërë këtë do të jetë pjesë e familjes së Perëndisë në qiell.

Disa njerëz nuk besojnë se Jezusi është Biri i Perëndisë, se Ai vdiq për mëkatet e tyre dhe se Ai e tregoi fuqinë e Tij duke mos mbetur në varr. Ndëshkimi i mëkatit të tyre është se ata nuk mund të jetojnë qiell për gjithë përjetësinë. Është e vështirë të imagjinosh jetën përgjithmonë larg Perëndisë, në ferr.

Shumë njerëz besojnë se po të bëjnë mjaft vepra të mira, do të shkojnë në qiell. Ata mendojnë se duke u treguar të sjellshëm ose duke dhënë para për të ndihmuar dikë e bëjnë Perëndinë të lumtur. Mirëpo, kjo do të nënkuptonte se shkojmë në qiell përmes gjërave që bëjmë për Perëndinë. Këta njerëz anashkalojnë diçka shumë të rëndësishme. Ne shkojmë në qiell për shkak se besojmë në Jezusin dhe, për shkak se besojmë tek Ai, bëjmë vepra të mira. Ne do të jetojmë në qiell për shkak të asaj që Jezusi bëri për ne, jo për shkak të asaj që ne mund të bëjmë për Të. *Mundësi për të shpallur Ungjillin duke përdorur "Librin pa fjalë".*

Të jesh i sigurt se do të jetosh përgjithmonë në qiell nëse e ke pranuar mëkatin tënd (gjithçka ke menduar, thënë apo bërë kundër Perëndisë) dhe ke besuar se Jezusi është Biri i Perëndisë, i përsosur, i cili dha jetën e Tij për të paguar për atë që ti ke bërë kundër Perëndisë. Kur bën këtë, diçka ndryshon brenda teje. Fillon të dëshirosh ta jetosh çdo moment të jetës për të nderuar Perëndinë. Dhe Perëndia të jep premtimin e qiellit. Nëse ke besuar në Jezusin si Zoti dhe Shpëtimtari yt, të jesh i sigurt se një ditë do të jesh me Perëndinë në qiell!

Emri yt tashmë është shkruar në Librin e Jetës së Qengjit (Zbulesa 21:27). Kjo do të thotë se je i sigurt – do të jesh një ditë në qiell!

Nëse nuk je lutur apo dorëzuar para Jezusit si Shpëtimtari yt, dhe do të doje të flisje me një drejtues, mund ta bësh tani! *Ftoji nxënësit për shpëtim dhe jepu mundësinë të flasin me një drejtues në një vend të qetë.*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përfundimi

Sa gëzim është kur mëson për premtimet që na ka bërë Perëndia! Ne e dimë se, po të besojmë në Jezusin si Shpëtimtari ynë, një ditë do të jemi përjetësisht me Të në qiell.

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Çfarë të bëjmë tani, ndërkohë që jemi ende në tokë? Nuk shkojmë në qiell tani menjëherë – vetëm Perëndia e di se kur është koha jonë.

Për sa kohë jemi ende këtu në tokë, mund të mësojmë për Jezusin dhe të presim me gëzim ditën kur do të jemi me Të në qiell. Gjithashtu mund të kemi një marrëdhënie me Jezusin tani! *Ngri lart fletën e gjelbër të "Librit pa fjalë".* Ne mund të rritemi e ta njohim më mirë Jezusin duke lexuar Fjalën e Tij (Biblën), duke adhuruar dhe duke i shërbyer Atij dhe duke folur me Të përmes lutjes. Ai na do aq shumë, sa po përgatit një shtëpi të përjetshme për ne në qiell, por Ai do gjithashtu të ketë një marrëdhënie me ne tani!

Është shumë e rëndësishme ta përdorim kohën që kemi këtu në tokë për t'ia shpallur Lajmin e Mirë të Jezusit kujtdo! Ne duam që të gjithë të kenë mundësinë të besojnë në Jezusin si Shpëtimtari i tyre. Ne mund t'i shërbejmë Perëndisë tani, me dhuratat që Ai na ka dhënë, që t'i ndihmojmë të tjerët ta njohin Atë!

Le të lutemi e ta falënderojmë Perëndinë që na ka premtuar një shtëpi të bukur, të përjetshme në qiell.

Alternativë për nxënësit më të rritur: *Lër pak kohë në fund për pyetje. Nëse ka pyetje për të cilat nuk je i përgatitur, shënoji dhe bëja pastorit apo drejtuesve.*

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Te shtojca ka ide për lojëra.

1. E vërtetë apo e gabuar: Njerëzit kthehen në engjëj kur shkojnë në qiell. (E gabuar)
2. Çfarë do të thotë përjetësi? (Përgjithmonë)
3. A shkon në qiell po të jesh njeri shumë, shumë i mirë? (Jo)
4. Kush do të jetë në qiell? (Të gjithë ata që i kanë besuar Jezusit si Shpëtimtar ndërsa ishin në tokë)
5. Cilat janë dy grupe tek të cilat Jezusi do t'i ndajë njerëzit? (Ata që kanë besuar tek Ai dhe ata që nuk kanë besuar)
6. Cili është ndëshkimi i mëkatit? (Vdekje, ndarje e përjetshme nga Perëndia)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lojërat e fundit të përsëritjes

Këshilla:

- *Zhvillo të njëjtën lojë disa javë rresht, që nxënësit të mësohen me rregullat, kështu nuk duhet të përqendrohesh shumë te udhëzimet.*
- *Printoji dhe ngjiti diku udhëzimet, që nxënësit t'i shohin.*

Garë quiz (mjetet: dy zilka apo diçka tjetër që shkakton zhurmë)

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Zgjidh dy nxënës (një nga secila skuadër) që të vijë përpara.
3. Bëj një pyetje nga përsëritja.
4. Nxënësi i parë që i bie ziles dhe përgjigjet saktë, fiton një pikë.
5. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton.

Variante argëtuese:

- **Hedhje e topit:** përgjigje e saktë = godit drejt koshit për të fituar një pikë shtesë
- **Hedhja e zarit:** përgjigje e saktë = hidh zarin (zaret) për të përcaktuar pikët e fituara
- **Tic Tac Toe:** përgjigje e saktë = vendos X ose O në tabelë
- **Rrotullo rrotën:** përgjigje e saktë = rrotullo për të fituar pikë, shpërblime ose etiketa shpërblyese
- **Zarfi i mistershëm:** përgjigje e saktë – zgjidh një zarf që ka pikë ose çmime
- **Këpucët:** përgjigje e saktë = tërhiqni në tokë këpucët e skuadrës; këpuca që arrin e para, fiton
- **Goditje "e vërtetë ose e gabuar"** (mjetet: dy vrasëse mizash): shkruaj "e vërtetë" dhe "e gabuar" në tabelë; nxënësi i parë që godet përgjigjen e saktë, fiton një pikë (ose shkruaj "A", "B" dhe "C" për pyetje me alternativa)

Mbytu ose noto

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Kërkoju të ngrihen të gjithë në këmbë.
3. Pyet njërin nga nxënësit që janë në këmbë.
4. Nëse përgjigjet saktë, ata mund të:
   a. "mbysin" dikë nga skuadra kundërshtare, pra, personi tjetër duhet të ulet dhe të presë që dikush ta "shpëtojë" – OSE –
   b. mund të "shpëtojnë" dikë nga skuadra e tyre që është "mbytur" nga dikush tjetër.
5. Skuadra e parë që i "mbyt" të gjithë anëtarët e skuadrës kundërshtare, fiton!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shëno shumë pikë

1. Vendosu paraprakisht pyetjeve të përsëritjes vlerë në pikë, duke i dhënë më shumë pikë pyetjeve më të vështira (e vështirë = 20 pikë, mesatare = 15 pikë, e thjeshtë = 10).
2. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
3. Skuadrat duhet ta zgjedhin pyetjen e tyre në bazë të vlerës së pikëve.
4. Kur japin përgjigje të saktë, fitojnë pikë për skuadrën.
5. Skuadra e parë që mbledh 100 pikë fiton!

Vendosja në piramidë e gotave plastike (2 sete me gota plastike)

1. Ndaji nxënësit në skuadra.
2. Sa herë që nxënësit përgjigjen saktë, fitojnë një gotë, të cilën duhet ta vendosin te piramida e skuadrës. Piramida do të ndërtohet me çdo gotë që fitohet.
3. Skuadra e parë që i fiton të gjitha gotat dhe përfundon piramidën, fiton.

Gotë mirësie (mjetet: shkopinj druri të vendosur në një gotë me ngjyra; vendos paraprakisht vlerë në pikë te shkopinjtë; vendos pikë pozitive dhe negative, pastaj vendosi shkopinjtë me kokë poshtë që të mos dallohen pikët)

1. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
2. Bëji njërit prej tyre një pyetje përsëritjeje.
3. Kur një nxënës të përgjigjet saktë, mund të zgjedhë njërin nga shkopinjtë dhe të fitojnë pikët e shënuara në të.
4. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton!

Gjejeni se kush...

1. Kërkoji njërit prej nxënësve të ulet përballë klasës dhe pas vetes të ketë një tabelë ose një copë letre.
2. Shkruaj emrin e personit për të cilin kanë mësuar javën e kaluar në tabelën që ndodhet pas nxënësit të ulur në karrige.
3. Kërkoju nxënësve të ngrenë dorën dhe ai që është ulur në karrige do të zgjedhë tre persona që do t'i japin ndihma.
4. Nëse e gjen personazhin, fiton një Etiketë shpërblyese.
5. Personi që jep të dhënën më ndihmuese, fiton vendin te "karrigia e të ftuarit" për raundin e ardhshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Topi i plazhit (mjetet: top plazhi; shkruaj paraprakisht te topi një sërë pyetjesh që mund të aplikohen për çdo mësim, për shembull: Kush ishte personazhi kryesor në këtë mësim? Çfarë mësuam nga KZ-ja? Cili është vargu i ditës nga "Mendo si duhet"? Ku gjendet mësimi ynë në Bibël?)

1. Mos e ndaj klasën në skuadra.
2. Luaj muzikë ose kërkoji njërit nga drejtuesit të recitojë 2 nga 12 vargjet kyç ndërkohë që nxënësit e kalojnë topin te njëri-tjetri. Nxënësit duhet të qëndrojnë ulur.
3. Kur të ndalojë muzika ose të kenë përfunduar vargjet, kushdo që ka topin në dorë duhet t'i përgjigjet pyetjes në të cilën ka gishtin e madh.
4. Jepi një Etiketë shpërblyese nëse përgjigjet saktë.

Rreth botës

1. Mos e ndaj klasën në skuadra; kërkoju të gjithëve të ulen në rreth, në tokë ose me karrige.
2. Zgjidh dy nxënës që të qëndrojnë në mes të rrethit.
3. Bëj një pyetje përsëritjeje.
4. Dy nxënësit e parë që ngrihen dhe përgjigjen saktë, fitojnë raundin.
5. Fituesi qëndron në këmbë.
6. Nxënësi që e humbi vendin, ulet atje ku ishte ulur fituesi.
7. Tani fituesi garon kundër nxënësit tjetër që është ulur pranë tij (në kah orar).
8. Vazhdoje këtë proces deri sa të përfundojë rrethi.
9. Qëllimi është që nxënësit të qarkullojnë nëpër të gjithë rrethin derisa të kthehen në vendin fillestar.
10. Nëse një nxënës arrin të kthehet në karrigen fillestare, fiton lojën.
11. Nëse mbaron koha para se dikush të kthehet në vendin fillestar, atëherë fiton ai që ka ecur më shumë përpara.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

LIBRI PA FJALË

T'U PREZANTOJMË FËMIJËVE UNGJILLIN

Libri pa fjalë është mënyra kryesore se si e ndajmë Ungjillin me fëmijët në kurrikulën e Zbuluesit. Do të vini re se do t'i i referohemi çdo javë ndërsa prezantohet mesazhi i Ungjillit. Secila ngjyrë ka një kuptim të thjeshtë dhe një varg kyç që do t'i ndihmojë fëmijët të marrin kuptimin e vërtetë të dashurisë së Perëndisë dhe të mënyrës se si mund të kemi një marrëdhënie personale me Të, tani e në përjetësi.

Libri pa fjalë është një mjet që paraqet një mesazh të qartë të Ungjillit. Për fëmijët më të rritur, mund t'ju duket si një mjet shumë i përsëritur, por pasi rishikuam rezultatet e testit, mësuam se fëmijët më të rritur dinë fjalën kyç, ngjyrën dhe vargun, por shpesh nuk dinë ta përdorin si mjet për të ndarë apo mbrojtur besimin e tyre. Mbajeni në mendje ndërsa modeloni mesazhin e Ungjillit për fëmijët çdo javë.

Përpiquni që me raste ta përdorni prezantimin e Ungjillit pa iu referuar ngjyrave. Pasi të keni përfunduar, pyetini fëmijët se çfarë iu kujton. Ose, filloni ta ndani Ungjillin duke shprehur gëzimin që keni për shkak se jeni pastruar (shpëtuar) nga mëkati në jetën tuaj. Është e rëndësishme të përfshihet gëzimi i të qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Kur bëhesh i krishterë, Perëndia është Ati yt Qiellor dhe ti u bashkohesh të gjithë të krishterëve si pjesë e familjes së kishës së Tij.

Përdorimi i Librit pa fjalë

Ngjyra e artë – Faqja e artë na kujton dashurinë e Perëndisë për ne dhe se si ne, si të krishterë, mund të kemi sigurinë se një ditë do të shkojmë në qiell. Gjoni 14:2 thotë: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend". Qielli është i vërtetë… dhe është një vend i përsosur e real. Do të jetë i mbushur me gëzim, lumturi, rrugë të arta, me praninë e vetë Perëndisë dhe do të jetë një familje e përsosur. Por diçka nuk është në qiell… dhe ajo është mëkati.

Ngjyra e errët – Faqja e errët përfaqëson mëkatin. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë që është kundër Perëndisë. Shembuj të mëkatit janë kopjimi, vjedhja dhe thashethemet. Këto gjëra nuk do të jenë në qiell dhe janë gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë. Romakëve 3:23 thotë: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë". Ndëshkimi i mëkatit është vdekja e përjetshme, që do të thotë se nuk mund të shkojmë në qiell, por ka shpresë…

Ngjyra e kuqe – Faqja e kuqe na kujton Jezusin. Jezusi është Biri i vetëm i përsosur i Perëndisë, që erdhi në tokë të jetonte një jetë të përsosur. Për shkak të jetës së Tij të përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë. Hebrenjve 9:22b thotë: "...dhe pa derdhur gjak, nuk ka ndjesë". Jezusi derdhi gjakun e Tij dhe për këtë shkak, Ai është e vetmja rrugë për në qiell. Jo përmes veprave të mira (Efesianëve 2:8-9), por vetëm përmes dhuratës së Jezusit. Pranimi i kësaj dhurate falas nga Jezusi është zgjedhje personale. Por prit, duhet të të tregoj diçka... Jezusi nuk qëndroi i vdekur, Ai u ngrit sërish dhe pati fitore mbi mëkatin!

Ngjyra e bardhë – Faqja e bardhë na kujton se, nëse besojmë këto të vërteta, marrim falje për mëkatin tonë. Veprat 16:31 thotë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote". Beso dhe do të shpëtosh nga ndëshkimi i mëkatit tënd. Mëkati yt mund të falet dhe ti mund të pastrohesh. Por kjo është një zgjedhje që çdo individ duhet ta bëjë vetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ngjyra e gjelbër – Faqja e gjelbër na kujton se, pasi i kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd, Ai dëshiron që ti të afrohesh më tepër me Të. Është një *marrëdhënie*, jo një fe. Ai bëhet udhëheqësi i jetës sate. Për shkak se Ai është udhëheqësi yt, do të duash të rritesh… si bari në muajt e ngrohtë të verës (i gjelbër). 2 e Pjetrit 3:18a thotë: "Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht". Ne afrohemi me Të kur lexojmë Biblën, kur lutemi dhe kur i bindemi Fjalës së Tij.

Duket fantastike, apo jo? Pavarësisht sa vjeç je, kjo është një zgjedhje që duhet ta bësh vetë! Mund të zgjedhësh ta pranosh sot këtë të vërtetë të mrekullueshme. Nëse dëshiron të zgjedhësh t'i kërkosh Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Zoti yt, duhet të lutesh ose të flasësh me Perëndinë për këtë. Perëndia është real dhe mund të të dëgjojë kur lutesh.

Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të lutesh tani për këtë:

1. Pranoje që je mëkatar… tregoji për mëkatin që të mundon dhe se ti e di që ai mëkat nuk i pëlqen Perëndisë. (**ngjyra e errët**)
2. Tregoji se beson që Jezusi vdiq dhe mori ndëshkimin për mëkatin tënd. (**ngjyra e kuqe**)
3. Kërkoji personalisht Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës sate. (**ngjyra e bardhë**)
4. Falënderoje që të ka falur dhe që u bë udhëheqësi i ri i jetës sate.

Nëse vërtet i ke kërkuar Perëndisë të të shpëtojë dhe të bëhet udhëheqësi i jetës saee, duhet të dish që mëkati të është falur dhe ti je fëmijë i Perëndisë.

Këshilla shtesë

Për të ndihmuar në udhëzimin e fëmijëve drejt shpëtimit, programi i Zbuluesit siguron kartën *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*.

Për të ndihmuar me prezantimin e Ungjillit dhe për të filluar me dishepullimin e fëmijëve, programi i Zbuluesit ofron fletushkat *E beson apo jo?* dhe *Po tani, çfarë ndodh?* si dhe libër shënuesin *Unë besoj.*



Fletushka *E beson apo jo?* shpjegon Ungjillin duke përdorur Shkrimin, përkufizime të përshtatshme për fëmijët dhe kornizën e Librit pa fjalë. Është një mjet i shkëlqyer për t'i shpjeguar Ungjillin një fëmije të interesuar, dhe për t'ia dhënë me vete fëmijës që dëshiron të mendojë për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij.

Nëse një nxënës zgjedh t'i besojë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar, fletushka *Po tani, çfarë ndodh?*, është një prezantim i mirë i çfarë do të thotë të jetosh jetën e krishterë. Mbulon shkurtimisht tema si: identiteti i tyre në Krishtin, disiplina frymërore, adhurimi dhe lutja, dhe të bërët pjesë e familjes së Perëndisë.

Pasi fëmija merr vendimin t'i besojë Krishtit si Shpëtimtar, libër shënuesi *Unë besoj* mund të plotësohet si kujtesë e këtij vendimi të rëndësishëm. Shënuesin e mban nxënësi dhe pjesa fundore e tij plotësohet dhe i dorëzohet drejtuesit, në mënyrë që të gëzohemi bashkë me nxënësin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mirënjohje dhe Falënderime

Falënderime të sinqerta për Shawn Thornton, pastor i kishës Calvary Community Church në Westlake Village, Kaliforni, për përdorimin e konceptit “Mendo si duhet”, “Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”. Kjo ide, bashkë me “Kupto si duhet”, është bërë struktura e çdo mësimi të qendërzuar në Bibël në këtë kurikul. E vlerësojmë shumë që ka lejuar këtë ide të jetë pjesë e kësaj kurikule, që të tjerë të mund të pajisen për t’u mësuar fëmijëve të “Kuptojnë si duhet”, të “Mendojnë si duhet”, të “Veprojnë si duhet” dhe të “Ndihen si duhet”.

Jemi mirënjohës për bashkëpunimin e vyer që kemi me “Awana International” dhe që na kanë dhënë lejen t’i referohemi Awana-s brenda kurikulës dhe materialeve trajnuese të “Discovery Land”. Kemi parë se Perëndia e ka përdorur marrëdhënien mes kurikulës të së dielës dhe programit të mesjavës nga Awana që të ketë një ndikim të fortë te nxënësit tanë nëpër botë.

Awana është një markë e regjistruar e “Awana Clubs International”. Përdorur me leje. Appleton Alliance Association, Inc vepron në pavarësi nga “Awana Clubs International” dhe është përgjegjëse vetëm për përmbajtjet e kësaj kurikule.

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla, ABS 2009, përdorur me leje nga *Albanian Bible Society (A.B.S.).*

LEGO® është një markë tregtare e grupit të legove. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.